


KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • PRILL 2014

# Liahona

**Gëzimi dhe Mirënjohja  
për Shpëtimtarin e  
Ringjallur, f. 16**

**Pesë Mënyra për të Ndjekur Profetin, f. 22**

**Bekimet e Priftërisë – Të Gjindshme  
për të Gjithë, f. 46, 50, 53, 54, 60**







*“A mundet një  
grua të harrojë  
foshnjen e gjirit  
dhe të mos i vijë  
keq për fëmijën  
e barkut të saj?  
Edhe sikur ato  
të të harrojnë,  
unë nuk do të  
harroj.*

*Ja, unë të kam  
gdhendur mbi  
pëllëmbët e  
duarve të mia.”*

Isaia 49:15–16



## MESAZHET

- 4 Mesazhi i Presidencës së Parë: Një Spirancë e Hedhur me Qëndrueshmëri**  
Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 7 Mesazhi i Vizitave Mësimore: Misioni Hyjnor i Jezu Krishtit: Shpëtimtari dhe Shëlbuesi**

## ARTIKUJT KRYESORË

- 12 Ne Jemi Duart e Zotit**  
Nga Nil K. Njuëll  
*Shenjtore nga Brazili, Ekuadori, Filipinet dhe Rusia tregojnë se çfarë do të thotë t'iu japësh shërbesë atyre që kanë nevojë.*

### NË KOPERTINË

Përpara: *Kopshiti i Varrit*, nga J. Kirk Richards, nuk mund të kopjohet. Brenda kapakut të përparmë: Fotoilustrim nga John Luke.

- 16 Dëshmitarë të Veçantë Dëshmojnë për Krishtin e Gjallë**  
*Anëtarët e Presidencës së Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dëshmojnë për Shpëtimtarin.*

- 22 Ndiq Profetin**  
Nga Plaku Uilliam R. Uolker  
*Ne duhet t'i mësojmë këto pesë mësim nga shembulli vetjak i Presidentit Tomas S. Monson.*

- 26 Pionierë në Çdo Vend: Filipinet: Forca Shpirtërore në Ishujt e Detit**  
*Pavarësisht nga fatkeqësitë natyrore dhe vështirësitë ekonomike në Filipine, shenjtoret kanë qenë dëshmitarë të rritjes së mrekullueshme atje.*

- 32 Përdorimi i Planit të Shpëtimit për t'iu Përgjigjur Pyetjeve**  
Nga LaRen Porter Gant  
*Plani i shpëtimit mund të na ndihmojë t'iu përgjigjemi disave prej pyetjeve themelore të jetës.*

## SEKSIONET

- 8 Profetët e Dhiatës së Vjetër: Moisiu**
- 10 Shtëpitë Tona, Familjet Tona: Shtatë Ditë Derisa të Vijë Pashka**
- 36 Zëra të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**
- 80 Kur Prapë të Takohemi: Gjetja e Shpresës në të Ardhmen**  
Nga Sten Pagsli





40

#### 40 Nëse Syri Juaj Drejtohet te Lavdia Ime

Nga Kethrin Nelson dhe Haidi Mek-Konki

*Për të qenë njeri i thjeshtë duhet më tepër sesa thjeshtë të veshësh veshjet e duhura.*

#### 44 Profile të Të Rinjve në Moshë Madhore: Kthim në Besim dhe Sakrificë në Finlandë

Nga Melisa Zenteno



*Shihni nëse mund të gjeni Liahonën e fshehur në këtë botim. E dhënë: Cilat janë gjërat e saj të parapëlqyera?*

54

#### 46 Burrat dhe Gratë në Punën e Zotit në Punën e Zotit

Nga Plaku M. Rasëll Ballard

*Si burrat ashtu edhe gratë duhet t'i kuptojnë këto të vërteta rreth rolit që gratë kanë në mbretërinë e Perëndisë.*

#### 50 Duke u Përgatitur për të Shërbyer, Duke Shërbyer për t'u Përgatitur

Nga Dejvid L. Bek

*Shërbimi juaj në Priftërinë Aarone do të vendosë standardin për të gjithë pjesën tjetër të jetës suaj. Ja se si.*

#### 53 Fuqia për t'i Bekuar të Gjithë Njerëzit

*Udhëheqësit e Kishës dëshmojnë për bekimet që vijnë nga priftëria.*

#### 54 Sjellja e Bekimeve të Priftërisë në Shtëpinë Tuaj

Nga Boni L. Oskarson

*Pavarësisht gjinisë apo situatës suaj familjare, ju mund të mbështeteni te fuqia e priftërisë për të bekuar familjen tuaj.*

#### 56 Siguria e Denjesisë

Nga Plaku Xhefri R. Holland

*Kur thirrreni për të përdorur priftërinë, a e keni sigurinë për t'u përgjigjur?*

#### 60 Porta dhe Shtegu

*Ja se si mund t'ju ndihmojë priftëria për t'u kthyer tek Ati Qiellor.*

#### 62 Pyetje e Përgjigje

*Çfarë duhet të bëj kur në shkollë hapet një temë, e cila është në kundërshtim me mësimet e ungjillit, e tillë si aborti?*

#### 64 E Vërtetë apo E Rreme?

Nga Dejvid A. Eduards

*Bëni këtë pyetësor me alternativa dhe mësoni më tepër rreth mënyrës se si na gënjen Satani.*



68

#### 67 "Kjo është kaq e lehtë, Gjyshi."

Nga Plaku Enrike R. Falabela

*Rakela mendonte se nuk ishte e rritur sa duhej për të lexuar Librin e Mormonit.*

#### 68 Premtimi i Porterit

Nga Karol M. Stivens

*Porteri po i mbante besëlidhjet e tij – dhe as nuk e dinte këtë!*

#### 70 Sjellja e Fillorës në Shtëpi: Familja Është Qendrore në Planin e Atit Qiellor

Nga Xhein Teilor

#### 72 Ide e Shkëlqyer

#### 73 Lëvizja e Shkëmbit


Nga Plaku Terens M. Vinson

*Zoti dëshiron të na ndihmojë t'i zgjidhim problemet tona – madje dhe ato të voglat.*

#### 74 Miq nëpër Botë: Unë jam Dria nga Filipinet

#### 76 Për Fëmijët e Vegjël

#### 81 Portret Profeti: Hauard W. Hanter





# Ide për Mbrëmje Familjare

*Ky numër përmban artikuj dhe aktivitete që mund të përdoren për mbrëmje familjare. Në vijim janë dy shembuj.*



FOTOLISTRIMI NGA DAVID STOKER

## "Shtatë Ditë Derisa të Vijë Pashka",

faqe 10 dhe "Dëshmitarë të Veçantë Dëshmojnë për Krishtin e Gjallë", faqe 16: Ju mund të dëshironi t'i përdorni materialet në këta artikuj për të ndarë mendime të përditshme shpirtërore me familjen tuaj javën përpara Pashkës. Duke filluar nga e diela përpara Pashkës, lexoni dëshmitë e Presidencës së Parë në faqen 17 dhe ndiqni udhëzimet tek artikulli "Shtatë Ditë Derisa të Vijë Pashka". Çdo ditë pas kësaj, lexoni dëshmitë e dy Apostujve dhe përdorni shkrimet e shenjta, këngët dhe veprimtarinë tek artikulli "Shtatë Ditë Derisa të Vijë Pashka" për t'i dhënë një mesazh familjes suaj. Të dielën e Pashkës, mund të shikoni videon nga Bibla "He Is Risen" ["Ai Është

Ngritur"] që gjendet te [lds.org/bible-videos](http://lds.org/bible-videos) (e gjindshme në disa gjuhë).

## "Kjo Është Kaq e Lehtë, Gjyshi."

faqe 67: Pasi ta lexoni këtë artikull, edhe ju mund të dëshironi ta nxirrni kronometrin tuaj! Merrni parasysh të lexoni një faqe nga Libri i Mormonit si familje dhe të matni sa kohë ju duhet për ta lexuar. Duke e përdorur atë kohë si udhërrëfyes, llogaritni sa kohë mund t'i duhet familjes suaj për ta lexuar Librin e Mormonit. Ju mund të dëshironi të vendosni një synim për ta lexuar Librin e Mormonit së bashku. Krijimi i një programi, të tillë si të lexuarit në një kohë të përcaktuar çdo ditë, mund t'ju ndihmojë ta arrini synimin tuaj.

## NË GJUHËN TUAJ

*Liahona* dhe materiale të tjera të Kishës gjenden në shumë gjuhë te [languages.lds.org](http://languages.lds.org).

## TEMAT NË KËTË BOTIM

*Numrat përfaqësojnë faqen e parë të artikullit.*

**Besëlidhjet,** 68

**Dallimi,** 64

**Dëshmia,** 62

**Dhiata e Vjetër,** 8

**Familja,** 46, 50, 54, 70

**Gjuha,** 40

**Gratë,** 46

**Hanter, Hauard W.,** 51

**Historia e Kishës,** 26

**Jezu Krishti,** 4, 7, 10, 16, 76

**Konferenca e përgjithshme,** 4

**Kthimi në besim,** 26, 44

**Libri i Mormonit,** 67

**Mirëqenia,** 12, 36

**Monson, Tomas S.,** 22

**Nderimi,** 76

**Pashka,** 10, 16

**Pikëllimi,** 37, 39

**Plani i shpëtimit,** 32, 37, 39, 70

**Priftëria,** 46, 50, 53, 54, 56, 60

**Profetët,** 8, 22

**Puna misionare,** 26, 62

**Shembulli,** 22

**Shërbimi,** 12, 36, 38, 50

**Shlyerja,** 7, 10, 16, 32, 76

**Shpresa,** 80

**Tempujt,** 26, 44

**Thjeshtësia,** 40

**Vlera individuale,** 7, 12





**Nga Presidenti  
Diter F. Uhtdorf,**

Këshilltar i Dytë në  
Presidencën e Parë

# NJË Spirancë

E HEDHUR ME QËNDRUESHMËRI

**J**o shumë kohë më parë, pata mundësinë të lundroja në një anije të madhe përgjatë bregut të mrekullueshëm të Alaskës në SHBA. Ndërkohë që kapiteni përgatitej për qëndrimin e anijes gjatë natës në një gji të pashkelur, ai vlerësoi me kujdes vendndodhjen dhe rrethanat, të tilla si rendin e baticës e zbaticës, thellësinë e ujërave dhe largësinë nga pengesat e rrezikshme. Pasi mbeti i kënaqur, ai e hodhi spirancën që anija të rrinte e mbrojtur dhe e ancoruar në mënyrë të qëndrueshme, duke u dhënë pasagjerëve mundësi për t'u mahnitur me bukurinë madhështore të krijimeve të Perëndisë.

Teksa po shihja vijën bregdetare, fillova të kuptoj se anija po lëvizte në mënyrë pothuajse të pakuptueshme me shkallën më të vogël të erës dhe rrymës poshtë saj. Megjithatë, anija qëndroi në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme brenda një rrethi të përcaktuar nga gjatësia e vijës së spirancës dhe nga fuqia e spirancës.

Kapiteni nuk e kishte mbajtur spirancën të ruajtur në anije, gati për ta ulur vetëm nëse do të afronte një stuhi. Jo, ai e kishte ulur spirancën e anijes si një masë parandaluese dhe e mbrojti anijen nga lëvizja drejt ujërash të pasigurt ose nga të shkuarit dalëngadalë pas rrjedhës ndërkohë që pasagjerët dhe ekuipazhi ndiheshin të sigurt.

Teksa po e soditja këtë skenë, më erdhi ndër mend mendimi se, nëse kjo nuk ishte një mundësi për një shëmbëlltym, atëherë unë nuk kisha pilotuar kurrë një aeroplan.

## **Përse na Duhet Spirancat**

Qëllimi i një spirance është ta mbajë të mbrojtur dhe të sigurt një anije në një vendndodhje të dëshiruar ose që të ndihmojë për ta kontrolluar anijen gjatë motit të keq. Sidoqoftë,

për t'i arritur këto qëllime jetike, nuk mjafton thjesht të kesh një spirancë. Spiranca duhet të jetë e fortë, e besueshme dhe të përdoret siç duhet në kohën dhe vendin e duhur.

Edhe individët dhe familjet kanë nevojë për spiranca.

Fatkeqësia mund të vijë si një stuhi e madhe që na flak jashtë udhës dhe kërcënon të na përplasë pas shkëmbinjve. Por ndonjëherë, ne jemi në rrezik edhe kur gjithçka duket se është e sigurt – erërat të lehta dhe ujërat të patrazuar. Në fakt, ne mund të jemi në rrezikun më të madh kur po na merr rrjedha dhe lëvizja është aq e papërfillshme saqë mezi e dallojmë.

## **Ungjilli Është Spiranca Jonë**

Spirancat duhet të jenë të qëndrueshme, të forta dhe të mirëmbajtura që të jenë gati kur është nevoja. Përveç kësaj, ato duhet të jenë të lidhura te një bazament i aftë për ta mbajtur peshën e forcave kundërshtare.

Sigurisht, ungjilli i Jezu Krishtit është një spirancë e tillë. Ai u përgatit nga Krijuesi i universit për një qëllim hyjnor dhe u hartua për t'iu dhënë siguri dhe udhërrëfim fëmijëve të Tij.

Çfarë është ungjilli, në fund të fundit, përveçse plani i Perëndisë për t'i shëlbuar fëmijët e Tij dhe për t'i kthyer ata përsëri në praninë e Tij?

Duke e ditur se është në natyrën e të gjitha gjërave që të lëvizin, ne duhet t'i hedhim spirancat me qëndrueshmëri në themelin e vërtetësisë së ungjillit. Ato nuk duhet të ulen lehtëazi në rërat e krenarisë ose mezi ta prekin sipërfaqen e bindjeve tona.

Këtë muaj ne kemi mundësi t'i dëgjojmë shërbëtorët e Perëndisë në një konferencë të përgjithshme të Kishës. Fjalët e tyre, të bashkuara me shkrimet e shenjta dhe nxitjet





e Shpirtit, përbëjnë një bazë themeli të sigurt e të qëndrueshëm vlerash e parimesh të përjetshme, tek i cili mund t'i lidhim spirancat tona në mënyrë që të mbetemi të patundur e të sigurt mes mundimeve dhe sfidave të jetës.

Profeti i lashtë Helamani dha mësim: “Është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj; që kur djalli të çojë erërat e tij të fuqishme, po shigjetat e tij në shtjellë të erës, po, kur i gjithë breshëri i tij dhe furtuna e tij e fuqishme do të lëshohen mbi ju, nuk do të ketë fuqi mbi ju, që t’ju tërheqë në humnerën e mjerimit dhe të vuajtjes së pafund, për shkak të shkëmbit mbi të cilin jeni ndërtuar, që është një bazë e sigurt, një bazë mbi të cilën në qoftë se njerëzit ndërtojnë, nuk mund të bien” (Helamani 5:12).

### **Vlera e Spirancave të Hedhura me Qëndrueshmëri**

Jeta ka një mënyrë për t’i vënë në provë spirancat tona dhe për të na tunduar të shkojmë pas rrjedhës. Megjithatë, nëse spirancat tona vendosen siç duhet në shkëmbin e Shëlbuesit tonë, ato do të na mbajnë – pavarësisht nga forca e erës, fuqia

e baticës apo lartësia e dallgëve.

Sigurisht, një anije nuk bëhet që të mbetet e palëvizur në një port, por përkundrazi që ta ngrejë spirancën e të lundrojë në detet e jetës. Por kjo është një shëmbëlltëri për një kohë tjetër.

Për momentin, unë gjej ngushëllim te dijenia se spiranca e ungjillit dhe shkëmbi i Shëlbuesit tonë do të na mbajnë të patundur e të sigurt.

Një spirancë e tillë nuk do të na lejojë të shkojmë drejt rrezikut dhe fatkeqësisë. Ajo do të na japë mundësinë e lavdishme për të gëzuar bukuritë e pakrahasueshme të peizazhit vazhdimisht të ndryshueshëm e madhështor të jetës.

Jeta është e bukur dhe ia vlen të jetohej. Era, stuhia dhe rrymat mbizotëruese mund të na tundojnë të shkojmë drejt rrezikut të dukshëm e të padukshëm, por mesazhi i ungjillit dhe fuqia e tij hyjnore do të na mbajnë në shtegun e kthimit drejt portit të sigurt të Atit tonë Qiellor.

Prandaj, jo vetëm t’i *dëgjojmë* bisedat e konferencës së përgjithshme të prillit, por edhe t’i *zbatojmë* mesazhet e tyre si një spirancë e hedhur me qëndrueshmëri në jetën tonë të përditshme.

Na bekoftë dhe na drejtoftë Perëndia në këtë udhëtim kuptimplotë dhe të domosdoshëm! ■

### **MËSIMDHËNIA NGA KY MESAZH**

**M**errni parasysh të diskutoni për rëndësinë e spirancave në kontekstin e lundrimit të familjes së Lehit drejt tokës së premtuar (shih 1 Nefi 18). Ju mund të vini në dukje 1 Nefi 18:11–15, një kohë kur Nefi është i lidhur, liahona pushon së vepruari dhe anija shtyhet nga stuhi të dhunshme. Çfarë pasojash hasim kur nuk kemi një spirancë të hedhur në mënyrë të sigurt në ungjillin? Ju mund të vini në dukje edhe 1 Nefi 18:21–22 dhe të diskutoni rreth mënyrës se si mund të gjejmë mbrojtje duke u kthyer te Shpëtimtari.



## Konferenca dhe Unë

Nga Sara Diks



**E**kisha zakon të mendoja se fundjava e konferencës së përgjithshme ishte e gjatë dhe e mërzitshme, por me kohën që ka kaluar, kam arritur ta dua dhe ta pres me padurim atë. Fundjava e konferencës së përgjithshme mund të na mbushë përsëri shpirtërisht, por është e lehtë t'i lësh këto ndjenja të zbehen kur jeta e zakonshme vazhdon të hënën. Disa nga idetë vijuese më kanë ndihmuar të vazhdoj të përfitoj sa më tepër që të jetë e mundur nga konferenca.

E përgatis veten për konferencën duke shkruar pyetje dhe më pas mbaj shënime kur pyetjet e mia marrin përgjigje. Pas kësaj, më pëlqen t'i shkarkoj bisedat dhe muzikën e konferencës nga LDS.org dhe t'i vendos në një pajisje dëgjimi për formatin MP3 që të mund

ta dëgjoj një bisedë ose një himn teksta vazhdoj rutinën time të përditshme. Më pëlqen shumë gjithashtu të studioj botimin e *Liahonës* me konferencën. Bëj nënvizime dhe shënime në anët e kopjes sime personale. Deri në kohën kur vjen konferenca e ardhshme, revista ime përdoret më së miri. Familja ime ndonjëherë i studion së bashku mesazhet në mbrëmjen familjare.

Mbajtja me vete e shpirtit që ndiem gjatë konferencës dhe vazhdimësia e të mësuarit nga mesazhet kërkon punë, por bërja e kësaj ka qenë një bekim i madh për mua. Kam marrë kaq shumë fuqi dhe udhërrëfim në kohë nevojë duke i studiuar mesazhet nga konferenca e përgjithshme dhe e di se këto mesazhe janë të frymëzuara.

*Autorja jeton në Toronto, Kanada.*

## FËMIJËT

### Hidhni Spirancën Tuaj

**C**farë do t'ju mbajë me spirancën të vendosur në ungjill? Vizatoni një vijë nga litari në dorën e djalit te sendet që Presidenti Uhtdorf tha se janë vende të sigurta për të hedhur spirancën tuaj.



Studiojeni me lutje këtë material dhe kërkoni të dini se çfarë të thoni prej tij. Si do ta rrisë besimin tuaj te Shpëtimtari të kuptuarit e jetës dhe të misionit të Tij dhe si do t'i bekojë ato për të cilat kujdeseni nëpërmjet vizitës mësimore? Për më tepër informacion, shkoni te [reliefsociety.lds.org](http://reliefsociety.lds.org).

## Misioni Hyjnor i Jezu Krishtit: Shpëtimtari dhe Shëlbuesi

*Kjo është pjesë e një serie Mesazhesh të Vizitave Mësimore që paraqesin aspekte të misionit të Shpëtimtarit.*

**N**jë nga titujt më kuptimplotë që e përshkruajnë Jezu Krishtin, është Shëlbues”, tha Plaku D. Tod Kristoferson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. “Shëlboj do të thotë të shlyesh një detyrim ose borxh.

Shëlboj mund të ketë gjithashtu kuptimin të shpëtosh ose të çlirohsh me anë të pagimit të një shpërblese. . . . Secili prej këtyre kuptimeve shfaq aspekte të ndryshme të Shëlbimit të madhërishtëm, të kryer nga Jezu Krishti me anë të Shlyerjes së Tij, që përfshin, sipas fjalëve të fjalorit, ‘të çlirohsh nga mëkati dhe ndëshkimet e tij, me anë të një sakrifice të bërë për mëkatarin.’”<sup>1</sup>

Linda K. Barton, presidente e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, ka thënë: “Ati . . . Qiellor . . . dërgoi Birin e Tij të Vetëmlindur dhe të përsosur që të vuante për mëkatet tona, pikëllimet tona dhe gjithçka që duket e padrejtë në vetë jetën tonë vetjake.

. . . Një grua, që kishte kaluar vite mundimesh dhe hidhërimesh, tha mes



lotëve të saj: ‘Kam arritur të kuptoj se jam si një kartmonedhë e vjetër 20-dollarëshe – e zhubrosur, e grisur, e pistë, e shpërdoruar dhe me shenja. [Por] . . . përsëri unë vlej plot 20 dollarë.’ Kjo grua e di se . . . ajo ishte aq e vlefshme për [Perëndinë] saqë të dërgonte Birin e Tij për të shlyer për të, veçan. Secila motër në Kishë duhet ta dijë atë që di kjo grua.”<sup>2</sup>

### ***Nga Shkrimet e Shenjta***

2 Nefi 2:6; Helamani 5:11–12; Moisiu 1:39

#### **SHËNIME**

1. D. Tod Kristoferson, “Shëlbimi”, *Liahona*, maj 2013, f. 109.
2. Linda K. Barton, “A Është Besimi në Shlyerjen e Jezu Krishtit i Shkruar në Zemrat Tona?”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 114.



## Besim, Familje, Ndihmë

### ***Nga Historia Jonë***

Dhiata e Re përfshin tregime për gra që ushtruan besim te Jezu Krishti, që i mësuan e i jetuan mësimet e Tij dhe që dëshmuuan për shërbesën, mrekullitë dhe madhësitinë e Tij.

Jezusi i tha gruas te pusi:

“Kush pi nga uji që do t’i jap unë nuk do të ketë më kurrë etje përjetë; por uji që unë do t’i jap do të bëhet në të një burim uji që gufon në jetë të përjetshme.

Gruaja i tha: ‘Zot, më jep këtë ujë, që unë të mos kem më etje. . . .’

Unë e di se do të vijë Mesia, që e quajnë Krisht; kur të ketë ardhur, ai do të na kumtojë çdo gjë.’

Jezusi i tha: ‘Unë jam, ai që po të flet!’”

Ajo “atëherë . . . e la kovën e saj” dhe dha dëshmi për të në qytet. (Shih Gjoni 4:6–30.)

### ***Çfarë Mund të Bëj Unë?***

**1.** Si mund t’i tregojmë mirënjohje Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit, Jezu Krishtit?

**2.** Si mund t’i marrim në jetën tonë bekimet e flijimit shlyes të Shpëtimtarit tonë?



# MOISIU

*“Aq i madh ishte Moisiu sa edhe Krishti është përshkruar si një Profet mbi këtë udhëheqës të lashtë të turmës së Izraelit.”<sup>1</sup> – Plaku Brus R. Mek-Konki (1915–1985), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.*

U lindi në Egjipt në një kohë kur njerëzit e mi, izraelitët, ishin në robëri. Duke u frikësuar nga numri në rritje i skllëvërve izraelitë, faraoni urdhëroi që të gjithë izraelitët meshkuj të vriteshin që në lindje. Që të më mbronte, nëna ime më fshehu për tre muaj pas lindjes sime përpara se te më vendoste në një kanistër mes kallamishteve të Nilit. E bija e faraonit më gjeti dhe më rriti si birin e saj.<sup>2</sup>

Kur u rrita, u largova nga Egjipti dhe jetova në tokën e Madianit. Atje gjeta hir në sytë e Jethros, bari e prift, dhe u martova me bijën e tij, Seforën. Nga Jethro mora Priftërinë Melkizedeke.<sup>3</sup>

Një ditë, teksa po kullotja kopenë e Jethros, Zoti m'u shfaq në një ferrishtë që po digjej dhe më thirri që t'i nxirrja fëmijët e Izraelit nga robëria.<sup>4</sup>

U ktheva në Egjipt dhe i thashë faraonit ta çlironte popullin e Zotit, por në vend të kësaj, ai ua shtoi barrat. Zoti dërgoi një seri plagësh mbi egjiptianët, por faraoni e ngurtësoi zemrën dhe sërisht nuk pranoi t'i çlironte izraelitët. Plaga e fundit ishte një engjell shkatërrues që vrau birin e paralindur të çdo familjeje në Egjipt. Izraelitët u mbrojtën nga engjëlli shkatërrues duke spërkatur gjakun e një qengji pa të meta mbi pjesën

rrethuese të dyerve të tyre dhe duke qëndruar brenda në shtëpi. Nëpërmjet meje, Zoti e themeloi Festën e Pashkës si një ordinancë për t'i ndihmuar izraelitët që ta kujtonin këtë mrekulli çdo vit.<sup>5</sup>

Plaga e fundit bëri që faraoni të zbutej e t'i linte të lirë izraelitët. Por faraoni më vonë e ngurtësoi zemrën dhe dërgoi ushtritë pas izraelitëve që po largoheshin. Zoti më bekoj me fuqinë për ta ndarë Detin

e Kuq dhe ne kaluam në tokë të thatë ndërkohë që deti e përmbysi ushtrinë e faraonit.<sup>6</sup>

Zoti më pas shkoi përpara nesh ditën në një re dhe natën në një



MOISIU NË FERRISHTË © PROVIDENCE COLLECTION; MOISIU DUKE NDARË DETIN E KUQ, NGA ROBERT T. BARRETT; MOISIU DHE PLLAKAT, NGA JERRY HARSTON; MOISIU THËRRET AARONIN PËR SHËRBESË, NGA HARRY ANDERSON; MOISIU DHE GJARPRI PREJ BRONZI, NGA JUDITH A. MEHR

kolonë zjarri. Ai na mbajti me ujë, manë dhe shkurta.<sup>7</sup>

Unë u ngjita në malin Sinai, ku qëndrova për 40 ditë dhe mora Dhjetë Urdhërimet nga Zoti. Kur u ktheva nga mali, izraelitët i kishin kthyer shpinën Perëndisë dhe kishin farkëtuar një viç të artë për ta adhuruar. Ata nuk ishin më të denjë të merrnin ligjin që më dha Perëndia, ndaj unë i theva pllakat që e përmbanin atë. U ktheva në mal, ku Zoti më dha një ligj më të ulët, i cili thirret me emrin tim – Ligji i Moisiut.<sup>8</sup>

Në shkretëtirë, Zoti më zbuloi projektet për të ndërtuar një tabernakull

ose një tempull të lëvizshëm. Ne e mbanim tabernakullin me vete në udhëtimet tona që të mund të adhuronim brenda tij. Në tabernakull, populli mori ordinancat dhe unë i fola Zotit “ballë për ballë, ashtu si një njeri flet me mikun e tij”<sup>9</sup>. Zoti më tregoi edhe si ta ndërtoja arkën e besëlidhjes, një relike e shenjtë që qëndronte në pjesën më të shenjtë të tabernakullit, Shenjtëroren e Shenjtërove.<sup>10</sup>

Kur Zoti dërgoi “gjarpërinj flakë-rues” për t’i ndëshkuar izraelitët, unë u urdhërova të bëja një gjarpër prej bronzi dhe ta vija lart mbi një shtizë që të gjithë ata që u kafshuan nga gjarpërinjtë, të mund ta shikonin e të shëroheshin. Por për shkak të krenarisë së tyre dhe të thjeshtësisë së

detyrës, shumë nuk do të shikonin e si rrjedhim vdiqën.<sup>11</sup>

Zoti bëri që izraelitët të endeshin në shkretëtirë për 40 vjet përpara se t’i lejonte të hynin në tokën e premtuar.<sup>12</sup> Unë nuk hyra por u “mor[a] nga Shpirti” për te Zoti.<sup>13</sup> ■

#### SHËNIME

1. Bruce R. Mek-Konki, *Mormon Doctrine*, bot. i 2-të (1966), f. 515; shih edhe Ligji i Përtërirë 18:15–19.
2. Shih Eksodi 1;2:1–10.
3. Shih Eksodi 2:11–22; Doktrina e Besëlidhje 84:6.
4. Shih Eksodi 3;4:1–17.
5. Shih Eksodi 5–12; Ezekieli 45:21.
6. Shih Eksodi 14.
7. Shih Eksodi 13:21–22; 15:22–27; 16; 17:1–7.
8. Shih Eksodi 24:18; 31:18; 32; 34.
9. Eksodi 33:11.
10. Shih Eksodi 25–29; 40:21.
11. Shih Numrat 21:6–9; 1 Nefi 17:41; Alma 33:19–20.
12. Shih Numrat 14:33–34.
13. Alma 45:19.

#### KUTIA E FAKTEVE: MOISIU

**Shkrimet e Moisiut:** Përveç librit të Moisiut në Perlën me Vlerë të Madhe, Moisiu ishte autori i pesë librave të parë në Bibël: Zanafilla, Eksodi, Levitiku, Numrat dhe Ligji i Përtërirë.

**Roli para lindjes:** u përzgjedh që të kryesonte mbi një periudhë ungjillore (shih Abraham 3:22–23)

**Rolet në vdekshmëri:** udhëhoqi izraelitët në largimin nga Egjipti; mori ligjin në malin Sinai (shih Eksodi 12; 20)

**Rolet pas vdekjes:** u shfaq në malin e Shpërfytyrimit, duke u dhënë çelësat e priftërisë Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit (shih Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta, “Shpërfytyrim”, f. 181, scriptures.lds.org); u shfaq në tempullin e Kirtlandit në Ohajo, SHBA, më 3 prill 1836, duke i rivendosur Jozef Smithit çelësat e mbledhjes së Izraelit (shih DeB 110:11)





# SHTATË DITË DERISA TË VIJË PASHKA

Ti dhe familja jote mund të mësoni rreth asaj që bëri Jezusi ndërkohë që po jetonte në tokë. Fillo nga puna të dielën përpara Pashkës. Çdo ditë, lexo shkrimin e shenjtë, bëj veprimtarinë ose këndo këngën (apo një këngë tjetër mbi atë temë). Më pas prite dhe ngjite në një kuti boshe pikturën e Jezusit që përkon me historinë e shkrimit të shenjtë. Kur të mbushen të gjitha kutitë, Pashka do të vijë! ■



## DITA

**1** Ati Qiellor dërgoi Birin e Tij, Jezu Krishtin, që të lindte në tokë.

- Lluka 2:4–7
- "He Sent His Son" ["Ai Dërgoi Birin e Tij"], (*Children's Songbook*, nr. 34).

## DITA

**2** Jezusi që dikur fëmijë. Ne mund të jemi si Ai duke qenë të mirë dhe të sjellshëm.

- Lluka 2:40, 52
- "Jesus Once Was a Little Child" ["Jezusi Që Dikur Fëmijë i Vogël"] (*Children's Songbook*, nr. 55).

## DITA

**3** Jezusi i mbajti të gjitha urdhërimet e Atit Qiellor, përfshirë urdhërimin për t'u pagëzuar.

- Mateu 3:13–17
- "When Jesus Christ Was Baptized" ["Kur Jezu Krishti u Pagëzua"] (*Children's Songbook*, nr. 102).

## DITA

**4** Jezusi kreu shumë mrekulli, si shërimin e njerëzve që ishin të sëmurë, të ndihmuarit e të verbërve që të shihnin përsëri dhe ndalimin e një stuhie.

- Marku 4:36–39
- "Tell Me the Stories of Jesus" ["Historitë e Jezusit M'Trego"] (*Children's Songbook*, nr. 57).

3

2

1

4



**DITA**

**5** Në Darkën e Fundit, Jezusi u kërkoi dishepujve të Tij të merrnin sakramentin si një mënyrë për ta kujtuar Atë. Kur e marrim sakramentin çdo javë, edhe ne mund ta kujtojmë Shpëtimtarin.

- Lluca 22:19–20
- Fol me prindërit për diçka që mund të bësh për të të ndihmuar të mendosh për Jezusin gjatë sakramentit këtë të diel.

**DITA**

**6** Për shkak se Ati Qiellor dhe Jezusi na duan, Jezusi erdhi në tokë për të vuajtur për mëkatet tona, që ne të mund të falemi dhe të kthehemi tek Ati Qiellor.

- Lluca 22:41–44
- Çfarë është diçka që mund të bësh sot për t'i treguar Jezusit që je mirënjohës për sakrificën e Tij?

**DITA**

**7** Pasi qëndroi në varr për tri ditë, Jezusi u ringjall. Për shkak se Ai u ringjall, edhe ne mund të ringjallemi.

- Gjoni 20:15–17
- Lluca 24:36–40
- “Did Jesus Really Live Again?” [“Jetoj Jezusi Vërtet Përs’ri?”] (*Children’s Songbook*, nr. 64).

*Mund t'i dëgjoni këngët e kësaj veprimtarie te [lds.org/music](http://lds.org/music).*







# NE JEMI

# Duart e Zotit

*Kërkimi i të varfërve dhe shërbimi ndaj atyre që vuajnë janë të domosdoshme për atë që do të thotë të jesh një dishepull i Jezu Krishtit.*

**Nga Nil K. Njuëll**

Shërbimet e Mirëqenies

**G**jatë ditëve të para të Depresionit të Madh, gjashtë presidentë kunji nga lugina e Solt-Lejikut u mblodhën së bashku për t'u kacafytur me retë e ngritura të varfërisë dhe urisë që kërcënonin të pushtonin kaq shumë anëtarë të Kishës.<sup>1</sup> Edhe pse kriza ekonomike i preku njerëzit kudo, Juta në veçanti, qe rrënuar.<sup>2</sup>

Në atë kohë, udhëheqësit e Kishës kishin burime të pakta për t'i ndihmuar njerëzit nevojtarë. Ata mundën të përdornin ofertat e agjërimit, sigurisht, por nevoja e vazhdueshme ishte e pakrahasueshme me çdo gjë që kishin përjetuar ndonjëherë. Nën drejtimin e Peshkopatës Kryesuese, ishte themeluar një Zyrë Punësimi Deseret në fillim të viteve 1900. Por ajo nuk ishte pajisur siç duhej që të përballonte një nevojë kaq të stërmadhe.

Këta gjashtë udhëheqës priftërie e dinin se nëse njerëzit e kunjeve të tyre duheshin ndihmuar, ata nuk mund të prisnin. Duhej të merrnin masa të menjëhershme. Ata ia nisën duke i vënë njerëzit të punonin. I organizuan burrat dhe i çuan në fusha ku mund të mblidhnin të korrat. Në shkëmbim të punës së tyre, fermerët mirënjohës u dhuruan burrave ushqim me bujari. Teprica u çua në një depo dhe iu shpërnda të tjerëve që ishin të uritur. Ndërkohë që dhurimet shtoheshin, shenjtorët filluan ta vendosnin ushqimin në konserva për ta ruajtur. Ky qe fillimi i programit të mirëqenies të kohës së sotme.

Tetë dekada më vonë, udhëheqësit e Kishës të kohës së sotme anëmbanë botës përkujdesen për bashkësitë e tyre dhe ndiejnë të njëjtën vendosmëri për t'iu ardhur në ndihmë njerëzve nevojtarë.

Në konferencën e përgjithshme të tetorit 2011, Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, tha: “Shumë shpesh ne i vëm re nevojat që ka rrotull nesh, duke shpresuar se dikush nga larg do të shfaqet në mënyrë magjike për t'i plotësuar këto nevoja. Ndoshta ne presim që probleme të caktuara t'i zgjidhin ekspertë me njohuri të specializuar. Kur e bëjmë këtë, ne i mohojmë të afërmit tonë shërbimin që mund t'i bënim dhe i mohojmë vetes mundësinë për të shërbyer. Megjithëse nuk ka asgjë kundër ekspertëve, le të jemi të vërtetë: nuk do të ketë kurrë ekspertë të mjaftueshëm për t'i zgjidhur gjithë problemet. Në vend të tyre, Zoti e bëri priftërinë e Tij dhe organizatën e saj lehtësisht të gjindshme në çdo vend të botës ku Kisha është ngritur.”<sup>3</sup>

Kjo thirrje për udhëheqësit dhe anëtarët që të marrin masa sikurse frymëzohen nga Fryma e Shenjtë, i ka bërë shumë anekënd botës që, siç tha Presidenti Uhtdorf “ta zbulojnë vetë [ç'të bëjnë]”<sup>4</sup>. Ata i kanë përveshur mëngët dhe morën vendimin t'i “kujtolojnë” në gjithçka të varfërit dhe nevojtarët, të sëmurët dhe të brengosurit” (DeB 52:40).



## Ekvadori

Teksa peshkopi Xhoni Morante in Guajakil të Ekuadorit, kujdesej për anëtarët e lagjes së tij, atij i pikonte në zemër. Shumë prej familjeve mundoheshin shumë për të plotësuar edhe nevojat më të domosdoshme të jetës. Ai dëshironte t'i ndihmonte, ndaj u këshillua me udhëheqësit e lagjes dhe iu lut për çështjen Zotit.

Duke qenë se mundësitë e punësimit në zonë ishin të pakta, ai filloi të punonte me një grup prej 11 motrash, duke i nxitur ato të ndiqnin mundësinë e një rasti për biznes të vogël. Këto motra vunë re se ishte nevoja për produkte cilësore, me kosto të ulët për pastrimin e shtëpisë dhe vranë mendjen nëse mund t'i prodhonin e t'i shisnin në komunitetin e tyre. Por si do të mësonin ato t'i bënin këto produkte?

Në këtë kohë, peshkopi Morante u vu në dijeni për një motër të papunë në lagjen e tij që kishte punuar si kimiste farmaceutike. Kur 11 motrat e pyetën atë nëse do t'i ndihmonte, ajo i mësoi me kënaqësi ato se si të bënin produkte të sigurtat e cilësore.

Ato krijuan një plan biznesi, përcaktuan zonat e komunitetit që do të mbulonte çdo motër, zgjodhën produktet që do të bënin dhe bënë projektin e paketimit dhe të etiketave.

Në pak muaj, ato kishin ndërtuar një rrjet klientësh dhe po mblidhnin të ardhura të mjaftueshme për ta lehtësuar varfërinë e tyre dhe për të ndihmuar në plotësimin e nevojave të familjeve të tyre.

Kur administruesit e një kompanie farmaceutike vendore mësuuan për këtë sipërmarrje, atyre iu ngjalli kureshtje historia e kimistes farmaceutike të papunë. Në fund, ata e intervistuan dhe e punësuan atë që të drejtonte vetë prodhimin e tyre.

## Rusia

Në lagjen Reknoj të Moskës në Rusi, Galina Gonkarova, e cila po shërbente si historiane e lagjes, rrëshqiti në akull dhe theu të dy krahët. Ajo u çua në spital, ku ia vunë krahët në allçi. Ajo nuk mund të ushqej apo vishej vetë. Nuk mund t'i krihte flokët ose madje t'i përgjigjej telefonit.

Kur anëtarët e lagjes së saj mësuuan për atë që kishte ndodhur, ata reagueshan sakaq. Mbajtësit e priftërisë i dhanë një bekim dhe punuan me motrat e Shoqatës së Ndhmës për të krijuar një program për të kontrolluar si ishte kjo motër e mirë dhe për t'u kujdesur për nevojat e saj.

Vladimir Nekiporovi, udhëheqësi i misionit të lagjes, tha: "Na u kujtua një bisedë e dhënë në konferencën e



*Pasi Galina Gonkarova rrëshqiti dhe theu krahët, motrat e saj të Shoqatës së Ndhmës shërbyen si duart e saj.*

përgjithshme rreth një statuje të Krishtit që nuk i kishte duart.<sup>5</sup> Poshtë statujës dikush kishte vendosur një pllakë ku lexohej: 'Ju jeni duart e mia'. Për ato pak javë që kjo motër ishte e paaftë, anëtarët e lagjes Reknoj ndien një ngjashmëri me atë histori. Ne u bëmë duart e saj me kuptim e plotë të fjalës."

## Filipinet

Kur stuhia tropikale Uoshi ra mbi Filipinet në 2011, ajo e përmbysi zonën me një rrebesh uji dhe ere. Afro 41.000 shtëpi u dëmtuan dhe më tepër se 1.200 njerëz humbën jetën.

Përpara përmbytjes, Maks Savedra, presidenti i kunjtit të Kagajan de Oro të Filipineve, kishte ndier nxitjen për të krijuar një skuadër reagimi ndaj urgjencave. Ai organizoi komitete që të përmbushnin detyra të ndryshme – gjithçka

nga kërkimi dhe shpëtimi deri te ndihma e parë dhe siguri mi i ushqimit, ujit e veshmbathjeve.

Kur ujërat u tërhoqën deri në një nivel të sigurt, udhëheqësit dhe anëtarët e Kishës u vunë në lëvizje. Ata u bënë përgjegjës për sigurinë e çdo anëtari dhe për vlerësimin e dëmit. Një anëtar solli gomone për t'i çuar anëtarët e bllokuar te një vend i sigurt. Shtëpitë e mbledhjeve u hapën për t'u dhënë strehim të gjithë atyre që kishin nevojë për ushqim, veshmbathje, batanije dhe një vend të përkohshëm ku të qëndronin. Uji i pastër ishte një nevojë e ngutshme, ndaj Presidenti Savedra u lidh me një biznes vendor që zotëronte një kamion zjarrfikësish dhe ata transportuan ujë të pastër në qendrat e evakuimit të shtëpive të mbledhjeve. Anëtar me përvojë profesionale mjekësore ndihmuan ata që ishin lënduar.

Pasi u siguruan anëtarët e Kishës, Presidenti Savedra dhe skuadra e tij vizituan qendra të tjera të evakuimit në qytet dhe u ofruan ndihmë. U sollën atyre ushqim dhe furnizime të tjera. Shumë prej anëtarëve, edhe pse kishin humbur vetë shtëpitë e tyre, iu shërbyen me vetëmohim të tjerëve menjëherë pas stuhisë. Kur shirat pushuan dhe toka u tha, vullnetarët e Duarve Ndhimëtare Mormone nga tre kunje shkuan të punonin në shpërndarjen e furnizimeve, duke ndihmuar edhe për pastrimin.

## Brazil

Brenda qytetit të Sete Lagoasit në Brazil ka një strehë për gratë me paaftësi, jeta e të cilave është prekur nga abuzimi me drogën. Çdo ditë ato luftonin për të mbijetuar. Kishin një sobë të vogël që e përdornin për të bërë rreth 30 bukë në ditë. Megjithëse gratë kishin marrë një farë ndihme nga një shoqatë humanitare vendore, ato zor se kishin mjaftueshëm për të ushqyer veten. Kur udhëheqësit e Kishës nga kunji i Sete Lagoasit në Brazil mësuan për nevojat e këtyre grave, ata dëshironin të ndihmonin.

Folën me gratë rreth nevojave të tyre. Gratë thanë se, nëse mund të bënin më tepër bukë, ato jo vetëm që do ta ushqenin më mirë veten, por ndoshta edhe të mund të shisnin disa bukë dhe të fitonin disa të ardhura që iu nevojiteshin kaq shumë.

Udhëheqësit dhe anëtarët e Kishës punuan me polici-në ushtarake të vendit dhe një shkollë vendore për t'ua

përmirësuar kushtet këtyre grave. Me ndihmën e një dhurimi humanitar nga Kisha dhe të vullnetarëve të Kishës e komunitetit, ato mundën të krijonin një furrë të re – një furrë që u lejonte grave të prodhonin 300 bukë në ditë.

Me përfitimet që kanë marrë, gratë në furrën e bukës kanë mundur të marrin në punë punonjësen e tyre të parë – një nga gratë e strehës.

## Puna e Mirëqenies

Sikurse ata udhëheqës të frymëzuar të Kishës disa dhjetëvjeçarë më parë që panë nevojën e madhe përreth tyre dhe nuk pranuan të kthenin shpinën, udhëheqësit dhe anëtarët e Kishës anëmbanë botës sot po bëjnë të njëjtën gjë në zonat e tyre dhe në mënyrën e tyre vetjake.

Kur Presidenti Uhtdorf i foli Kishës për përkujdesjen ndaj të tjerëve, ai tha: “Mënyra e Zotit nuk është të ulemi buzë përroit të problemeve dhe të presim sa të thahet uji përpara se të kalojmë. Mënyra e Zotit është që të mblidhemi së bashku, të përveshim mëngët, të shkojmë të punojmë dhe të ndërtojmë një urë ose një barkë që të kalojmë ujërat e sfidave tona.”<sup>6</sup>

Kërkimi i të varfërve dhe shërbimi ndaj atyre që vuajnë, janë të domosdoshme për atë që do të thotë të jesh një dishepull i Jezu Krishtit. Është puna që Jezu Krishti Vetë bëri kur Ai u shërbeu njerëzve të kohës së Tij. “Kjo punë e ndihmës sipas mënyrës së Zotit nuk është thjesht një artikull tjetër në listën e programeve të Kishës”, përfundoi Presidenti Uhtdorf. “Ajo nuk mund të mos përfillet apo të lihet mënjanë. Ajo është qendrore për doktrinën tonë, është thelbi i besimit tonë.”<sup>7</sup> ■

## SHËNIME

1. Katër nga këta presidentë kunji – Hju B. Braun, Harold B. Li, Henri D. Mojl, dhe Marion G. Romni – u thirrën më pas si Apostuj dhe që të katërt shërbyen më vonë në Presidencën e Parë të Kishës. Harold B. Li u bë Presidenti i 11-të i Kishës.
2. Në vitin 1930, Juta ishte shteti i dytë për normën më të lartë të papunësisë në Shtetet e Bashkuara. Shih Garth L. Mangum dhe Bruce D. Blumell, *The Mormons' War on Poverty: A History of LDS Welfare 1830–1990* (1993), f. 95.
3. Diter F. Uhtdorf, “Ndihma sipas Mënyrës së Zotit”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 54.
4. Diter F. Uhtdorf, “Ndihma sipas Mënyrës së Zotit”, f. 55.
5. Shih Diter F. Uhtdorf, “Ju Jeni Duart e Mia”, *Liahona*, maj 2010, f. 68.
6. Diter F. Uhtdorf, “Ndihma sipas Mënyrës së Zotit”, f. 55.
7. Diter F. Uhtdorf, “Ndihma sipas Mënyrës së Zotit”, f. 55–56.





**A**nëtarët e Presidencës së Parë dhe të Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve janë profetë, shikues dhe zbulues të kohëve të sotme, të cilët qëndrojnë si “dëshmitarët e veçantë të emrit të Krishtit në gjithë botën” (DeB 107:23). Si të tillë, ata kanë përgjegjësinë për të dëshmuar për natyrën hyjnore të Jezu Krishtit dhe për misionin e Tij si Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës.

Në citimet që vijojnë, këta burra të zgjedhur e të autorizuar, japin dëshmitë e tyre për Shlyerjen e Shpëtimtarit, Ringjalljen dhe realitetin e gjallë.

# Dëshmitarë të Veçantë Dëshmojnë për Krishtin e Gjallë



## Jezu Është Shëlbuesi Ynë

“Me gjithë zemrën time dhe zjarrin e shpirtit tim, unë ngre zërin në dëshmi si dëshmi-

tar i veçantë dhe shpall se Perëndia jeton. Jezusi është Biri i Tij, i Vetëmlinduri i Atit në mish. Ai është Shëlbuesi ynë; Ai është Ndërmjetësi ynë me Atin. Ishte Ai që vdiq në kryq për të shlyer për mëkatet tona. Ai u bë fryti i parë i Ringjalljes. Për shkak se Ai vdiq, të gjithë do të jetojnë përsëri. “Ç’gëzim më jep, oh kjo fjalë: ‘E di se rron Shëlbuesi im!’” [“E di se rron Shëlbuesi im”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 38.]

Presidenti Tomas S. Monson, “E di se Rron Shëlbuesi im!” *Liahona*, maj 2007, f. 25.



## Unë Jam Dëshmitar

“Unë jam dëshmitar i Ringjalljes së Zotit, me po aq siguri sikur të kisha qenë atje

në mbrëmjen me dy dishepujt në shtëpinë në rrugën për në Emaus. E di se Ai jeton me po aq siguri sa e dinte edhe Jozef Smithi kur pa Atin dhe Birin në dritën e një mëngjesi të shkëlqyeshëm në korijen e drurëve në Palmira. . . .

. . . Unë dëshmoj kështu, si dëshmitar i Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë të ringjallur.”

Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën së Parë, “Ejani tek Unë”, *Liahona*, maj 2013, f. 25.



## Shlyerja dhe Shpëtimi

“Perëndia, Ati, është autori i ungjillit, i cili është një pjesë kyçe e planit të shpëtimt të Perëndisë, ose

e planit të shëlbimit. Quhet ungjilli i Jezu Krishtit, sepse është Shlyerja e Jezu Krishtit që e bën të mundur shëlbimin dhe shpëtimin. Nëpërmjet Shlyerjes të gjithë burrat, gratë dhe fëmijët shëlbohen nga vdekja fizike dhe të gjithë do të shëlbohen nga mëkatet e veta me kushtin e pranimit dhe të bindjes ndaj ungjillit të Jezu Krishtit . . . .

Për këtë unë jap dëshmi me gjithë zemrën dhe mendjen time.”

Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, “A Nuk Kemi Shkak të Gëzohemi?” *Liahona*, nëntor 2007, f. 19, 21.





### Jezusi Është Krishti

“Unë e di se Perëndia është Ati ynë. Ai ia paraqiti Birin e Tij, Jezu Krishtin, Jozef Smithit. Unë deklaroj se unë e di se Jezusi është Krishti. Unë e di se Ai jeton. Ai u lind në meridianin e kohës. Ai u mësoi njerëzve ungjillin e Tij dhe u gjykua. Ai vuajti dhe u kryqëzua dhe u ringjall në ditën e tretë. Ai, si Ati i Tij, ka trup prej mishi dhe kocke. Ai bëri Shlyerjen e Tij. Për Atë unë jap dëshmi. Unë jam një dëshmitar i Tij.”

Presidenti Bojd K. Paker, President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Të Dymbëdhjetët”, ose *Liahona*, maj 2008, f. 87.



### Një Shpërblese për Familjen Njerëzore

“[Jezu Krishti] është pjesa kryesore e planit të përjetshëm të Atit, Shpëtimtari që u dha si shpërblese për njerëzimin. Perëndia e dërgoi Birin e Tij të Dashur që të mposhte Rënieën e Adamit dhe të Evës. Ai erdhi në tokë si Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Ai e kapërceu pengesën e vdekjes fizike për ne duke dhënë vetë jetën e Tij. Kur vdiq në Kryq, shpirti i Tij u nda nga trupi i Tij. Ditën e tretë, shpirti i Tij dhe trupi i Tij u ribashkuan përjetësisht, për të mos u ndarë më kurrë.”

Elder L. Tom Perry of the Quorum of the Twelve Apostles, “The Plan of Salvation”, *Liahona*, nëntor 2006, f. 71.



### Vepra Qendrore e Historisë Njerëzore

“Shlyerja e [Shpëtimtarit] u krye në Gjetseman, ku Atij i pikuan si djersë pika gjaku (shih Lluka 22:44) dhe në Golgotë (ose Kalvari), ku trupi i Tij u ngrit në kryq te ‘vendi i kafkës’ që nënkuptonte vdekjen (Marku 15:22; Mateu 27:33; shih edhe 3 Nefi 27:14). Kjo Shlyerje e pafundme do ta çlironte njeriun nga pafundësia e vdekjes (shih 2 Nefi 9:7). Shlyerja e Shpëtimtarit e bëri ringjalljen një realitet dhe jetën e përjetshme një mundësi për të gjithë. Shlyerja e Tij u bë vepra qendrore e të gjithë historisë njerëzore.”

Elder Russell M. Nelson of the Quorum of the Twelve Apostles, “The Peace and Joy of Knowing the Savior Lives”, *Liahona*, dhjetor 2011, f. 22.



### Një Sakrificë për Mëkatën

“Jezu Krishti duroi vuajtje të paimagjinueshme për ta flituar Vetën për mëkatet e të gjithë njerëzve. Ajo sakrificë ofroi dobinë përfundimtare – Qengjin e dëlirë pa të meta – për vlerën përfundimtare të së keqes – mëkatet e të gjithë botës. . . .

Ajo sakrificë – Shlyerja e Jezu Krishtit – është në qendër të planit të shpëtimtimit. . . .

Unë e di që Jezu Krishti është Biri i Vetëmlindur i Perëndisë, Atit të Përjetshëm. E di se për shkak të sakrificës së Tij shlyese, ne kemi sigurinë e pavdekshmërisë dhe mundësinë për jetë të përjetshme. Ai është Zoti ynë, Perëndia ynë dhe Shëlbuesi ynë.”

Plaku Dallin H. Ous, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Sakrifica”, *Liahona*, maj 2012, f. 19, 22.



### **Shpëtimtari e Drejton Kishën e Tij Sot**

“Shlyerja e Jezu Krishtit ishte një pjesë e domosdoshme e planit të Atit tonë Qiellor për misionin tokësor të Birit të Tij dhe për shpëtimin tonë. Sa mirënjohës duhet të jemi që Ati ynë Qiellor nuk i ndërhyri, por, përkundrazi, e frenoi instiktin e Tij atëror për ta shpëtuar Birin e Tij të Dashur. Për shkak të dashurisë së Tij të përjetshme për ju dhe mua, Ai e lejoi Jezusin ta plotësonte misionin e Tij të parashuguruar për t’u bërë Shëlbuesi ynë. . . .

Jezu Krishti, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i gjithë njerëzimit, nuk ka vdekur. Ai jeton – Biri i ringjallur i Perëndisë jeton – kjo është dëshmia ime, dhe Ai i drejton punët e Kishës së Tij sot.”

Elder M. Russell Ballard of the Quorum of the Twelve Apostles, “The Atonement and the Value of One Soul”, *Liahona*, maj 2004, f. 85, 86.



### **Shpresa Jonë, Ndërmjetësi Ynë, Shëlbuesi Ynë**

“Siguria jonë është tek [Ati ynë Qiellor] dhe te Biri i Tij, Jezu Krishti. Unë e di se Shpëtimtari ju do. Ai do t’i pohojë përpjekjet tuaja për ta forcuar dëshminë tuaj në mënyrë që të bëhet një fuqi e plotë për mirë në jetën tuaj, një fuqi që do t’ju mbështesë në çdo kohë nevojë dhe t’ju japë paqe e siguri në këto kohë pasigurie.

Si një nga Apostujt e Tij, i autorizuar që të jap dëshmi për Të, unë dëshmoj solemnisht se e di që Shpëtimtari jeton, që Ai është një personazh i ringjallur, i lavdishëm me dashuri të përkryer. Ai është shpresa jonë, Ndërmjetësi Ynë, Shëlbuesi Ynë.”

Elder Richard G. Scott of the Quorum of the Twelve Apostles, “The Power of a Strong Testimony”, *Liahona*, janar 2002, f. 103.



### **Pirja e Kupës së Hidhur**

“Në Kopshtin e Gjetsemanit, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë nuk u mpak kur piu kupën e hidhur të Shlyerjes [shih DeB 19:16–19]. Dhe në kryq vuajti sërish për të bërë vullnetin e Atit të Tij, derisa më në fund mund të thoshte: ‘U krye’ [Gjoni 19:30]. Ai duroi deri në fund. Si përgjigje ndaj bindjes së përsosur të Shpëtimtarit për të qëndruar i paepur, Ati ynë Qiellor shpalli: ‘Vini re Birin tim të Dashur, në të cilin unë jam shumë i kënaqur, në të cilin unë kam lartësuar emrin tim’ [3 Nefi 11:7].

. . . Le ta përlëvdojmë emrin e Perëndisë duke qëndruar të paepur me Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin. Jap dëshminë time të veçantë se Ai jeton.”

Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Qëndroni të Paepur në Vende të Shenjta”, *Liahona*, maj 2013, f. 51.



### **I Vetmi Fëmijë i Përsosur i Perëndisë**

“Unë e di se Perëndia është në të gjitha kohët dhe në të gjitha mënyrat dhe në të gjitha rrethanat Ati ynë i dashur, falës, në Qiell. Unë e di se Jezusi ishte i vetmi fëmijë i Tij i përsosur, jeta e të cilit u dha me dashuri nëpërmjet vullnetit të Atit, sidhe të Birit, për shëlbimin e gjithë ne të tjerëve që nuk jemi të përsosur. Unë e di se Ai u ngrit nga vdekja për të jetuar përsëri dhe, ngaqë Ai e bëri këtë, ju dhe unë do të jetojmë përsëri.”

Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Unë Besoj, o Zot”, *Liahona*, maj 2013, f. 95.





### **E Di se Shpëtimtari Jeton**

“Unë shpall dëshminë dhe vlerësimin tim për sakrificën e pafundme e të përjetshme të Zotit Jezu Krisht. E di se Shpëtimtari jeton. Unë e kam provuar edhe fuqinë e Tij shlyese edhe fuqinë e Tij ndihmuese dhe unë dëshmoj se këto fuqi janë të vërteta dhe të disponueshme për secilin prej nesh. Në të vërtetë, ‘në fuqinë e Zotit’ ne mund t’i bëjmë dhe t’i mposhtim të gjitha gjërat ndërsa shkojmë përpara në udhëtimin tonë të vdekshmërisë.”

**Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Shlyerja dhe Udhëtimi i Vdekshmërisë”, Liahona, prill 2012, f. 19.**



### **Krishti e Përbushi Misionin e Tij**

“[Shpëtimtari] mori mbi vete ‘barrën e mëkateve të njerëzimit’ dhe ‘tmerret që Satani . . . mund të sillte’ [James E. Talmage, *Jesus the Christ*, f. 613]. Në këtë proces Ai duroi gjykimet e sajura me mashtrim dhe ngjarjet e tmerrshme e tragjike që çuan në Kryqëzimin e Tij. Kjo së fundi kulmoi në Ringjalljen triumfuese të Krishtit të dielën e Pashkës. Krishti përbushi misionin e Tij të shenjtë si Shpëtimtar dhe Shëlbues. Ne do të ringjallemi nga vdekja dhe shpirtrat tanë do të ribashkohen me trupat tanë. . . .

Unë jap dëshminë time apostolike se Jezu Krishti jeton dhe është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës. Ai ka siguruar shtegun drejt lumturisë së vërtetë.”

**Plaku Kuentin L. Kuk, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Ne Ndjekim Jezu Krishtin”, Liahona, maj 2010, f. 83–84, 86.**



### **Shpëtimtari na Shëlboi Ne**

“Vuajtja e Shpëtimtarit në Gjetseman dhe agonia e Tij në kryq na shëlbojnë nga mëkati duke kënaqur kërkesat që drejtësia ka mbi ne. Ai shtrin mëshirë dhe fal ata që pendohen. Shlyerja gjithashtu kënaq borxhin që drejtësia zotëron mbi ne, duke na shëruar dhe dëmshpërblyer për çfarëdo vuajtje që durojmë pafajësisht. ‘Pasi vini re, ai vuan dhembjet e të gjithë njerëzve, po, vuajtjet e çdo krijese të gjallë, si burra, gra ashtu edhe fëmijë, që bëjnë pjesë në familjen e Adamit’ (2 Nefi 9:21; shih edhe Alma 7:11–12). . . .

. . . Shëlbimi përfundimtar është te Jezu Krishti dhe vetëm tek Ai. Unë përulësisht dhe me mirënjohje e pranoj Atë si Shëlbuesin.”

**Plaku D. Tod Kristoferson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Shëlbimi”, Liahona, maj 2013, f. 110, 112.**



### **Ringjallja dhe Jeta**

“Mbi të gjitha, ne shpallim Shpëtimtarin dhe Shëlbuesin tonë, Jezu Krishtin. Gjithçka jemi – gjithçka që do të jemi ndonjëherë – ia detyrojmë Atij. . . .

Fjalët e Tij jehojnë përmes shekujve:

‘Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë.

Dhe ai që jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë përjetë’ (Gjoni 11:25–26).

Vëllezër dhe motra, Ai jeton. Ai është ringjallur. Ai drejton punën e Tij të shenjtë mbi tokë.”

**Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Ejani tek Ai”, Liahona, maj 2009, f. 80.**



## **PËRGJIGJE PËR PYETJET**

### **Si duket një njeri i ringjallur?**

“Pasi ta kemi kaluar këtë jetë, ne vërtet do t’i . . . kemi trupat tanë të përlëvdur, të shpen-guar nga çdo sëmundje e ankth dhe të bërë shumë të bukur. Nuk ka asgjë më të bukur për t’u parë sesa një burrë apo grua e ringja-llur. Nuk ka asgjë më madhështore që mund të përfytyroj, që një burrë [apo grua] mund

të zotërojë, sesa një trup të ringjallur. Nuk ka asnjë shenjtor të ditëve të mëvonshme . . . që nuk ka me siguri këtë perspektivë të ngrit-jes në mëngjesin e ringjalljes së parë dhe të bërjes së përlëvdur, të ekzaltuar në praninë e Perëndisë.”

**President Lorenzo Snow (1814–1901), në Conference Report, tetor 1900, f. 4.**







# Ndiq PROFETIN

**D**isa vite më parë, pikërisht përpara konferencës së përgjithshme, Presidenti Tomas S. Monson dha një mesazh të mrekullueshëm. Këtë radhë ishte për Autoritetet e Përgjithshme të mbledhur, të cilët kishin udhëtuar për në Solt-Lejk-Siti të Jutës, shumë duke ardhur nga vende nëpër botë ku po shërbenin në Presidencat e Zonave. Ishim mbledhur së bashku për t'u udhëzuar nga Presidenca e Parë dhe Dymbëdhjetë Apostujt.

Ndërsa po afrohej koha e mbledhjes, të gjithë dukej se ishin të pranishëm me përjashtim të Presidentit Monson. Disa minuta përpara se të fillonte mbledhja, ne pushuam së foluri me njëri-tjetrin dhe u ulëm me nderim për të dëgjuar muzikën e hyrjes, duke pritur që profeti të hynte nga çasti në çast.

Pritëm me durim ndërkohë që ora arriti 09:00 e mëngjesit dhe më pas kaloi. Dikush doli nga dera anësore – sigurisht për të parë nëse ndonjë ndihmë mund të nevojitej. Kur u kthye, ai tha: “Presidenti Monson do të bashkohet me ju së shpejti”.

Rreth 15 minuta më vonë, Presidenti Monson hyri në dhomë. Si shenjë respekti, ne u ngritëm në këmbë kur hyri ai. Ne u gëzuam që e pamë dhe u kënaqëm që ai dukej mirë. Nuk kishte ndonjë arsye të dukshme përse ai kishte qenë me vonesë.

Presidenti Monson shkoi drejt te foltorja dhe tha: “Vëllëzër, më vjen keq që jam me vonesë, por gruaja ime kishte nevojë për mua këtë mëngjes”.

Më bëri thellësisht përshtypje dhe ndjeva përlulësi e nuk mund të ndaloja së menduari për fjalët e tij.

Kjo ishte një mbledhje shumë e rëndësishme. E tërë udhëheqja kryesore e Kishës u mblodh, por Presidenti

*Ndërsa e ndjekim Presidentin Monson dhe përpiqemi të jemi më shumë si ai, ne vërtet do të kemi sukses të pashmangshëm në bërjen dishepuj më besnikë të Zotit Jezu Krisht.*

Monson e dha shembullin për ne të gjithë. Bashkëshortja e tij kishte nevojë për të dhe ai harxhoi kohën e nevojshme për t'u kujdesur për të. Ishte një predikim i madhërishtëm. Nuk më kujtohet ndonjë gjë tjetër që u tha atë ditë, por e kujtoj atë predikim: “Gruaja ime kishte nevojë për mua”.

## **Ndjekja e Shembullit të Profetit**

Dëshiroj të sugjeroj pesë mënyra se si ne mund ta ndjekim shembullin e Presidentit Monson:

### **1. Ne mund të jemi pozitivë dhe mund të jemi të lumtur.**

Në Perlën me Vlerë të Madhe, Profeti Jozef Smith përshkruan “temperamentin [e tij] të hareshëm” (Joseph Smith – Historia 1:28). Fjala “i hareshëm” gjithashtu përshkruan Presidentin Monson.

Në një rast Presidenti Monson tha: “Ne . . . mund të zgjedhim të kemi një qëndrim pozitiv. Ne nuk mund ta drejtojmë erën, por mund t'i rregullojmë velat. Me fjalë të tjera, ne mund të zgjedhim të jemi të lumtur dhe pozitivë, pavarësisht nga çfarë vjen drejt nesh.”<sup>1</sup>

Një ditë po prisja jashtë dhomës së mbledhjes së Presidencës së Parë. Isha ftuar atje për të marrë pjesë në një





***Në çdo përkushtim tempulli, Presidenti Monson përqendrohet te fëmijët. Ka dëshirë t'i përfshijë ata në ceremoninë e vënies së gurit të qoshes.***

mbledhje për të diskutuar çështje të tempujve. U ula qetësisht jashtë dhomës, i vetëm. Mendova se Presidenca e Parë ishte tashmë në mbledhje dhe se ata do të më ftonin të bashkohesha me ta pas pak minutash.

Ndërsa qëndroja i ulur atje, munda të dëgjoj dikë duke ecur nëpër korridor duke fërshëlyer. Mendova me vete: “Dikush nuk e kupton protokollin e duhur. Nuk duhet të vish rrotull duke fërshëlyer jashtë zyrës së Presidentit të Kishës.”

Një çast më vonë fërshëlyesi kaloi qoshen – ishte Presidenti Monson. Ai ishte i gëzuar dhe ishte pozitiv. Më përshëndeti me ngrohtësi dhe tha: “Besoj se do ta fillojmë mbledhjen për pak minuta”.

Edhe me peshën e tërë Kishës mbi supet e tij, ai është një shembull lumturie dhe ai gjithmonë ka një qëndrim pozitiv. Ne duhet të jemi po ashtu.

## **2. Ne mund të jemi të sjellshëm dhe të dashur kundrejt fëmijëve.**

Jezusi foli shpesh për fëmijët. Edhe profeti i Tij, Presidenti Monson, flet shpesh për fëmijët. E kam parë, veçanërisht në përkushtimet e tempujve, se sa i do ai fëmijët dhe, përmes shembullit të tij, na mëson si t'i trajtojmë ata. Në çdo përkushtim tempulli ai përqendrohet te fëmijët. Ka dëshirë t'i përfshijë ata në ceremoninë e vënies së gurit të qoshes dhe gjithashtu i fton disa nga ata të vendosin pak llaç në gurin e qoshes për të marrë pjesë në përfundimin në mënyrë simbolike të tempullit. E bën të gëzueshme

për ta. E bën të paharrueshme për ta. Ai gjithmonë ka një buzëqeshje të madhe për ta. I nxit dhe i lavdëron ata. Është një gjë e mrekullueshme ta shohësh.

Përshëndetjet e tij të ngrohta me raste përfshijnë bërjen qepalla, lëvizjen e veshëve dhe nxitje për të shërbyer misionet dhe për t'u martuar në tempull.

Disa vite më parë u planifikua që Presidenti Monson të përkushtonte Tempullin e Okër Mauntinit në ditën e ditëlindjes së tij. Kur arriti në tempull dhe iu afrua derës kryesore të tempullit, ishte mbledhur një grup të rinjsh. Ata sigurisht e dinin që ishte ditëlindja e Presidentit Monson, sepse filluan t'i këndonin “Gëzuar Ditëlindjen”. Ndaloi dhe i pa ata me një buzëqeshje të madhe në fytyrën e tij. Ai madje filloi të tundte krahët sikur po e dirigjonte të kënduarin e tyre. Në fund ata shtuan refrenin “Dhe shumë të tjera”. Ai më tha: “Kjo është pjesa ime e preferuar”.

Fëmijët dhe të rinjtë e Kishës e duan atë dhe ata nuk kanë asnjë lloj dyshimi se edhe ai i do!

## **3. Ne mund t'i ndjekim nxitjet e Shpirtit.**

Përkushtimi i Presidentit Monson ndaj Zotit dhe zotimi i tij për t'i ndjekur nxitjet e Shpirtit u thanë kaq bukur nga profeti vetë me këto fjalë “Përvoja më e ëmbël që njoh në jetë, është ta ndiesh një nxitje e të veprosht sipas saj dhe më vonë të gjes se ishte plotësimi i lutjes së dikujt apo i nevojës së dikujt. Dhe unë dua gjithmonë që Zoti të dijë se, nëse Ai ka nevojë për një punë për t'u bërë, Tom Monson do ta bëjë atë punë për Të.”<sup>2</sup>

Ky është një model që secili prej nesh duhet të dojë ta ndjekë.

## **4. Ne mund ta duam tempullin.**

Presidenti Monson do të mbahet mend në histori si një nga ndërtuesit e mëdhenj të tempujve në historinë e Kishës. Që kur u bë President i Kishës në shkurt të 2008-ës, ai e ka vazhduar punën e madhërishtme të ndërtimit të tempujve. Në gjashtë vitet që ka qenë profet, Presidenti Monson ka shpallur plane për të ndërtuar 33 tempuj të rinj.

Presidenti Monson ka thënë: “Secili prej nesh jetoftë jetë të denjë, me duar të pastra dhe zemër të dëlirë, kështu që tempulli të mund të prekë jetën tonë dhe familjet tona”<sup>3</sup>.

Ai gjithashtu ka dhënë këtë premtim të mrekullueshëm: “Kur ne e duam tempullin, e prekim tempullin dhe shkojmë në tempull, jetët tona do të pasqyrojnë besimin tonë. Kur shkojmë [në këto] shtëpi [të] shenj[a] të Perëndisë, kur

kujtojmë besëlidhjet që ne bëjmë brenda saj, *ne do të jemi në gjendje të durojmë çdo sprovë dhe të kapërcejmë çdo tundim.*<sup>4</sup>

Le ta ndjekim modelin që profeti ka ngritur për ne për ta dashur tempullin.

### **5. Ne mund të jemi të mirë, të kujdesshëm e të dashur.**

Presidenti Monson është një shembull i mrekullueshëm i dashurisë për të tjerët. E tërë shërbesa e tij është e mbushur me vizita nëpër shtëpi; vënien e duarve mbi koka dhe dhënien e bekimeve; bërjen e telefonatave të papritura për të ngushëlluar dhe inkurajuar; dërgimin e letrave të inkurajimit, përgëzimit dhe vlerësimit; vizita në spitale e qendra përkujdesjeje; dhe gjetjen e kohës për të shkuar në varrime dhe ceremoni funeralesh pavarësisht nga një plan shumë i ngjeshur ditor.

Ashtu siç do të bënte Shpëtimtari, Tomas Monsoni ka shkuar duke bërë mirë (shih Veprat e Apostujve 10:38), duke bekuar dhe dashur të tjerët; kjo ka qenë forca shtytëse në jetën e tij.

Një shembull mbresëlënës i mirësisë së Presidentit Monson ndodhi në vitin 2012. Ndërkohë që tempulli i bukur i Brigam-Sitit në Jutë po i afrohej përfundimit, unë u takova me Presidentin e Parë për të diskutuar plane për përkushtimin e tempullit. Meqë Brigam-Siti ndodhet vetëm një orë në veri të Solt-Lejk-Sitit, do të kishte qenë shumë e lehtë për Presidentin Monson të udhëtonte atje për përkushtimin.

Në vend të kësaj, Presidenti Monson tha: “Brigam-Siti është qyteti i lindjes së Presidentit Bojd K. Paker, këtij Apostulli të madh, i cili është ulur përkrah meje për kaç shumë vite në Të Dymbëdhjetët. Unë dua që ai të ketë nderin dhe bekimin e përkushtimit të tempullit në qytetin e tij të lindjes. Unë nuk do të përzihem dhe do të caktoj Presidentin Paker për ta përkushtuar Tempullin e Brigam-Sitit. Dua që ajo të jetë dita e tij.”

Ishte një ditë e mrekullueshme për Presidentin Paker dhe për Motrën Paker, e cila gjithashtu u rrit në Brigam-Siti. U preka shumë nga gjesti i dashur dhe zemërgjerë i Presidentit Monson ndaj Apostullit koleg të tij. Ne të gjithë mund të jemi në atë mënyrë. Ne mund të ndajmë dhe të jemi dashamirës e të mendojmë më shumë për njerëzit përreth nesh.



**Ashtu siç do të bënte Shpëtimtari, Presidenti Monsoni ka shkuar duke bërë mirë, duke bekuar dhe dashur të tjerët; kjo ka qenë forca shtytëse në jetën e tij.**

### **Modeli i një Profeti**

Presidenti Monson na ka mësuar mënyrën se si ta jetojmë jetën tonë me anë të mesazheve të tij të mrekullueshme dhe frymëzuese në konferenca të përgjithshme. Ai na ka mësuar se si të jemi pasues të Jezu Krishtit me anë të shembullit të tij vetjak, mbresëlënës dhe të mrekullueshëm. Me të vërtetë, Zoti na ka dhënë një model në të gjitha gjërat dhe një nga modelet që ne duhet të përqipemi ta ndjekim është ai i profetit tonë të dashur.

Unë dëshmoj se ka një Perëndi në qiell, i cili na njeh dhe na do. Ai na ka dhënë një profet – për të na drejtuar, për të na mësuar dhe për të na udhëhequr në këto ditë të mëvonshme. Unë besoj se Zoti pret që ne ta duam profetin, ta mbështesim atë dhe ta ndjekim shembullin e tij.

E shoh si bekim të madh të kem jetuar në kohën kur Tomas S. Monson ishte profeti i Zotit. Ndërsa e ndjekim profetin dhe përqipemi të jemi më shumë si ai, ne do të kemi sukses të pashmangshëm në bërjen dishepuj më besnikë të Zotit Jezu Krisht. ■

*Nga një takim shpirtëror i Sistemit Arsimor të Kishës të mbajtur në Universitetin “Brigam Jang” – Ajdaho më 5 maj 2013. Për bisedën e plotë në anglisht, vizitoni [lds.org/broadcasts](http://lds.org/broadcasts).*

### **SHËNIME**

1. “Messages of Inspiration from President Monson”, *Church News*, 2 shtator, 2012, f. 2.
2. *On the Lord’s Errand* (DVD, 2008).
3. Tomas S. Monson, “Bekime të Tempullit”, *Liahona*, tetor 2010, f. 15.
4. Thomas S. Monson, *Be Your Best Self* (1979), f. 56; shkrimi kursiv i shtuar.





# Filipinet:

## FORCA SHPIRTËRORE NË ISHUJT E DETIT

*Në harkun e shkurtër kohor të 53 viteve, Kisha ka përjetuar forcim dhe rritje befasuese në Filipine, vend që njihet si “Perla e Orientit”.*

**P**ër Augusto A. Limin, mesazhi që iu paraqit nga dy misionarë të rinj nga Shtetet e Bashkuara u duk se ia pohoi parimet që ai tashmë i dinte se ishin të vërteta. Augusto, një avokat i ri dhe një i krishterë, vuri re se doktrina të tilla si zbulesa e vazhdueshme ishin “gjëra që, edhe kur isha në shkollë të mesme e në kolegji, i besoja”<sup>1</sup>.

Pas disa muajsh, Augusto pranoi të merrte pjesë në shërbimet e së dielës dhe pranoi sfidën për të lexuar e për t’u lutur rreth Librit të Mormonit. “Fillova ta lexoja Librin e Mormonit seriozisht me të njëjtin shpirt që Moroni na këshilloi [të kishim]. Kur e bëra atë me dëshirën për të ditur nëse është i vërtetë – pas pak rreshtash – unë po merrja një dëshmi”, kujtoi ai.<sup>2</sup>

Në tetor të vitit 1964, Augusto Lim u pagëzua dhe u bë një pionier i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në Filipine, me të shoqen dhe familjen e tij që u bashkuan pas një kohe të shkurtër. Sot, pas dekadash shërbimi besnik në Kishë – që përfshiu një thirrje në vitin 1992 për të shërbyer si Autoritet i Përgjithshëm, filipinasi i parë që shërbeu në atë pozicion – Vëllai Lim pasqyron besimin dhe përkushtimin e qindra mijëra shenjtorëve të ditëve të mëvonshme që jetojnë në “Perlën e Orientit”.

### Një Tokë Pjellore

Rreth 550 vjet përpara lindjes së Jezu Krishtit, Zoti i premtoi profetit Nefi të Librit të Mormonit: “Unë i mbaj

mend ata që janë në ishujt e detit” dhe “ua çoj fjalën time fëmijëve të njerëzve, po, madje të gjitha kombeve të tokës” (2 Nefi 29:7). Shumë njerëzve që i kanë lexuar këto fjalë të zgjedhura, u vjen në mendje një grup i “ishuj[ve të] detit”: Filipinet.

Me një popullsi që i afrohet 100 milionëshit, Republika e Filipineve është një arkipelag i madh me pothuaj 7.100 ishuj që gjenden përgjatë bregut juglindor të Azisë. Është një vend i bukur tropikal i populluar nga njerëz miqësorë, të gjallë e të përrulur. Prapëseprapë vendi është i prirur për tërmete, tajfune, shpërthime vullkanike, dallgë baticash dhe fatkeqësi të tjera natyrore dhe vuan nga një sërë problemesh ekonomiko-shoqërore. Varfëria e përhapur gjerësisht është një sfidë e përsëritur dhe filipinasit kanë duruar periudha me paqëndrueshmëri politike dhe kriza ekonomike.

Por për ata që i njohin mënyrat e Zotit, Filipinet janë një tokë pjellore për mbjelljen e farave të ungjillit. Së bashku me gjuhën tagaloge dhe gjuhët e tjera vendase, shumë filipinas flasin anglisht, që edhe ajo është një gjuhë kombëtare. Falë periudhës së gjatë të sundimit spanjoll, më tepër se 90 përqind e popullatës është e krishterë; një pjesë e konsiderueshme e minoritetit është myslimane.

Orvatja e parë për ta çuar Kishën në Filipine u bë në vitin 1898 gjatë luftës spanjolle-amerikane nga Uillard Koll dhe Xhorxh Simen, shërbetarë shenjtorë të ditëve të mëvonshme nga Juta që ishin veçuar si misionarë përpara





*Duke ndërtuar mbi parimet e ungjillit, të rinjtë në moshë madhore në Filipine po korrin sukses dhe po bëhen udhëheqës energjikë në Kishën e Zotit.*

largimit të tyre. Kur mundësitë u shfaqën, ata predikuan ungjillin, por nuk pati asnjë pagëzim.

Gjatë Luftës II Botërore, disa shenjtore të ditëve të mëvonshme lëvizën përmes ishujve me forcat aleate që përparonin. Në vitet 1944 dhe 1945, grupet ushtarake mbanin mbledhje të Kishës në shumë vendndodhje dhe shumë anëtarë e punonjës SHDM të shërbimeve ushtarake ishin ende në Filipine kur lufta mbaroi. Mes tyre ishin dhe Maksina Tejt dhe i sapokthyeri në besim Xherom Horouic. Që të dy ndihmuan për t'ia paraqitur ungjillin Aniseta Fahardos. Ndërkohë që ndihmonin për t'i rindërtuar shtëpinë Anisetës në një zonë të bombarduar të Manilës, Vëllai Horouic i tregoi për besimin e tij të sapogjetur Anisetës dhe bijës së saj, Ruthit.

Aniseta fitoi një dëshmi dhe dëshiroi të pagëzohej, por Kisha nuk autorizonte pagëzime për filipinasit në atë kohë ngaqë nuk kishte njësi të përhershme të Kishës në ishuj. Plaku Harold B. Li (1899–1973), i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, u vu në dijeni për dëshirën e Anisetës dhe në pozitën e tij si kryetar i Komitetit të Përgjithshëm të Ushtarakëve, Plaku Li e miratoi pagëzimin e Anisetës. Mëngjesin e Pashkës në vitin 1946, Aniseta Fahardo u pagëzua nga ushtaraku Loren Ferre dhe tani njihet si e para filipinase që dihet të jetë bërë anëtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

## Fillimi i Punës Misionare

Pas lufte, grupet e Kishës u riorganizuan në dy baza ushtarake të Shteteve të Bashkuara – Baza Ajrore Klark dhe Baza Detare e Gjirit Sabik – teksa anëtarët shenjtore të ditëve të mëvonshme me shërbim ushtarak mezi e prisnin themelimin e një pranie më zyrtare të Kishës në Filipine. Më 21 gusht 1955, Presidenti Xhozef Fillding Smith (1876–1972) i përkushtoi Filipinet për predikimin e ungjillit. Sidoqoftë, kufizimet ligjore, e vonuan mbërritjen e misionarëve deri në vitin 1961.

Në vitin 1960, Plaku Gordon B. Hinkli (1910–2008), në atë kohë një Ndhmës në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve, i vizitoi Filipinet për disa ditë: “Unë shpreha pikëpamjen se puna misionare do të ishte . . . po aq e frytshme sa ka qenë në shumë vende të tjera të botës”<sup>3</sup>. Vitin pasues, pas shumë përgatitjeje dhe dokumentesh të bëra nga anëtarë të tillë si Maksina Tejt Grim dhe Presidenti Robert S. Tejlor i Misionit Jugor të Lindjes së Largët, si edhe nga miq jashtë Kishës, Plaku Hinkli u kthye në ishujt për t'i ripërkushtuar Filipinet për fillimin e punës misionare.

Më 28 prill 1961, në periferi të Manilës, Plaku Hinkli u takua me një grup të vogël anëtarësh të forcave ushtarake, banorë amerikanë dhe një anëtar filipinas – Dejvid Lagman – dhe bëri një lutje të veçantë “që do të ketë shumë mijëra njerëzish që do ta marrin mesazhin dhe rrjedhimisht do të bekohen”<sup>4</sup>. Ato fjalë, të shqiptuara nga një shërbëtor i vërtetë i Zotit, shpejt u bënë profetike.

Katër misionarët e parë – Rejmond L. Gudson, Herri J. Mëri, Kent C. Lou dhe Nester O. Ledezma – mbërritën në Manila disa javë më vonë. “Filipinasit e pranuan ungjillin me shumë gatishmëri”, vuri re Plaku [Eldër] Lou. “Kur kryefamiljari vendoste të bashkohej me Kishën, në shumë, shumë raste e tërë familja do të bashkohej me Kishën.”<sup>5</sup>

## Kisha Përparon

Puna përparoi deri në pikën ku u organizua Misioni i Filipineve në vitin 1967. Deri në fund të atij viti, kishte 3.193 anëtarë në mision, 631 prej të cilëve ishin kthyer në besim atë vit. Deri në vitin 1973, Kisha në Filipine ishte zgjeruar deri pothuajse në 13.000 anëtarë. Më 20 maj 1973, u krijua Kunji i Manilës në Filipine me Augusto A.

Limin si president. Në 1974 misioni u nda, duke krijuar Misionin e Manilës në Filipine dhe Misionin e Sebu-Sitit në Filipine.

Në gusht të vitit 1975, Presidenti Spenser W. Kimball (1895–1985) erdhi në Manila për të kryesuar konferencën e parë të zonës për Filipinet. Gushti ishte një muaj plot stuhi, duke e bërë udhëtimin më të vështirë për ata që vinin nga zonat jashtë Manilës. Një autobus i mbushur me shenjtorë nga Laoag-Siti për pak nuk ia doli, por shenjtorët e shtynë mjetin e tyre jashtë një pellgu me baltë dhe iu lutën shoferit që të mos kthehej mbrapsht. Një tjetër grup shenjtorësh u përballën trimërisht me detet e stuhishme për tri ditë të plota, sepse gjithçka që ka vërtet rëndësi, sikurse tha një

*1898: Dy anëtarë SHDM ushtarakë predikojnë ungjillin në Filipine gjatë luftës spanjollo-amerikane*



*1944–1945: Më shumë anëtarë SHDM ushtarakë predikojnë gjatë Luftës II Botërore*

një tempull. Pasi mori parasysh disa vende, drejtori dorëzoi një kërkesë për të blerë 3.5 akra (1.4 ha) në Kezon-Siti. Vendi sheh nga lart luginën e Marikinës dhe vendndodhja e tij është relativisht e arritshme për shumë anëtarë të Kishës. Kërkesa u miratua dhe prona u ble në janar 1981. Emri i rrugës u ndryshua në Tempëll Drayv [Rruga e Tempullit] me kërkesë të Kishës.

Për ceremoninë e fillimit të punimeve më 25 gusht 1982, pavarësisht nga kërcënimi prej një tajfuni, rreth 2.000 anëtarë të Kishës u mblodhën nga të gjitha pjesët e ishujve me barkë, tren dhe autobus. Ndërtimi i tempullit filloi shpejt dhe qe gati për t'u përkushtuar në gusht 1984.

Afro 27.000 anëtarë dhe joanëtarë e vizituan tempullin

*1946: Aniseta Fahardo bëhet filipinasja e parë që dihet të jetë pagëzuar dhe konfirmuar si anëtare e Kishës*



*1955: Presidenti Jozef Filding Smith përkushton Filipinet për predikimin e ungjillit*

motër, është të shohësh e të dëgjosh një profet të gjallë të Perëndisë.

Presidenti Kimball i vizitoi Filipinet përsëri në vitin 1980 për të kryesuar mbi një tjetër konferencë zone dhe gjithashtu u takua shkurtimisht me presidentin e Filipineve Ferdinand Markosin. Ky takim i hapi rrugën Kishës që të hapte më vonë një qendër trajnimi për misionarët në Filipine në vitin 1983 dhe që të përkushtonte Tempullin e Manilës në Filipine në vitin pasues. Në vitin 1987 u krijua Zona e Filipineve/Mikronezisë me zyrat qendrore në Manila.

Pjesë të përzgjedhura nga Libri i Mormonit u përkthyen në gjuhën tagaloge në vitin 1987. Përkthimet e Librit të Mormonit janë tani në disa gjuhë filipinase, përfshirë gjuhën sebuanese.

### Bekimet e Tempullit

Në dhjetor të vitit 1980, Presidenti Spenser W. Kimball dërgoi drejtorin e sektorit të pasurive të patundshme të Kishës në Manila për të gjetur një vend të përshtatshëm për

përpara përkushtimit të tij. Ata erdhën pavarësisht prej dy tajfuneve – vetëm 48 orë njëri pas tjetrit – që kishin kaluar duke shkatërruar përmes Filipineve pak ditë më parë. Shenjtorët nga provincat e largëta mbërritën të drobitur, por plot gjallëri. Në shumë raste ata ishin detyruar të bënin itinerare rrethore për në Manila, sepse rrugët ishin përmbytur dhe urat ishin dëmtuar nga lumenjtë e dalë nga shtretërit.

Bukuria e tempullit u la mbresa vizitorëve, duke përfshirë shumë filipinas të mirënjohur. Shkrimtari Selso Karunungan komentoi mbi “një ndjenjë shenjtërie, që, kur hyn brenda, do të përballësh me Krijuesin tënd”. Koloneli Bienvenido Kastijo, kryekapelani i Xhandarmërisë së Filipineve, tha se tempulli “është një vend ku mund të mendosh për gjëra qiellore, sepse je në një mjedis të tillë”. Dy murgësja ndien se “tempulli është vërtet një shtëpi e Zotit”. Eva Estrada-Kalau, një anëtare e parlamentit filipinas, u tha shoqëruesve: “Do të doja që ju të ndërtonit më shumë tempuj këtu”<sup>6</sup>.





Presidenti Hinkli, në atë kohë Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, i udhëhoqi shërbesat që të vendosnin gurin e qoshes të martën, më 25 shtator 1984. Nëntë sesione përkushtuese vijuan, të mbajtura në dhomën celestiale. Afro 6.500 shenjtore nga 16 kunje dhe 22 distrikte në Zonën e Paqësorit morën pjesë në sesionet e ndryshme.

Sapo përfundoi sesioni i fundit përkushtues, Paulo V. Malit i Riu dhe Edna A. Jasona u bënë çifti i parë që u martuan në Tempullin e Manilës në Filipine, më 27 shtator 1984. Presidenti i parë i atij tempulli, W. Garth Endrjus, e

shtëpinë që të paguante udhëtimin në mënyrë që ata dhe fëmijët e tyre të mund të vuloseshin si familje e përjetshme. Pasi e shitën shtëpinë dhe shumicën e zotërimeve të tyre, ata ia dolën të mblidhnin së bashku shumën e saktë për të paguar udhëtimin me barkë deri në Manila për familjen e tyre prej nëntë vetash. Leonidesa shqetësohej ngaqë ata nuk do të kishin shtëpi ku të ktheheshin. Por Bernardo e siguroi atë se Zoti do të gjente një mënyrë për ta. Ata u vulosën si familje për kohën dhe gjithë përjetësinë në tempull në vitin 1985. Ia vlejti çdo sakrificë që kishin

*1961: Filipinet hapen zyrtarisht për punën misionare; mbërrijnë katër misionarët e parë*

*1967: Organizohet Misioni i Filipineve*



*1973: Krijohet Kunji i Manilës në Filipine*

*1974: Ndahet Misioni i Filipineve, duke krijuar Misionin e Manilës në Filipine dhe Misionin e Sebu-Sitit në Filipine*

*1975: Konferenca e parë e zonës, e mbajtur në Manila*

*1983: Qendra e trajnimit të misionarëve hapet në Manila*



celebroi ceremoninë martesore.

Mori anëtarësh të Kishës u vunë në radhë për të marrë indaumentet e tyre, duke nisur me punonjësit e ordinancave. Puna në tempull vazhdoi gjatë natës deri të nesërmen.

Anëtarët ndien një dëshirë më të madhe për të hyrë në tempull. Ata që jetonin larg Manilës, duhej të sakrifikonin shumë për të udhëtuar në një largësi të madhe me barkë ose autobus. Por prapëseprapë, ata erdhën dhe sollën me vete histori besimi dhe vendosmërie.

Për Bernardo dhe Leonides Obedosa nga Heneral Santos, të shkuarit në tempull në Manilën e largët dukej e pamundur. Por si tregtari që shkoi dhe shiti gjithçka kishte për të blerë një perlë me vlerë të madhe (shih Mateu 13:45–46), ky çift vendosi ta shiste

*Një mbledhje e Shoqatës së Ndhmës mbi përgatitjet për urgjencat siguron informacion të vlefshëm për motrat që jetojnë në një vend të prirur ndaj fatkeqësive natyrore.*



bërë, sepse në tempull ata gjetën gëzim të pakrahasueshëm – perlën e tyre të paçmuar. Dhe pikërisht sipas fjalëve të Bernardos, Zoti siguroi vërtet një mënyrë. Gjatë kthimit të tyre nga Manila, njerëz të njohur të mirë u dhanë atyre vende ku të qëndronin. Fëmijët e tyre e përfunduan shkollimin dhe familja më pas bleu shtëpinë e vet në një vendndodhje të re.

Më 18 prill 2006, Presidenca e Parë njoftoi ndërtimin e Tempullit të Sebu-Sitit në Filipine. Sapo e dëgjuan lajmin, shumë anëtarë të Kishës derdhën lot gëzimi. “Ne jemi të bekuar, sepse Zoti ka zgjedhur Sebu-Sitin për të qenë vendi i tempullit të radhës”, tha Sezar Perez i Riu, drejtori i Institutit të Fesë së Sebu-Sitit.

## RRITJA E ANËTARËSISË SË KISHËS NË FILIPINE



1967: 3.193

1970: 13.000

1980: 17.424

1990: 237.000

2000: 373.000

2012: 661.598

Anëtarësia e Përgjithshme e Kishës: 675.166\*

Lagje dhe Degë: 1.134

Misione: 17

Tempuj: 2 (një tjetër në ndërtim)

Qendra për Historinë familjare: 167

\* Deri në shtator 2013

1984: Përkushtohet Tempulli i Manilës në Filipine



1987: Krijohet Zona e Filipineve/ Mikronezisë me zyrat qendrore në Manila



1987: Përkthehen pjesë të përzgjedhura nga Libri i Mormonit në gjuhën tagaloge



2010: Përkushtohet Tempulli i Sebu-Sitit në Filipine

Pak muaj pas përkushtimit të Tempullit të Sebu-Sitit në Filipine, shenjtoret e ditëve të mëvonshme filipinas gjetën edhe njëherë arsye për t'u gëzuar. Më 2 tetor 2010, gjatë fjalimit të tij të hapjes në konferencën e përgjithshme, Presidenti Tomas S. Monson njoftoi ndërtimin e Tempullit të Urdanetës të Filipineve në Pangasinan.

### Më e Mira Nuk Ka Ardher Ende

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në Filipine është relativisht e re, kur krahasohet me praninë e saj në vende të tjera, por fati i saj në kombin e ishujve është i lavdishëm. Rritja e Kishës ka qenë e mrekullueshme dhe më e mira nuk ka ardhur ende. Plaku Majkëll Xhon U. Teh, i Të Shtatëdhjetëve, filipinasi i dytë që u thirr për të shërbyer si Autoritet i Përgjithshëm, tha: “Ne [shenjtoret e ditëve të mëvonshme filipinas] duhet ta përgatisim veten shpirtërisht më tepër se kurrë, sepse puna do të shkojë përpara me ose pa ndihmën tonë”<sup>7</sup>.

Me të vërtetë, teksta shekulli i 21-të rrokulliset, Kisha e rivendosur do të vazhdojë të rritet në numër e në ndikim, teksta gjithnjë e më shumë filipinas e pranojnë mesazhin dhe bëhen një bekim për këtë popull të zgjedhur në ishujt e detit. Për Plakun Teh dhe shenjtoret filipinas, “premtimet [e mëdha të] Zotit për ata që janë në ishujt e detit” (2 Nefi 10:21) tani po përmbushen. ■

### SHËNIME

1. Augusto A. Lim, në R. Lanier Britsch, “Faithful, Good, Virtuous, True’: Pioneers in the Philippines”, *Liahona*, shkurt 1998, f. 44.
2. Augusto Lim, në Gelene Tobias, “Augusto Lim: The Man of Many Firsts”, [countrywebsites.lds.org/ph/index.php/deline-philippines/jubilee-2011](http://countrywebsites.lds.org/ph/index.php/deline-philippines/jubilee-2011).
3. Shih Sheri L. Dew, *Go Forward with Faith: The Biography of Gordon B. Hinckley* (1996), f. 213–215.
4. Gordon B. Hinckley, “Commencement of Missionary Work in the Philippines”, *Tambuli*, prill 1991, f. 18.
5. Intervistë e Kent Klajd Lout nga Xhejms Nil Klark, 3 shtator 2007.
6. Francis M. Orquiola, “Temple Dedication Rewards Faith of Filipino Saints”, *Ensign*, nëntor 1984, f. 107.
7. Michael John U. Teh, “Scriptures and Spiritual Preparation” [Mesazhe të Presidencës së Zonës, maj 2011]; [lds.org/ph/index.php/literature](http://lds.org/ph/index.php/literature).





# PLANIT TË SHPËTIMIT

*Përdorimi i  
për t'iu Përgjigjur  
Pyetjeve*

**Nga LaRen Porter Gant**

Revistat e Kishës

**P**o jetojmë në një kohë emocionale. Ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit po del “nga terri” (DeB 1:30). Si rrjedhim, më shumë fëmijë të Atit Qiellor, që nuk janë të besimit tonë, po dëgjojnë rreth “mormonëve”. Disa dëgjojnë gjëra që tingëllojnë të çuditshme dhe pështjelluese. Të tjerët dëgjojnë gjëra që duken të njohura dhe ngushëlluese. Individët nga secili prej këtyre grupeve mund të vijnë te ne duke kërkuar përgjigje për pyetjet e tyre. Shumë përgjigje gjenden në planin e shpëtimit, që njihet edhe si “plani [i] madh [i] lumturisë” (Alma 42:8).

Pyetjet e bëra rëndom janë: “Nga erdha unë?” “Përse jam këtu?” dhe “Ku do të shkoj pas kësaj jete?” Të gjitha këto pyetje mund të gjejnë përgjigje nga të vërtetat që gjenden në planin e shpëtimit. Ky artikull jep disa nga përgjigjet që shkrimet e shenjta dhe profeti ynë, Presidenti Tomas S. Monson, kanë dhënë lidhur me këto pyetje.

*Besimi te Jezu Krishti  
Pendimi*

JETA PARA LINDJES

KRIJIMI

VELI

VDEKSHMËRIA

## Nga erdha unë?

Ne jemi qenie të përjetshme. Ne jetuam me Perëndinë përpara kësaj jete si fëmijët e Tij shpirtërorë. “Apostulli Pal [na mësoi] se ‘ne jemi pasardhës të Perëndisë’ [Veprat e Apostujve 17:29]”, tha Presidenti Monson. “Duke qenë se e dimë që trupat tanë fizikë e kanë prejardhjen nga prindërit tanë të vdekshëm, duhet të kërkojmë kuptimin e deklarimit të Palit. Zoti deklaroi se ‘fryma e trupi janë shpirti i njeriut’ [DeB 88:15]. Kështu është shpirti që është pasardhës i Perëndisë. Autori i Hebrenjve i drejtohet Atij si ‘Ati [i] shpirtave’ [Hebrenjve 12:9].”<sup>1</sup>

## Përse jam këtu?

Mbi jetën tonë në tokë, Presidenti Monson tha: “Sa mirënjohës duhet të jemi që një Krijues i urtë i dha formë tokës dhe na solli këtu me një vel harrese për ekzistencën tonë të mëparshme në mënyrë që të përjetojmë një periudhë prove, një mundësi për të provuar veten, që të mund të kualifikohemi për gjithçka që Perëndia ka përgatitur që të marrim.

Qartazi, një qëllim kryesor i ekzistencës sonë në tokë është që të marrim një trup prej mishi e kockash. Neve na është dhënë gjithashtu dhurata e lirisë së zgjedhjes. Ne jemi të privilegjuar në një mijë mënyra për të zgjedhur për veten tonë. Këtu ne mësojmë nga mbikëqyrësi i rreptë i përvojës. Ne dallojmë të mirën nga e keqja. Ne bëjmë dallimin mes të hidhurës e të ëmbëlës. Ne zbulojmë se ka pasoja të lidhura me veprimet tona.”<sup>2</sup>

## Ku do të shkoj pas kësaj jete?

Vdekja u vjen të gjithë njerëzve të familjes njerëzore. Por “në qoftë se njeriu vdes, a mund të kthehet përsëri në jetë?” (Jobi 14:14). “Ne e dimë se vdekja nuk është fundi”, tha Presidenti Monson. “Kjo e vërtetë është dhënë mësim nga profetët e gjallë nëpër epoka. Ajo gjendet edhe në shkrimet tona të shenjta. Në Librin e Mormonit ne lexojmë fjalë të posaçme dhe ngushëlluese:

‘Tani, në lidhje me gjendjen e shpirtit midis vdekjes dhe ringjalljes – Vëre, mua m’u bë e ditur nga një engjëll që shpirtat e të gjithë njerëzve, posa

*Kur ne ose të tjerë  
kemi pyetje rreth  
ungjillit të Jezu  
Krishtit, a e dimë  
se ku t’i gjejmë  
përgjigjet?*

*Pagëzimi*

*Dhurata e Frymës së Shenjtë*

*Durimi  
deri në  
fund*





## KU MUND TË MËSOJ MË TEPËR RRETH PLANIT TË SHPËTIMIT?

1. Plani i shpëtimit na mësohet më së qarti në Librin e Mormonit, te Doktrina e Besëlidhjet dhe te Perla me Vlerë të Madhe.
2. Fjalët e profetëve të gjallë gjenden në [conference.lds.org](http://conference.lds.org). Mund të kërkonti terma të tillë si plani i shpëtimit, plani i lumturisë, shlyerja, ekzaltimi, drejtësia e mëshira, pendimi dhe ringjallja.
3. Shih "Mësimi 2: Plani i Shpëtimit" në kapitullin 3 të manualit *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar*.

të largohen nga ky trup i vdekshëm, po, shpirtrat e të gjithë njerëzve, qofshin ata të mirë ose të ligj, çohen në shtëpi tek ai Perëndi që u dha atyre jetë.

Dhe do të ndodhë që shpirtrat e atyre që janë të drejtë pranohen në një gjendje lumturie që quhet parajsë, një gjendje e pushimit, një gjendje e paqes, ku ata do të prehen nga të gjitha trazirat e tyre dhe nga të gjitha vuajtjet dhe brengat' [Alma 40:11–12]."<sup>3</sup>

Pasi ringjallemi, ne shkojmë te mbretëria çelestiale me lavdi si të diellit, mbretëria terrestiale me lavdi si të hënës, mbretëria telestiale me lavdi si të yjeve, ose te errësira e jashtme (shih DeB 76).

### A ka vërtet një Perëndi? A është i vërtetë Satani?

Ati Qiellor, Jezu Krishti dhe Satani ishin të gjithë pjesë e Këshillit të madh në Qiell të mbajtur përpara se ne të lindeshim. Si pjesë e planit të shpëtimit, Ati Qiellor kërkoi që dikush të shkonte në tokë dhe të shlyente për mëkatet tona. Ai tha: "Kë të dërgoj? Dhe njëri [Jezu Krishti] u përgjigj sikurse Biri i Njeriut: Ja ku jam, dërgomë mua. Dhe një tjetër [Satani] u përgjigj e tha: Ja ku jam, dërgomë mua. Dhe Zoti tha: Do të dërgoj të parin.

Dhe i dyti [Satani] u egërsua dhe nuk e ruajti gjendjen e tij të parë; dhe, në atë ditë, shumë e ndoqën atë" (Abraham 3:27–28; shih edhe DeB 29:36–37; Moisiu 4:1–4).

### A e kemi ne fuqinë për t'iu bërë ballë tundimeve të Satanit?

Një e treta e shpirtrave që zgjodhën ta ndiqnin Satanin pas Këshillit në Qiell, u dëbuan bashkë me të. Ata dhe Satani mbetën shpirtra pa trupa fizikë. Profeti Jozef Smith na mësoi: "Të gjitha qeniet që kanë trupa kanë fuqi mbi ato që nuk kanë"<sup>4</sup>. Kështu Satani mund të na tundojë, por ne kemi fuqinë për t'i bërë ballë.

*Bota e Shpirtrave*

VDEKJA

RINGJALLJA





ÇELESTIALI

TERRESTIALI

TELESTIALI

### **Përse duket ndonjëherë sikur Ati Qiellor nuk iu përgjigjet lutjeve të mia?**

“Lutja është akti me anën e të cilit vullneti i Atit dhe vullneti i fëmijës vijnë në bashkërendim me njëri-tjetrin. Qëllimi i lutjes nuk është të ndryshojmë vullnetin e Perëndisë” (Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Lutje”, f. 107). Lutja është një mjet që na ndihmon të vendosim nëse do ta përdorim lirinë tonë të zgjedhjes për ta përputhur vullnetin tonë me atë të Perëndisë (shih Abraham 3:25). Ati Qiellor iu përgjigjet gjithnjë lutjeve tona, por ato përgjigje mund të vijnë në këtë formë: po, jo ose ende jo. Koha e duhur është e rëndësishme.

### **Përse kam sfida kur po mundohem të jetoj një jetë të mirë?**

Sfidat janë pjesë e planit të shpëtimit. Ato na bëjnë më të fortë, na përmirësojnë dhe na pastrojnë teksa mbështetemi te Jezu Krishti dhe ungjilli i Tij. Ati Qiellor na mbështet gjatë sfidave tona. Sprovat tona do të “[na] japin përvojë dhe do të jenë për të mirën [tonë]” (DeB 122:7).

### **Si mund ta di se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar?**

Të gjithë fëmijët e Perëndisë lindin me Dritën e Krishtit, e cila na ndihmon “të dalloj[më] të mirën nga e keqja” (Moroni 7:16). Përveç kësaj, Fryma e Shenjtë mund të na japë dëshmi për të vërtetën në mendjen dhe në zemrën tonë me ndjenja paqeje dhe ngrohtësie (shih DeB 8:2–3).

### **A mund të falem edhe nëse kam bërë mëkate të rënda?**

Perëndia e dinte se të gjithë ne do të mëkatonim ndërkohë që mësojmë të zgjedhim midis së mirës dhe të keqes.<sup>5</sup> Sidoqoftë, të gjitha mëkatet kanë ndëshkime që lidhen me to. Drejtësia kërkon që ne ta vuajmë ndëshkimin. Në mëshirën e Tij, Ati Qiellor e lejoi Jezu Krishtin që të bënte Shlyerjen dhe të plotësonte kërkesat e drejtësisë për të gjithë ne (shih Alma 42). Me fjalë të tjera, vuajtja e Krishtit në Gjetseman dhe vdekja në Golgotë paguan çmimin për të gjitha mëkatet tona nëse marrim nga Shlyerja e Krishtit duke u penduar dhe duke marrë ordinancat e ungjillit. Mëkatet tona do të falen (shih DeB 1:31–32). ■

#### **SHËNIME**

1. Tomas S. Monson, “Vrapimi i Jetës”, *Liahona*, maj 2012, f. 91; shih edhe Abraham 3:22–26.
2. Tomas S. Monson, “Vrapimi i Jetës”, f. 91–92; shih edhe Alma 34:32–34.
3. Tomas S. Monson, “Vrapimi i Jetës”, f. 93; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 76:59–111.
4. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 222.
5. Fëmijët e vegjël nuk mund të mëkatojnë “derisa ata fillojnë të bëhen të përgjegjshëm” (shih DeB 29:46–47).



## NGA E DININ ATO?

Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, u dha një mesazh motrave të Shoqatës së Ndihmës gjatë mbledhjes së përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës për vitin 2011, që më preku në zemër dhe më dha paqe. Ai foli rreth lules së vockël mosmëharro dhe mënyrës se si pesë petalet e saj përfaqësojnë pesë gjëra që ne duhet t'i mbajmë mend përherë.<sup>1</sup>

Pas mbledhjes, ime bijë Alisa, më tregoi një histori për shoqen e saj, Xhesin, që ka një biznes të vogël që shpërndan ushqime me porosi. Xhesiti iu kërkua nga udhëheqëset e Shoqatës së Ndihmës të kujtonte të saj që të bënte një ëmbëlsirë që do të shërbehej pas

mbledhjes së përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës. Xhesi i tha Alisë se e dinte menjëherë se çfarë duhej të bënte – 250 kekë të vegjël. Alisa doli vullnetare që të ndihmonte për transportin e kekëve të vegjël deri te qendra e kunjtit.

Dita e mbledhjes erdhi dhe, kur Alisa shkoi për të dhënë ndihmë, e gjeti Xhesin pothuajse në lot. Kekët e vegjël ishin gati, por Xhesi i kishte dërguar një fotografi të tyre një të afërmeje, e cila tha se nuk ishin aq të sofistikuar sa duhej për mbledhjen.

Xhesi filloi të vinte veten në dyshim. Ajo arriti në përfundimin se udhëheqëset e Shoqatës së Ndihmës do të prisnin diçka më të ngritur sesa

kekët e saj të vegjël e të thjeshtë. Ajo po përpiqej si e xhindosur të gjente një mënyrë për t'i rizbukuar kekët, por nuk kishte kohë. Ajo dhe Alisa i morën kekët siç ishin, me Xhesin që ndiente se i kishte zhgënjyer motrat – derisa foli Presidenti Uhtdorf.

Teksa ai foli për lulen e vogël mosmëharro, një fotografi e një luleje të vogël blu u shfaq në ekran. Ishte një lule aq e thjeshtë, por aq e bukur me petalet e saj të vijëzuara në mënyrë të brishtë. Mesazhi i Presidentit Uhtdorf ia preku zemrën gjithsecilës, ndërkohë që ai na u lut të mos hutohemi nga lulëzimet e mëdha ekzotike rreth nesh aq sa të harrojmë pesë të vërtetat e thjeshta, por të vërteta, që ai po na mësonte.

Pas lutjes së mbylljes, motrat shkuan për te salla kulturore. Kur hynë Alisa dhe Xhesi, ato i gjetën të gjitha gratë rrotull tryezës së ëmbëlsirave duke pyetur: “Nga e dinin ato?”

Çdo kek i vogël ishte mbuluar me krem të bardhë dhe ishte zbukuruar me një lule mosmëharro, të thjeshtë, të brishtë, me pesë petale. ■

Gejl Ashcroft, Arizona, SHBA

### SHËNIM

1. Shih Diter F. Uhtdorf, “Mosmëharro”, *Liahona*, maj 2011, f. 120.

Kekët e vegjël ishin gati, por Xhesi i kishte dërguar një fotografi të tyre një të afërmeje, e cila tha se nuk ishin aq të sofistikuar sa duhej për mbledhjen.



# PREMTIMI MË DHA SHPRESË

**P**ak kohë pasi bashkëshorti im dhe unë u martuam, ne u bekuam me një djalë. Ku e pashë buzëqeshjen e tij dhe e hodha vështrimin tek sytë e tij, u ndjeva në borxh me Atin Qiellor. Biri im m'u duk i përsosur. Bashkëshorti im dhe unë e falënderonim Zotin çdo ditë për një dhuratë kaq të çmuar.

Më 19 shkurt 2009, po bëja gati plaçkat që të kthehesha në shkollë për vitin tim të fundit të klasave mësimore. Burri im dhe unë nuk e dinim se të nesërmen birin tonë të dashur do ta zinte një ethe dhe ai do të largohej nga kjo jetë në vdekshmëri.

Ishte një përvojë e vështirë për mua për ta duruar. Anëtarët e lagjes sonë na erdhën në shtëpi për të na ngushëlluar me shkrime të shenjta e himne dhe për t'u lutur me ne. Ma ngrohnin zemrën ngushëllimet e tyre të dhembshura, por më vazhdonte hidhërimi për birin tim. Sa herë që mendoja për të, sytë më mbusheshin plot me lot.

Katër ditë pas vdekjes së tij, u frymëzova të studioja *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith*. Ndërsa e mbaja librin, ai m'u hap në duar te kapitulli i titulluar "Fjalë Shprese dhe Ngushëllimi në Kohën e Vdekjes". Fillova të lexoja dhe u preka thellësisht nga humbjet tragjike që Jozefi dhe Ema patën vuajtur kur filluan familjen e tyre. Kur arrita te një pjesë e shkëputur nga një fjalim që Profeti e dha në varrimin e një vajze dyvjeçare, ndjeva sikur ujë i ftohtë më ishte derdhur mbi kokë, duke m'i qetësuar mendimet e mia të pushtuara nga hidhërimi.

E thirra burrin tim. Së bashku lexuam: "Kam bërë pyetjen . . . përse foshnjat, fëmijët e pafajshëm, merren prej nesh. . . . Zoti merr shumë me vete, madje në foshnjëri, që ata të mund t'i shpëtojnë . . . dhimbjeve e të ligave të kësaj bote të tashme; ata qenë tepër të pastër, tepër të dashur, që të jetonin në tokë; prandaj, nëse gjykohet si duhet, në vend që të mbajmë zi, ne kemi arsye të gëzojmë pasi ata janë çliruar nga e liga dhe ne do t'i kemi ata përsëri së shpejti."

Profeti shtoi: "Mund të bëhet një pyetje – 'A do t'i kenë nënat fëmijët e tyre në përjetësi?' Po! Po! Nëna, ju do t'i keni fëmijët tuaj; sepse ata do të kenë jetë të përjetshme, sepse borxhi i tyre është paguar."<sup>1</sup>

**N**dërsa e mbaja librin, kapitulli i titulluar "Fjalë Shprese dhe Ngushëllimi në Kohën e Vdekjes" m'u hap në duar.

Që kur i lexuam ato fjalë të bukura, lutjet tona familjare kanë qenë plot falënderim për premtimin që, nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, ne vërtet do të jemi me birin tonë përsëri.

Sot kemi tre fëmijë të mrekullueshëm, që e kanë vëlla birin tonë të vdekur. Ne po u mësojmë atyre ungjillin e vërtetë dhe të përjetshëm, i cili do t'i udhëheqë ata drejt Atit të tyre Qiellor dhe Shpëtimtarit të tyre, Jezu Krishtit.

E di se mesazhi i Profetit Jozef Smith për jetën pas vdekjes është i vërtetë. Do të jem përherë mirënjohëse për shpresën, paqen, gëzimin dhe lumturinë që ai i sjell familjes tonë – në të dyja anët e velit. ■  
Xhuliana Fajehun, Lagos, Nigeri

## SHËNIM

1. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 184-185.





# PATA SHUMË PËR TË NDARË

**G**jithmonë kisha menduar për përgatitjen për urgjenca lidhur me përkujdesjen për familjen time dhe veten time. Por mësova ta shihja përgatitjen ndryshe një mëngjes të diele në Floridën jugore në vitin 1992. Uragani Endrju, një nga uraganet më shkatërrues dhe më dëmtues që goditi Shtetet e Bashkuara, e ndërpreu një verë të bukur në Majami, Florida.

Unë po jetoja përkohësisht i vetëm në një apartament në plazh, ndërkohe që vazhdoja një program tremujor orientimi për punën time. Kur erdhi paralajmërimi i uraganit dhe mësova se do të nevojitej të largoheshim nga kompleksi i apartamenteve para mesditës, një bashkëpunëtor prenotoi dhoma hoteli në një zonë larg bregdetit për bashkëpunëtorët e mi dhe mua. I zura dritaret me dërrasa dhe i vura në një vend të sigurt gjërat e mia vetjake.

Në përgatitje për një vizitë njëjavore nga gruaja dhe fëmijët e mi, që më

parë unë pata blerë ushqim dhe ujë të mjaftueshëm për familjen time prej gjashtë vetash. Gjeta ngushëllim duke e ditur se kisha një vend të sigurt ku të shkoja dhe ushqim të mjaftueshëm për ta marrë me vete që të më mjaftonte për disa javë.

Ndërsa u përgatita të largohesha në 10:30 të mëngjesit, u ndjeva mirë – gjithçka ishte në rregull. U gjuhëzova në lutje, duke e falënderuar Atin Qiellor për bekimet e mia dhe duke kërkuar ndihmën e Tij gjatë stuhisë që po vinte. Ndërsa po e mbaroja lutjen time, Shpirti më nxiti të them: “Nëse ka ndonjë që ka nevojë për ndihmë, ju lutem më ndihmoni ta gjej atë burrë ose grua”.

Brenda pak minutash, një e ve 80-vjeçare trokiti në derën time. “Më falni”, tha ajo. “Jam në dhomën e gabuar. Po kërkoj një shoqe.”

U duk e rraskapitur. Kur e pyeta nëse mund të ndihmoja, ajo u shqetësua dhe tha se nuk dinte se çfarë të

bënte apo ku të shkonte. E pyeta se ku jetonte dhe së bashku ecëm drejt apartamentit të saj, vlerësuam situatën e saj dhe u hodhëm një sy mundësive të saj.

I thashë se kompania ime mund të kishte vend në një prej dhomave tona të hotelit dhe e ftova të qëndronte me grupin tonë. Ajo psherëtiu me lehtësim. Me shpejtësi i paketuam gjërat dhe i siguroam apartamentin dhe plaçkat e saj dhe e rregullova me një bashkëpunëtor për ta çuar atë me makinë në hotel.

Ndërsa po bëhesha gati të largohesha, dy të veja të tjera kërkuan ndihmë. I ndihmova të qetësoheshin që të mund të mendonin qartësisht dhe të merrnin parasysh se ku mund të gjenin strehim. Kur po i merrja bagazhin njërit prej bashkëpunëtorëve të mi, një tjetër e ve e moshuar kërkoi ndihmë. I vendosëm gjërat e saj të thyeshme në vende të sigurta dhe e ndihmuam atë të përgatitej për t’u larguar.

Ndërkohë, bashkëpunëtorët e tjerë ftuan dy studentë kolegji që po jetonin në një ishull, të qëndronin me grupin tonë në hotel larg bregdetit. I vetmi ushqim që kishin, ishte një sasi e vogël ushqimesh të thata dhe një shishe gati 1 litërshë me ujë mineral. Për fat të mirë, unë kisha mjaft për t’iu dhënë jo vetëm atyre, por edhe gjithë të tjerëve.

Çfarë bekimi ishte të isha i përgatitur dhe i udhëhequr nga Zoti! Kjo më lejoi të siguroja një ndikim qetësues gjatë një kohe shqetësimi të madh dhe ta kaloja pothuajse të gjithë kohën time duke i ndihmuar të tjerët pa u shqetësuar për veten time. Fitova një nivel të ri vlerësimi për këshillën e dhënë nga udhëheqësit tanë të priftërisë për të qenë të përgatitur. ■

Brent Fisher, Kaliforni, SHBA

**K**ur e pyeta nëse mund ta ndihmoja, gruaja u shqetësua dhe tha se nuk dinte se çfarë të bënte ose ku të shkonte.



# DUKE PRITUR LINDJEN E DIELLIT

Hijet e mbuluan dhomën me errësirë teksa qëndroja zgjuar e shtrirë, duke dëgjuar frymëmarrjen e burrit tim, duke u përpjekur të përcaktoja nëse po flinte. Kishin kaluar vetëm dy ditë që kur bija jonë 12-vjeçare kishte ndërruar jetë nga një aksident i papritur tronditës. I mbylla sytë përsëri, por gjumi më kishte ikur. Zemra më pikonte për bijën time. Gjithë njohuria për planin e shpëtimit nuk mund ta lehtësonte dhembjen e mungesës së saj.

Ndërsa po afrohej agimi, ndjeva një mall të papritur, të fuqishëm. Dielli do të lindte së shpejti dhe në mendjen time pashë qiellin e larë me një dritë të zbehtë ngjyrë rozë. Bija jonë e donte shumë ngjyrën rozë. Një lindje me ngjyrë rozë e diellit do të ishte pikërisht gjëja që kisha nevojë që të ndihesha pranë saj përsëri.

“Eja të shkojmë për të parë lindjen e diellit”, i pëshpërita burrit tim të përgjumur.

Qëndruam në oborrin e shtëpisë, duke parë drejt lindjes dhe pritëm . . . e pritëm. Edhe pse qielli u zbardh, dielli nuk doli përmes reve që shtrihe-shin në nivelin e poshtëm.

E vura kokën në supin e burrit tim dhe psherëtiva, duke u përpjekur të shtiresha sikur s’kishte rëndësi. Por unë dëshiroja më shumë. Kisha nevojë për më shumë. Sigurisht Ati Qiellor mund të ma kishte plotësuar këtë dëshirë pasi na e kishte marrë vajzën tonë të ëmbël në shtëpi tek Ai.

Ndërsa burri im u kthye për të hyrë në shtëpi, duke parë pas nesh drejt perëndimit, ai tha: “Shih!”


U ktheva. Pas nesh, retë ishin larë nga një dritë e artë me një skuqje

të brishtë që i rrethonte ato. M’u zu fryma dhe lotët më rrodhën nga sytë. Ishte më e bukur nga sa mund ta kisha përfytyruar. U ndje si një përqa-fim nga bija jonë. E dija se Ati Qiellor ishte i vetëdijshëm për zemrën time plot dhembje dhe po dërgonte një premtim shprese për të ardhmen – një shenjë përkujtuuese të ëmbël të familjeve të përjetshme dhe të të gjitha çasteve të bukura që ende do të vinin.

Kam menduar shpesh për atë çast të bukur dhe për këndvështrimin e ri që më dha ai. Kush shikon për një lindje të diellit në perëndim? Dhe prapëseprapë atje po priste mrekullia ime. Sa shumë bekime dhe mrekulli i humbas ngaqë ato vijnë prej vendesh të papritura? Sa herë përqendrohëm në atë që mendoj se duhet të jetë dhe e humbas lavdinë e asaj që është?

Ne ishim lutur pa pushim për një mrekulli që na u mohua, por ndërsa hodha vështrimin përreth me këndvështrimin tim të ri, unë pashë mrekullinë e katër jetëve që u bënë më të mira nëpërmjet dhurimeve të organeve të bijës sonë, mrekullinë e dashurisë familjare dhe të unitetit të lagjes dhe mrekullinë e shërbimit. Kam ndier hidhërim të thellë, por gjithashtu kam ndier shpresë të fuqishme të ma mbushë shpirtin tim me secilën lindje të skuqur lehtë të diellit, me secilin perëndim të rozhtë të diellit dhe me secilën lule rozë që më del përpara në shtegun tim.

Tani, teksa lind dielli, unë shoh nga lindja dhe mandej kthehem për të parë nga perëndimi. Buzëqesh me mendimin se ka gjithmonë mrekulli dhe bekime për t’u gjetur – dhe që dielli gjithmonë do të lindë mbi hidhërimet tona, në qoftë se e lejojmë atë. ■  
Xhulia Vagner, Ohajo, SHBA



Ndërsa burri im u kthye për të hyrë në shtëpi, duke parë pas nesh drejt perëndimit, ai tha: “Shih!” Pas nesh, retë ishin larë nga një skuqje e brishtë.



Si mund të na ndihmojë të jetuarit me thjeshtësi në të folur, sjellje dhe paraqitje për të rrezatuar dritë dhe për të përlevduar Perëndinë?

## Nëse Syri Juaj Drejtohet te

Nga Kethrin Nelson dhe Haidi Mek-Konki

**N**ë Këshillin në Qiell para lindjes, kur Jezu Krishti doli vullnetar që të bëhej Shpëtimtari ynë, Ai i tha Atit: “Vullneti yt u bëftë dhe lavdia qoftë e jotja përgjithmonë” (Moisiu 4:2).

Zoti gjithmonë ka dhënë shembullin e përlevdimit të Atit. Gjatë shërbesës së Tij në vdekshmëri, Shpëtimtari kurrë nuk e tërhoqi vëmendjen drejt Vetvetes, por përkundrazi i drejtoi pasuesit e Tij tek Ati, duke i mësuar: “Kush beson në mua, nuk beson në mua, por në atë që më ka dërguar” (Gjoni 12:44). Në sjellje, paraqitje, fjalë dhe veprim, Shpëtimtari na mësoi rreth rëndësisë së thjeshtësisë.

Në përkushtimin e tyre për ta ndjekur Shpëtimtarin, të rinjtë në moshë madhore, të cituar në këtë artikull, mendojnë rreth shprehjeve të tyre të brendshme e të jashtme të thjeshtësisë dhe tregojnë se si zotimi i tyre për ta përlevduar Perëndinë i ka dhënë formë karakterit të tyre dhe i ka udhëhequr veprimet e tyre.

### Përlevdoni Perëndinë dhe Rrezatoni Dritë

Ne e dallojmë më mirë se si thjeshtësia e përlevdon Perëndinë kur e

# Lavdia Ime

kuptojmë se çfarë është me të vërtetë thjeshtësia. *Të Vërtetë ndaj Besimit* shpjegon: “Thjeshtësia është mbajtja e një qëndrimi të përlulur dhe të hijshëm në veshje, në zbulim, në gjuhë dhe në sjellje. Kur jeni i thjeshtë, nuk do të kërkonti të tërhiqni vëmendje të tepruar mbi ju. Në vend të kësaj, ju kërkonti të ‘përlevdoni Perëndinë . . . në trupin tuaj dhe në frymën tuaj’ (1 Korintasve 6:20).”<sup>1</sup>

Kur mësojmë të tregojmë thjeshtësi sikurse bëri Shpëtimtari, ne e mirëpresim Shpirtin në jetën tonë, duke plotësuar premtimin që “nëse syri juaj drejtohet te lavdia [e Perëndisë], tërë [trupi juaj] do të mbushet me dritë” (DeB 88:67). Teksa lexoni se si e kuptojnë të rinjtë të tjerë në moshë madhore thjeshtësinë, ju mund të merrni parasysh se si ta shtoni vetë dritën tuaj shpirtërore duke bërë rregullime për ta përmirësuar zotimin tuaj brenda vetes ndaj thjeshtësisë dhe shfaqjes së jashtme të saj.

### Jini të Thjeshtë në të Folur dhe në Sjellje

“Fjalët dhe veprimet tuaja mund të kenë ndikim të thellë tek ju dhe tek të tjerët. Shprehuni me anë të gjuhës së pastër, pozitive e lartësuese dhe me veprime që u sjellin lumturi atyre përreth. Përpjekjet tuaja që të jeni i thjeshtë në fjalë e në vepra, çojnë drejt rritjes së udhëheqjes dhe ngushëllimit nga Fryma e Shenjtë.”<sup>2</sup>

Darja Sergevna Shvidko nga Volgograd në Rusi shpjegon se ne jemi të thjeshtë në të folurën tonë kur i trajtojmë të tjerët me respekt dhe përdorim “butësi të zërit dhe shprehje të qetë të mendimeve tona, pa përdorur fjalë të ashpra ose të papërshtatshme”. Gjuha e thjeshtë është e çliruar nga thashethemet, përqeshjet, tallja dhe sarkazma. Nuk i ul poshtë të tjerët ose nuk nxit egoizëm; ajo thjesht tregon mirësi ndaj të gjithë fëmijëve të Atit Qielor dhe dallon natyrën hyjnore të tyre.



TË RINJTË NË MOSHË MADHORE



E folura jonë gjithashtu duhet të tregojë respekt për Kreun-Perëndi: “Largoni gjuhën e ndyrë dhe të shkujdesur, përdorimin e emrit të Zotit pa respekt, të cilat janë aq të rëndomta në botë. . . . Natyra e një gjuhe . . . të tillë me mungesë respekti dëmton aftësinë [tonë] për të marrë nxitjet e qeta të Frymës së Shenjtë.”<sup>3</sup>

Po ashtu sikurse e folura pa

**“Thjeshtësia është mbajtja e një qëndrimi të përlulur dhe të hijshëm në veshje, në zbulim, në gjuhë dhe në sjellje. Kur jeni i thjeshtë, nuk do të kërkonti të tërhiqni vëmendje të tepruar mbi ju.”**

thjeshtësi, e tillë si thashethemet dhe tallja, mund t'i dëmtojë marrëdhëniet, e folura me thjeshtësi kultivon një zotim më të madh ndaj Perëndisë dhe, ashtu si Kelli Pru nga Juta, SHBA, shpjegon: “rrit aftësinë tonë për të ndërtuar marrëdhënie të mira me të tjerët. E folura jonë me thjeshtësi na ndihmon për të nxjerrë në pah natyrën më të mirë të të tjerëve.”

Thjeshtësia në të folur dhe thjeshtësia në sjellje janë të lidhura ngushtë. “Është e rëndësishme që të jeni të thjeshtë në të folur dhe në sjellje, sepse ajo tregon se kush jeni dhe çfarë vlere keni”, thotë Majk Olsen nga Juta. Njerëzit e vënë re kur fjalët

dhe veprimet nuk përputhen. Gjuha jonë që i lartëson të tjerët moralisht dhe që përlëndon Perëndinë, duhet të shoqërohet nga veprime që i përputhen asaj. Nëpërmjet veprimeve të shërbimit dhe mirësisë, ne vëmë në dukje se zotimi ynë për t'i lartësuar moralisht të tjerët dhe për ta nderuar Perëndinë shkon edhe më thellë se fjalët tona. Shembujt tanë të dishepullimit në fjalë dhe veprim mund të jenë një ndikim për mirë.

“Me të vërtetë e vlerësoj thjeshtësinë në sjellje dhe të folur”, thotë Keri Karlson nga Kolorado, SHBA. “Ka diçka shumë të këndshme te dikush që është i përlulur dhe nuk bën gjëra për qëllimin e tërheqjes së vëmendjes. Ata që flasin me thjeshtësi, bëhen mjete të fuqishme për Zotin.”

### **Jini të Thjeshtë në Veshje dhe në Pamje**

“Thjeshtësia [në veshje] ndihmon për të nxjerrë në pah natyrën tonë më të mirë duke na ndihmuar të përqendrohemi te njeriu shpirtëror në vend të njeriut natyror”, thotë Pol Keiv nga Juta. Duke u veshur me thjeshtësi, ne i nxisim të tjerët që të mund të na njojnë dhe të na vlerësojnë për personalitetin dhe karakterin tonë më shumë sesa për mënyrën se si dukemi.

Mënyra se si vishemi jo vetëm që u tregon të tjerëve se si duhet të na trajtojnë, por ndikon edhe mënyrën se si e shohim dhe e trajtojmë veten tonë. “Ne mësojmë nga ungjilli se trupi ynë është një dhuratë nga Perëndia”, thotë Luis Da Kruz i Riu, nga Brazili. “Trupat tanë na ndihmojnë të përparojmë dhe të bëhemi siç është Ati ynë. Për këtë arsye është e rëndësishme të vishemi

me thjeshtësi. Duke bërë kështu, ne i tregojmë Perëndisë dhe të tjerëve se kemi respekt për këtë dhuratë dhe për të tjerët.”<sup>4</sup>

Keri shpjegon: “Të veshurit pa thjeshtësi ka për qëllim ta portretizojë trupin si një objekt fizik që është i shkëputur nga një shpirt me personalitet dhe karakter. Të qenit e thjeshtë, edhe pse më ka kushtuar më shumë para nganjëherë dhe sigurisht më shumë kohë, më ka ndihmuar të mësoj se trupi im është ena mbajtëse e një shpirti të çmuar me potencial dhe përfundim hyjnor, të lindur dhe të rritur nga Prindër Qiellorë. Ai meriton shumë më tepër kujdes dhe respekt sesa do t'i jepte bota.”

*Të Vërtetë ndaj Besimit* na mëson: “Pëveç mënjanimin të [veshjeve jo të thjeshta], duhet të shmangni kalimin në modele ekstreme të veshjes, paraqitjes dhe prerjes së flokëve. Në veshje, në zbulim dhe në modele përherë qëndroni i saktë dhe i pastër, asnjëherë i çrregullt ose i shkujdesur në mënyrë të pavend.”<sup>5</sup> Nëpërmjet mënyrës se si vishemi dhe e paraqitim veten, ne komunikojmë respektin tonë për Perëndinë, për veten tonë dhe për të tjerët.

### **Zotohuni për Vazhdueshmëri**

Kur përpiqemi të ndjekim standardet e ungjillit për thjeshtësinë, ne tregojmë zotimin tonë me anë të vazhdueshmërisë, duke iu bindur urdhërimeve të Zotit gjatë gjithë kohës, jo vetëm në rastet kur është e volitshme.

Zotimi i vërtetë gjithnjë i ka rrënjët të parimet e ungjillit. Enthëni Roberts nga Juta shpjegon: “Thjeshtësia është një gjendje e mendjes, një dëshirë për të

ecur çdo ditë duke e kuptuar ungjillin dhe planin e shpëtimit”. Kur e zhysim veten në ungjill, kthimi ynë në besim mund të thellohet dhe të rritet dëshira jonë për t'i jetuar parimet e ungjillit.

### Të Kuptuarit e Natyrës Suaj Hyjnore

Të praktikuarit e thjeshtësisë në mënyrë të vazhdueshme na ndihmon



ta kuptojmë dhe ta vlerësojmë të drejtën tonë të parëbirmisë dhe njohja e natyrës sonë hyjnore mund të na frymëzojë të jemi më të thjeshtë. Rafaela Ferini nga Firenze në Itali, shpjegon: “Thjeshtësia e bekon jetën time, sepse më ndihmon të ndihem si bijë e veçantë e Atit tim Qiellor dhe ajo dituri, si rrjedhim, më bën të kem dëshirë të jem e thjeshtë”.

Të lejuarit e botës që të përcaktojë se cilët jemi, mund ta dëmtojë vetëvlerësimin tonë. Xhuliana Auna nga Juta përshkruan përvojën e saj: “Përpara se të fitoja dëshmi për parimin e thjeshtësisë, unë isha në një gjendje të

palumtur dhe të pasigurt shpirtërisht. Të lejuarit e botës që të përcaktonte se kush isha, ishte dëshpëruese dhe gjymtuese moralisht, sepse mania e botës me gjërat materiale, fizike është e ashpër dhe e pamëshirshme. Sapo vendosa të mos ia vija veshin botës dhe ta lejoja marrëdhënien time me Perëndinë të më përcaktonte mua në vend të saj, jeta u bë më e lehtë, më e lirë dhe më e lumtur.” Kur kërkojmë miratim nga Ati Qiellor në vend të miratimit të botës, ne vërtet do të gjejmë gëzim më të madh në jetë dhe shtysë më të madhe për të qenë të thjeshtë.

### Jetoni një Jetë të Thjeshtë

“Thjeshtësia shprehet në gjithçka që bëjmë: të folurën tonë, pamjen tonë të jashtme, sjelljen tonë dhe madje vendet që vizitojmë”, thotë Galina Viktorovna Savçuk nga Novosibirsk në Rusi. Të jetuarit me thjeshtësi lidhet ngushtësisht me zotimin tonë ndaj ungjillit dhe ndaj marrëdhënies sonë me Perëndinë.

Thjeshtësia e vërtetë është një ndërthurje si e sjelljes, ashtu dhe e qëndrimit. Të punuarit për ta përmirësuar qoftë sjelljen tonë apo mënyrën se si i shohim gjërat, do të na ndihmojë ta përmirësojmë tjetrën. Të qenit të thjeshtë në sjelljen dhe paraqitjen tonë pa zhvilluar një zotim gjatë gjithë jetës nuk na lejon të marrim bekimet e plotësimit të jetuarit me thjeshtësi. Dhe të besuarit se vetë jemi njerëz të thjeshtë, pa i kryer deri në fund veprimet tona, është vetëmashtrim.<sup>6</sup>

Në kontekstin e thjeshtësisë, të thuash që sytë tanë drejtohen vetëm te lavdia e Perëndisë do të thotë që ne zotohemi nga ana e jashtme dhe e

brendshme për të jetuar me thjeshtësi. Po ashtu si syri duhet të drejtohet te Perëndia, pamja jonë e jashtme dhe veprimet tona të jashtme duhet të jenë në përputhje me parimet e thjeshtësisë. Por vetëm të drejtuarit e syrit te Perëndia, nuk e bën atë të drejtuar te lavdia e Tij; syri duhet të përqendrohet tek Ai. Në mënyrë të ngjashme, veshja dhe paraqitja e jashtme e thjeshtë duhet të shoqërohen me një përqendrim te parimet e përjetshme.

Kur i kthejmë sytë tanë drejt Perëndisë, ne vërtet do të jemi në gjendje ta përqendrojmë më me lehtësi përqendrimin tonë tek Ai. Po ashtu, ndërsa e përqendrojmë shikimin tonë te Perëndia, sytë tanë do të tërhiqen në mënyrë të natyrshme drejt Tij.

Kur përpiqemi të jetojmë me thjeshtësi, ne vërtet do ta ndiejmë ndikimin e Shpirtit të rritet në jetën tonë. Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, na ka mësuar: “Thjeshtësia është thelbësore për të qenit të denjë për Shpirtin. Të jesh i thjeshtë do të thotë të jesh i përlurur dhe të qenit i përlurur e fton Shpirtin që të jetë me ne.”<sup>7</sup> Me Shpirtin duke i drejtuar mendimet dhe veprimet tona, sytë tanë do të drejtohen te lavdia e Perëndisë dhe ne vërtet do të jemi plot me dritë. ■

*Kethrin Nelson jeton në Juta, SHBA. Haidi Mek-Konki jeton në Delauer, SHBA.*

#### SHËNIME

1. *Të Vërtetë ndaj Besimit: Një Referim për Ungjillin* (2004), f. 185.
2. *Të Vërtetë ndaj Besimit*, f. 187.
3. *Të Vërtetë ndaj Besimit*, f. 187.
4. Shih *Të Vërtetë ndaj Besimit*, f. 186.
5. *Të Vërtetë ndaj Besimit*, f. 186.
6. Shih Lin G. Robins, “Çfarë Lloj Burrash dhe Grash Duhet të Jeni?” *Liahona*, maj 2011, f. 103.
7. Robert D. Hales, “Modesty: Reverence for the Lord”, *Liahona*, gusht 2008, f. 18.



# Finlandë

Kthim në Besim dhe  
Sakrificë në

Nga Melisa Zenteno

**P**ak kilometra larg nga bregdeti i Helsinkit në Finlandë është fortesa detare e Suomenlinës, e ndërtaur në shekullin e 18-të, për t'u mbrojtur nga pushtuesit. Duke u shtrirë përmes gjashtë ishujve, kjo kështjellë përfaqëson vendosmërinë e paepur të popullit finlandez.

Por anëtarët finlandezë vizitojnë një ndërtesë të ndryshme kur udhëtojnë drejt kryeqytetit të tyre. Tempulli i Helsinkit në Finlandë është një simbol fizik i kthimit të tyre në besim dhe i mbrojtjes që marrin nga të jetuarit e ungjillit.

Për Nilo Kervinen, një të ri 24-vjeçar nga Rovaniemi në Finlandë, udhëtimi me tren për 10 orë për në Helsinki është një çmim i vogël për t'u paguar për bekimin e të shërbyerit në tempull.

Përpara përkushtimit të Tempullit të Helsinkit në Finlandë në tetor 2006, Nilo dhe anëtarë të tjerë të lagjes së tij, duhej të udhëtonin për tek Tempulli i Stokholmit në Suedi ose për tek tempulli i Kopenhagës në Danimarkë. “Zakonisht, udhëtimet zgjatnin një javë gjatë pushimeve të

verës”, kujton ai. Rruga e bërë me autobus dhe fjetja në tenda në ato udhëtime janë disa nga kujtimet më të mira që ka ai.

Prapëseprapë, të pasurit e një tempulli në tokën e tij amtare është një bekim i mrekullueshëm. “Kur e njoftuan tempullin e Helsinkit, unë isha kaq i lumtur”, thotë Nilo. “Lutja përku-shtuese ende më tingëllon në zemër çdo herë që hyj brenda.”

Kjo dashuri për tempullin e veçon Nilon nga miqtë e tij. “Finlandezët punojnë shumë dhe u pëlqen të jenë aktivë, por lënë pak kohë për gjëra shpirtërore në jetën e tyre”, shpjegon ai. Edhe pse Nilo thotë se ai gjithmonë është bekuar me miq të mirë, ndërsa rritej, dallimi midis mënyrës se si jetonin miqtë e tij dhe se si u mësua ai të jetonte, u bë më i qartë. Ishte ky ndryshim që e bëri Nilon të kërkonte dëshminë e vet kur ishte 17 vjeç. “Duhej të merrja një vendim se ku të qëndroja dhe se cili të isha”, thotë ai. “Me bekimet e Zotit dhe me udhërrëfimin e familjes dhe të miqve të mirë, unë mora një dëshmi më të fortë për Kishën.”

**Çfarë do të thotë të jesh një i ri në moshë madhore besnik në Finlandë? Një i ri tregon për kulturën e tij dhe besimin e tij fetar.**

Duke folur për kthimin në besim, Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ka thënë: “Unë ju premtoj se, ndërsa vijmë te njohuria e së vërtetës dhe kthehemi në besim te Zoti, ne do të mbetemi të vendosur e të paepur dhe nuk do të heqim dorë kurrë nga besimi ynë”<sup>1</sup>. Edhe pse udhëtimi për në Helsinki kërkon kohë dhe para, Nilo është i zotuar për të qenë një dishepull i Krishtit. Dhe për Nilon, ajo nuk është aspak sakrificë. ■

#### SHËNIM

1. Dejvid A. Bednar, “Të Kthyer në Besim të Zoti”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 109.

**MË SHUMË PËR NILON****Çfarë hanë kryesisht finlandezët?**

Disa nga gjellët e mia të parapëlqyera përfshijnë supën me salmon dhe mishin e drrit me patate të shtypura. Ne e hamë shumë edhe bukën e thekrës.

**Çfarë bën për argëtim?**

Më pëlqen të rrëshqas në dëborë, të shoh filma ose thjesht më pëlqen të shëtis në natyrë. Unë shërbeva në mision në Japoni, kështu që e studioj japonishten kur mundem.

**Si është dalja në takime në Finlandë?**

Nuk kemi një kulturë të fortë të daljes në takime. Në përgjithësi njerëzit i kërkojnë dikujt të dalë në takim me ta vetëm pasi kanë tashmë një interes të konsiderueshëm për ta. Këtu, dalja në takime nuk është një mekanizëm për ta njohur dikë. Këtu ka të rinj në moshë madhore besnikë, edhe pse nuk ka shumë anëtarë. Nganjëherë anëtarët e rinj në moshë madhore udhëtojnë në largësi të mëdha për të dalë në një takim me një njeri që e takuan në një mbrëmje vallëzimi për të rinjtë në moshë madhore.

**KISHA NË FINLANDË**

4.715 shenjtorë të ditëve të mëvonshme

15 lagje

15 degë

2 kunjë

1 mision

1 tempull, i përkushtuar më 22 tetor 2006

**ME SHIFRA**

5.250.000 njerëz (deri në janar 2012)

187.888 liqene

179.584 ishuj

2,2 milionë sauna

**FAKTE**

Kryeqyteti: Helsinki

Gjuha: Finlandeze (Suomi)





# BURRAT DHE GRATË NË PUNËN E ZOTIT

*Në planin e mrekullueshëm të Atit tonë Qiellor që u jep burrave fuqinë e priftërisë, burrat dhe gratë kanë role të ndryshme por njësoj të vlerësuara.*



**Nga Plaku  
M. Rasëll Ballard,**  
i Kuorumit të  
Dymbëdhjetë  
Apostujve

**U**në besoj se ka disa të vërteta që si gratë, ashtu edhe burrat duhet të kuptojnë rreth rolit thelbësor që gratë kanë në forcimin dhe ngritjen e mbretërisë së Perëndisë mbi tokë. Gratë janë zemra e Kishës në kaq shumë mënyra. Ndaj me ndihmën e Zotit, do të dëshiroja të shprehja nderim për gratë dhe të rejat besnike të Kishës. Ju motra të dashura, kudo që jetoni në botë, ju lutem që të keni dijeni për ngrohtësinë e madhe dhe mirëbesimin që Presidenca e Parë dhe të Dymbëdhjetë Apostujt kanë për ju.

Më lejoni të filloj me një rikujtim të asaj që po bëjmë këtu në tokë.

Ne jemi bij dhe bija të dashur shpirtërorë të Atit tonë Qiellor. Ne jetuam me Të në mbretëritë para lindjes. Në mënyrë që të përmbushej misioni i të bërit “të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39), Ati Qiellor krijoi një plan të hartuar për t’i ndihmuar fëmijët e Tij të arrijnë potencialin e tyre përfundimtar. Plani i Atit tonë kërkonte që njeriu të binte dhe të veçohej prej Tij për një kohë duke lindur në vdekshmëri, duke marrë një trup e duke hyrë në një periudhë prove e vënieje në provë. Plani i Tij siguroi një Shpëtimtar që ta shëlbonte njerëzimin nga Rënia. Shlyerja e

Zotit tonë Jezu Krisht siguron mënyrën për t’u kthyer në praninë e Perëndisë përmes ordinancave të ungjillit dhe besëlidhjeve të shenjta. Për shkak se ne do të jetonim në një mjedis vdekjeprurës, të mbushur me rrezik dhe gjëra që do të na e largonin vëmendjen, Ati Qiellor dhe Biri i Tij e dinin se do të na duhej mundësia për të përdorur një fuqi më të madhe se tonën. Ata e dinin se do të na duhej të përdornim fuqinë e Tyre. Ungjilli dhe doktrina e Krishtit u japin të gjithë atyre që do t’i pranojnë ato, fuqinë për të marrë jetë të përjetshme dhe fuqinë për të gjetur gëzim tek udhëtimi.

Ka nga ata që e vënë në dyshim vendin e grave në planin e Perëndisë dhe në Kishë. Jam intervistuar mjaft nga media kombëtare dhe ndërkombëtare për t’ju thënë se, shumica e gazetarëve me të cilët kam pasur të bëj, kanë pasur pikëpamje të paramenduara rreth kësaj teme. Përgjatë viteve, shumë njerëz kanë bërë pyetje duke nënkuptuar se gratë janë qytetare të dorës së dytë në Kishë. Asgjë nuk mund të jetë më larg nga e vërteta.

Më lini të sugjeroj pesë pika kyçe për ju që t’i përsiatni lidhur me këtë temë të rëndësishme.

## 1. Perëndia Ka një Plan që të na Ndhimojë të Arrijmë Jetë të Përjetshme

Ati ynë Qiellor krijoi si gratë edhe burrat, që janë bijat dhe bijtë e Tij shpirtërorë. Kjo do të thotë se gjinia është e përjetshme. Ai ka një plan të hartuar për t'i ndihmuar të gjithë ata që zgjedhin ta ndjekin Atë dhe Birin e Tij, të arrijnë fatin e tyre si trashëgimtarë të jetës së përjetshme.

Nëse ekzaltimi ynë përfundimtar është synimi dhe qëllimi i Tyre thelbësor dhe nëse Ata janë të gjithëditur dhe të përsosur, siç e dimë se janë, atëherë Ata e kuptojnë më së miri si të na përgatisin, mësojnë dhe udhëheqin që të kemi mundësinë më të madhe për t'u kualifikuar për ekzaltim.

Pothuajse çdo njeri ka familje ose miq që janë ngatërruar në probleme të ndryshme shqetësuese shoqërore. Debatimet rreth problemeve përgjithësisht nuk sjellin ndonjë zgjidhje dhe, në fakt, mund të krijojnë grindje. Ka disa pyetje rreth qëndrimit të Kishës mbi çështje delikate që janë të vështira për t'u dhënë përgjigje që do t'i kënaqin të gjithë.

Sidoqoftë, kur e kërkojmë Zotin në lutje për të ditur se si të ndihemi dhe çfarë të bëjmë në këto situata, vjen mbresja: “A beson te Jezu Krishti dhe a e ndjek Atë dhe Atin?” Unë besoj se pothuajse kushdo në Kishë në një kohë apo një tjetër do ta pyesë veten nëse mund të bëjë gjithçka që i kërkohet të bëjë. Por nëse besojmë me të vërtetë te Zoti, vjen përsëri sigurimi: “Unë besoj te Jezu Krishti dhe jam i gatshëm të bëj çfarëdo që Ai ka nevojë që unë të bëj”. Kështu ne bëjmë përpara. Sa të fuqishme janë fjalët: “Unë besoj te Jezu Krishti”!

Dëshmitë tona, paqja jonë e mendjes dhe mirëqenia jonë fillojnë me gatishmërinë për të besuar se Ati ynë në Qiell e di me të vërtetë çfarë është më e mira.

## 2. Kisha Qeveriset nëpërmjet Çelësave të Priftërisë

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është Kisha e Zotit dhe Kisha e Tij qeveriset nga autoriteti i priftërisë e çelësat e priftërisë dhe nëpërmjet





tyre. “Çelësat e priftërisë janë autoriteti që Perëndia u ka dhënë udhëheqësve të priftërisë për të drejtuar, kontrolluar dhe qeverisur përdorimin e priftërisë së Tij në tokë.”<sup>1</sup>

Ai që i ka çelësat e priftërisë – qoftë nëse është një dhjak që ka çelësa për kuorumin e tij ose një peshkop që ka çelësa për lagjen e tij, apo Presidenti i Kishës që i mban të gjithë çelësat e priftërisë – e bën të mundur me kuptimin e plotë të fjalës, për të gjithë që shërbejnë besnikërisht nën drejtimin e tyre që ta ushtrojnë autoritetin e priftërisë dhe të kenë mundësi të përdorin fuqinë e priftërisë.

Të gjithë burrat dhe të gjitha gratë shërbejnë nën drejtimin e atyre që kanë çelësat. Kjo është mënyra se si Zoti e qeveris Kishën e Tij.

Më lejoni të përsëris diçka që pohova në konferencën e përgjithshme të prillit 2013: “Në planin e mrekullueshëm të Atit tonë Qiellor që u jep burrave fuqinë e priftërisë, burrat kanë përgjegjësinë e vetme për të administruar priftërinë, por ata nuk janë priftëria. Burrat dhe gratë kanë role të ndryshme por njësoj të vlerësuara. Ashtu si një grua nuk mund të krijojë një fëmijë pa një burrë, edhe një burrë nuk mund ta ushtrojë plotësisht fuqinë e priftërisë për të krijuar një familje të përjetshme pa një grua. . . . Në këndvështrimin e përjetësisë, si fuqia krijuese edhe fuqia e priftërisë janë të përbashkëta për një bashkëshort dhe një bashkëshorte.”<sup>2</sup>

Përse në detyrat e priftërisë shugurohen burrat dhe jo gratë? Presidenti Gordon B. Hinkli (1910–2008) shpjegoi se ishte Zoti, jo njeriu “që përcaktoi se burrat në Kishën e Tij duhet të mbanin priftërinë” dhe se ishte përsëri Zoti që iu dhuroi grave “aftësi që e plotësojnë këtë organizim të madh e të mrekullueshëm, që është Kisha dhe mbretëria e Perëndisë”. . . .<sup>3</sup> Kur gjithçka është thënë dhe bërë, Zoti nuk ka zbuluar arsyen përse e ka organizuar Kishën e Tij ashtu siç ka bërë.

Le të mos e harrojmë se përafërsisht gjysma e të gjithë mësimdhënies që ndodh në Kishë, bëhet nga motrat. Shumë prej udhëheqjes bëhet nga motrat tona. Shumë mundësi shërbimi dhe veprimtari planifikohen dhe drejtohen nga gratë. Këshillat dhe pjesëmarrjet e tjera të grave në këshillat e lagjes, të kunjtit dhe në këshillat e përgjithshëm në selinë qendrore të Kishës japin mendjemprehtësinë, urtësinë dhe drejtpeshimin e nevojshëm.

Nevojiten si burra që i respektojnë gratë dhe dhuratat e tyre të dallueshme shpirtërore, ashtu edhe gra që i respektojnë çelësat e priftërisë të mbajtur nga burrat për të ftuar bekimet e plota të qiellit në çdo përpjekje në Kishë.

### 3. Burrat dhe Gratë Janë Njësoj të Rëndësishëm

Burrat dhe gratë janë të barabartë në sytë e Perëndisë dhe në sytë e Kishës, por të barabartë nuk do të thotë që ata janë njësoj. Përgjegjësitë dhe dhuratat hyjnore të burrave dhe grave ndryshojnë për nga natyra, por jo për nga rëndësia ose ndikimi. Doktrina e Kishës sonë i quan gratë të barabarta e prapëseprapë të ndryshme nga burrat. Perëndia nuk e konsideron asnjërin nga gjinitë më të mirë apo më të rëndësishme se tjetra. Presidenti Hinkli u deklaroi grave se “Ati ynë i Amshuar . . . nuk ka pasur kurrë për qëllim që ju të jeni më pak se lavdia kurorëzuese e krijimeve të Tij”<sup>4</sup>.

Burrat dhe gratë kanë dhurata të ndryshme, fuqi të ndryshme dhe pikëpamje e prirje të ndryshme. Kjo është një nga arsytet themelore përse kemi nevojë për njëri-tjetrin. Nevojitet një burrë dhe një grua për të krijuar një familje dhe nevojiten burrat e gratë për ta kryer punën e Zotit. Një bashkëshort dhe një bashkëshorte që punojnë së bashku drejtësisht, e plotësojnë njëri-tjetrin. Le të jemi të kujdesshëm që të mos përpiqemi të ndërhyjmë në planin dhe qëllimet e Atit tonë Qiellor në jetën tonë.

### 4. Të Gjithë Bekohen nga Fuqia e Priftërisë

Kur burrat dhe gratë shkojnë në tempull, ata e marrin indaumentin të dy nga e njëjta fuqi, që është fuqia e priftërisë. Ndërkohë që autoriteti i priftërisë drejtohet përmes çelësave të priftërisë dhe çelësat e priftërisë mbahen vetëm nga burrat e denjë, mundësia e përdorimit të fuqisë dhe bekimet e priftërisë janë në dispozicion të të gjithë fëmijëve të Perëndisë.

Ati ynë në Qiell është bujar me fuqinë e Tij. Të gjithë burrat dhe gratë kanë mundësinë e përdorimit të kësaj fuqie për ndihmë në jetën tonë vetjake. Të gjithë ata që kanë bërë besëlidhje të shenjta me Zotin dhe që i respektojnë ato besëlidhje, kanë të drejtë të marrin zbuluesë personale, të bekohen nga shërbesa e engjëjve, të bisedojnë me



Perëndinë, të marrin plotësinë e ungjillit dhe, përfundimisht, të bëhen përkrah Jezu Krishtit trashëgimtarë të gjithçkaje që Ati ynë ka.

### 5. Ne Duhet ta Dimë Doktrinën dhe të Japim Dëshmi për Të

Ne kemi nevojë që gratë e Kishës ta dinë doktrinën e Krishtit dhe të japin dëshmi për Rivendosjen në çdo mënyrë që të munden. Nuk ka pasur kurrë një kohë më të ndërlikuar në historinë e tokës. Satani dhe pasuesit e bindur të tij i kanë përsosur armët në arsenalin e tyre për mijëvjeçarë dhe ata kanë përvojë në shkatërrimin e besimit dhe të mirëbesimit të Perëndia dhe të Zoti Jezu Krisht mes familjes njerëzore.

Të gjithë ne – burra, gra, të rinj në moshë madhore, të rinj, djem e vajza – kemi Zotin dhe Kishën e Tij për ta mbrojtur, për ta përkrahur e për ta përhapur nëpër të gjithë tokën. Ne kemi nevojë për më tepër nga zërat e dalluar e ndikues të grave dhe për besimin e tyre. Ne kemi nevojë që ju ta mësoni doktrinën dhe të kuptoni se çfarë besojmë, që të mund të jepni dëshmi rreth së vërtetës së të gjitha gjërave – qoftë nëse ato dëshmi jepen rrotull zjarrit në një kamp për Të Rejat, në një mbledhje dëshmish, në një faqe vetjake interneti apo në Facebook. Vetëm ju mund t'ia tregoni botës se si duken dhe çfarë besojnë gratë e Perëndisë të cilat kanë bërë besëlidhje.

Motra, sfera juaj e ndikimit është një sferë e pashoqe

– një sferë që nuk mund të kopjohet nga burrat. Askush nuk mund ta mbrojë Shpëtimtarin me më shumë bindje apo fuqi nga sa mund ta bëni ju, bijat e Perëndisë, – ju që keni forcë të brendshme dhe bindje të tillë shpirtërore. Fuqia e zërit të një gruaje të kthyer në besim është e pamatshme dhe Kisha tani ka nevojë për zërat tuaj më shumë se kurrë.

Ju lë dëshmimin tim dhe dëshminë time se ne jemi në një kohë kur duhet të qëndrojmë të bashkuar. Ne duhet të qëndrojmë së bashku – burra dhe gra, të rinj dhe të reja, djem dhe vajza. Ne duhet të ngrihemi në këmbë për planin e Atit tonë Qiellor. Ne duhet ta mbrojmë Atë. Ai po lihet mënjanë. Ne nuk mund të rrimë me përtaci si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe ta lejojmë atë që të vazhdojë të ndodhë pa qenë aq guximtarë sa t'i bëjmë zërat tanë të dëgjojen.

Ju bekoftë Perëndia që të keni guximin për t'i studiuar dhe njohur të vërtetat e thjeshta të ungjillit e më pas t'ua tregoni të tjerëve në çdo rast që t'ju jepet. ■

*Nga një fjalim në një takim shpirtëror dhënë më 20 gusht 2013 në Universitetin "Brigam Jang". Për tekstin e plotë në anglisht, vizitoni [speeches.byu.edu](http://speeches.byu.edu).*

#### SHËNIME

1. *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 2.1.1.
2. M. Rasëll Ballard, "Kjo Është Vepra Ime dhe Lavdia Ime", *Liahona*, maj 2013, f. 19.
3. Gordon B. Hinckley, "Women of the Church", *Ensign*, nëntor 1996, f. 70.
4. Gordon B. Hinckley, "Stand Strong Against the Wiles of the World", *Ensign*, nëntor 1995, f. 98.



# DUKE U PËRGATITUR PËR TË SHËRBYER, DUKE SHËRBYER PËR T'U PËRGATITUR

*Perëndia jua dha Priftërinë Aarone, sepse Ai ka një punë për ju – tani dhe në të ardhmen.*



**Dejvid L. Bek,**  
President i Përgjithshëm  
i Të Rinjve

**X**honatani është një mik i imi që u bashkua me Kishën katër vjet më parë. Ai është i vetmi anëtar i Kishës në familjen e tij. Pasi mori Priftërinë Aarone, ai filloi t'iu shërbente të tjerëve ashtu siç nuk u kishte shërbyer kurrë më parë. Xhonatani e dinte se që të shërbente, ai duhej të mësonte shumë. Ai gjithashtu dëshironte që të ishte i denjë e më i besueshëm, ndaj studioi ungjillin, u lut dhe ndoqi mbledhjet e së dielës dhe seminarin. Ai punoi fort për t'i mbajtur urdhërimet dhe standardet e Kishës. Ai i përmbushi me zell detyrat e tij të priftërisë, përfshirë të qenit një mësues i shkëlqyer shtëpie. Libri i tij *Detyrë ndaj Perëndisë* e ndihmoi t'i kuptonte ato detyra dhe të mësonte se si t'i përmbushte ato.

Shërbimi besnik i Xhonatani si prift i dha atij forcë shpirtërore. Kjo e mbrojti atë nga ndikimet e liga. Ai u rrit jashtëzakonisht teksa shërbente dhe përgatitej për të ardhmen e tij. Vitin që shkoi, ai mori denjësisht Priftërinë Melkizedeke dhe indaumentin në tempull. Tani ai po shërben në mision në Brazil.

Priftëria Aarone quhet shpesh “priftëria përgatitore”. Perëndia jua dha Priftërinë Aarone, sepse Ai ka një punë për ju – tani dhe në të ardhmen. Shërbimi juaj besnik në Priftërinë Aarone ju përgatit për mundësi akoma më të mëdha për të shërbyer në vitet që do të vijin. Sikurse Xhonatani, ju po përgatiteni që të “m[errni] Priftërinë Melkizedeke, të m[errni]

bekimet e tempullit, të shërbe[ni] në një mision kohëplotë, të je[ni] një bashkëshort dhe baba i dashur dhe që të vazhdo[ni] gjithë jetës në shërbim të Zotit” (*Të Vërtetë ndaj Besimit: Një Referim për Ungjillin* [2004], f. 131).

Ju mund të mos i dini të gjitha hollësitë e mundësive të mrekullueshme që Ati Qiellor ruan për ju, por jam i sigurt se do të jeni të përgatitur t'i përmbushni ato nëse kujtoni të bëni sa vijon si mbajtës të Priftërisë Aarone.

## **Ndiqni Jezu Krishtin**

Si mbajtës të priftërisë, ju jeni përfaqësues të Jezu Krishtit. Kjo do të thotë se ju kërkohet ta ndiqni Atë dhe të bëni atë që Ai do të bënte. Çfarë do të bënte Ai? Në çdo situatë, Ai ia përkushtoi jetën e Tij shërbimit dhe bekimit të të tjerëve. Kështu duhet të bëni dhe ju. Jepeni veten tuaj në shërbimin ndaj të tjerëve – dhe më pas rrituni e përmirësohuni që të keni më shumë për të dhënë nga vetja! Kujtoni se si u rrit Jezusi në rininë e Tij: Ai “rritej në dituri, në shtat dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve” (Lluka 2:52).

Pjesë e ndjekjes së Shpëtimtarit është të qenit të urtë e të shëndetshëm fizikisht në rininë tuaj. Kjo kërkon që të punoni fort dhe të bëni gjithnjë më të mirën tuaj (shih DeB 4:2). Ju merrni admirimin e Perëndisë tekta afroheni më pranë Tij përmes lutjes së përditshme, studimit të përditshëm të ungjillit,



**MBAJTËSIT E PRIFTËRISË AARONE:**

**SI MUND TË PËRGATITEM PËR TË:**

**Ndjekin Jezu Krishtin përmes**

- lutjes dhe studimit të përditshëm të ungjillit
- bindjes
- kërkimit të vullnetit të Perëndisë

**Administrojnë ordinanca priftërie të tilla si:**

- bekimi i sakramentit
- pagëzimi i të tjerëve

**Japin gjithnjë shërbesë nëpërmjet**

- forcimit të pjesëtarëve të familjes dhe anëtarëve të kuorunit
- shpëtimit të anëtarëve më pak aktivë
- shërbimit ndaj nevojtarëve

**Marrë Priftërinë Melkizedeke**

---



---



---

**Marrë bekimet e tempullit**

---



---



---

**Shërbyer në një mision**

---



---



---

**Qenë një bashkëshort e baba**


---




---



---







*Ju e ndiqni Krishtin kur kërkoni vullnetin e Perëndisë gjatë gjithë ditës që t'i tregojë udhën shërbimit tuaj dhe kur veproni sipas nxitjeve shpirtërore që merrni.*

bindjes dhe shërbimit të përditshëm. Ju merrni admirimin e të tjerëve teksa tregoheni të sjellshëm e besnikë ndaj familjes suaj dhe një mik si Krishti për të gjithë.

Kujtoni se Jezusi bëri gjithnjë vullnetin e Atit. Ju e ndiqni Krishtin kur kërkoni vullnetin e Perëndisë gjatë gjithë ditës që t'i tregojë udhën shërbimit tuaj dhe kur veproni sipas nxitjeve shpirtërore që merrni.

### **Administroni Ordinanca Priftërie**

Ordinancat e priftërisë janë të nevojshme për të gjithë fëmijët e Perëndisë dhe i bekojnë si bijtë, ashtu edhe bijat e Tij në mënyrë të barabartë. Nga çasti që bëheni dhjakë, ju ndihmoni për të administruar në një ordinancë priftërie duke shpërndarë sakramentin. Ju do të vazhdoni të administroni ordianca priftërie në Priftërinë Aarone më vonë, teksa përgatiteni dhe bekonin sakramentin, pagëzoni dhe merrni pjesë në shugurimin e mbajtësve të tjerë të Priftërisë Aarone.

Për të marrë pjesë në ordinancat e shenjta, ju duhet të jeni të pastër. Pastërtia juaj morale mund t'iu shtojë fuqi të madhe shpirtërore ordinancave që administroni. Mundohuni të jeni të denjë në çdo mënyrë që të mbani enët e shenjta të sakramentit të Zotit (shih DeB 38:42). Kur jeni të denjë, ju mund të qëndroni përpara lagjes ose degës suaj si përfaqësues të vërtetë të Jezu Krishtit. Ata do të bekohen nga vendosmëria juaj për t'i mbajtur besëlidhjet, të cilat po ndihmoni që ata t'i përtërijnë.

### **Jepni Gjithnjë Shërbesë**

Si mbajtës të Priftërisë Aarone, ju jepni shërbesë. Në çdo kohë, kërkoni mundësi për t'i dhënë shërbesë familjes, miqve, anëtarëve

të kuorumit tuaj dhe të tjerëve. Çdo gjë që bëni në priftëri, ju ndihmon t'iu jepni shërbesë të tjerëve si fizikisht, ashtu edhe shpirtërisht. Për shembull, kur e ndihmoni peshkopin ose presidentin e degës suaj duke i shërbyer një familjeje ku jeni mësues shtëpie, ju po mësoni si t'i dalloni nevojat e të tjerëve dhe të kujdeseni për to. Ju do t'iu jepni shërbesë të tjerëve edhe kur shkoni për të forcuar anëtarët tuaj të kuorumit dhe për të shpëtuar më pak aktivët, kur mblidhni ofertat e agjërimit për të ndihmuar të varfrit dhe nevojtarët, kur kryeni punë fizike për të sëmuret e njerëzit me paaftësi, kur jepni mësim e dëshmoni për Krishtin dhe ungjillin e Tij dhe kur ua lehtësoni barrat të shkurajuarve.

Ju jepni shërbesë kur jepni mësim në mbledhjet e kuorumit tuaj dhe në mbledhjet tuaja familjare. Ju jepni shërbesë kur i ftoni të gjithë të vijnë te Krishti (shih DeB 50:29) – në shtëpi, në kuorumin tuaj, në shkollë, me misionarët kohëplotë dhe kudo ku jeni.

### **E Ardhmja Juaj**

Diskutoni me prindërit ose këshilluesit tuaj se çfarë do të kërkohet prej jush në rolet tuaja të ardhshme si mbajtës të Priftërisë Melkizedeke, misionarë, bashkëshortë e baballarë. Shkruajini në hapësirën e dhënë disa prej atyre përgjegjësive të shenjta dhe mënyrën si mund të përgatiteni për to sot, ndërkohë që shërbeni në Priftërinë Aarone. Mund të duket punë e rëndë tani, por kujtoni se mënyra më e mirë për t'u përgatitur është thjesht të bëni atë që Ati Qiellor ju ka kërkuar të bëni sot. Gjetshi lumturi ndërkohë që shërbeni tani dhe që përgatiteni për të ardhmen tuaj të lavdishme. ■

# FUQIA PËR T'I BEKUAR TË GJITHË NJERËZIT

*Udhëheqësit e Kishës na kanë mësuar se ordinancat dhe besëlidhjet e priftërisë janë të disponueshme për të gjithë fëmijët e Perëndisë – burrat dhe gratë.*



"Priftëria është fuqia dhe autoriteti i Priftërisë dhënë për shpëtimin dhe bekimin e të gjithëve – burra, gra e fëmijë. . .

Ka bekime të veçanta nga Perëndia për çdo nje-

ri të denjë që është i pagëzuar, merr Frymën e Shenjtë dhe merr rregullisht sakramentin. Tempulli sjell dritë dhe forcë më të madhe, së bashku me premtimin për jetë të përjetshme [shih DeB 138:37, 51].

**Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, "Fuqi në Priftëri", *Liahona*, nëntor 2013, f. 92.**



"Ordinancat dhe besëlidhjet [e] priftëri[së] sigurojnë të drejtën për plotësinë e bekimeve që na janë premtuar nga Perëndia, të cilat janë bërë të mundura me anë

të Shlyerjes së Shpëtimtarit. Ato i armatosin bijtë dhe bijat e Perëndisë me fuqi, me fuqinë e Perëndisë dhe na sigurojnë mundësinë për të marrë jetë të përjetshme – që të kthehemi në praninë e Perëndisë dhe të jetojmë me Të në familjen e Tij të përjetshme."

**Karol M. Stevens, këshilltare e parë në presidencën e përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës, "A e Dimë se Çfarë Kemi?" *Liahona*, nëntor 2013, f. 12.**



"Është vendimtare që ne të kuptojmë se Ati Qiellor ka siguruar një mënyrë për të gjithë bijtë dhe bijat e Tij që të kenë qasje te bekimet e fuqisë së priftërisë dhe të forcohen


prej saj. Qendrore te plani i Perëndisë për fëmijët e Tij shpirtërorë është vetë thënia e Tij: 'Kjo është vepra ime dhe lavdia ime – të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut' (Moisiu 1:39)."

**Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, "Kjo Është Vepra Ime dhe Lavdia Ime", *Liahona*, maj 2013, f. 19.**





# SJELLJA E BEKIMEVE TË PRIFTËRISË NË SHTËPINË TUAJ



**Nga Boni L. Oskarson,**  
Presidente e Përgjithshme  
e Të Rejave

*Kur i mbani  
besëlidhjet tuaja,  
ju mund të merrni  
nga fuqia e  
priftërisë për të  
bekuar shtëpinë  
dhe familjen tuaj.*

**S**i mund të merrni ju, si një i ri apo e re, pavarësisht nga rrethanat tuaja familjare, nga fuqia e besëlidhjeve të priftërisë që bëtë në pagëzim për të forcuar shtëpitë dhe familjet tuaja? Të kuptuarit e rolit dhe të rëndësisë së familjeve tona në planin e Zotit mund të na frymëzojë që t'i nderojmë premtimet që kemi bërë, duke kuptuar se shërbimi ynë më i mirë dhe më me dëshirë bëhet brenda vetë shtëpive tona. Le të shohim disa mënyra se si marrim nga fuqia e besëlidhjeve tona për t'i forcuar ata që janë më të rëndësishmit për ne dhe për t'u shërbyer atyre.

## Si do të Përgjigjeshit?

Është e hënë në darkë dhe keni shumë detyra shkollë për të bërë. Dëgjoni babanë që thërret familjen për t'u mbledhur për mbrëmjen familjare. Çfarë bëni ju?

Zgjedhja A: Ju përgjigjeni: "O babi, nuk kam kohë për atë sontë! Duhet të studioj!"

Zgjedhja B: Me të shpejtë ndihmoni për t'i mbledhur motrat dhe vëllezërit tuaj dhe

me gëzim merrni pjesë në lutje, muzikë dhe dhënie të mesazhit.

## Kur Ka Udhëheqje Priftërie në Shtëpi

Mbështetja e prindërve tuaj nëpërmjet pjesëmarrjes me dëshirë në mbrëmjen familjare, në lutjen familjare dhe në studimin familjar të shkrimeve të shenjta janë disa mënyra për ta forcuar udhëheqjen e priftërisë në shtëpinë tuaj. Ka edhe shumë mënyra të tjera, të tilla si:

- Lutuni për prindërit tuaj. (Ata ka shumë mundësi të lutën për ju çdo ditë.)
- Mbështetini prindërit tuaj në thirrjet e tyre të Kishës dhe ofroni të ndihmoni në shtëpi, veçanërisht kur ata janë të zënë me detyra të veçanta.
- I ndihmoni prindërit tuaj t'i mirëpresin mësuesit e shtëpisë kur ata vijnë dhe më pas dëgjoni me mirësjellje mesazhin e tyre.
- Nëse ka një tempull në zonën tuaj, ofroni që të kujdeseni për motrat dhe vëllezërit më të vegjël me qëllim që



prindërit tuaj të mund të shkojnë në tempull dhe të marrin pjesë në ordina-ncat e priftërisë.

Mbani mend se nuk është që vetëm prindërit janë përgjegjës për ta ftuar dhe për ta mbajtur Shpirtin në shtëpinë tuaj. Ka shumë që mund të bëni për ta ftuar Shpirtin nëpërmjet veprimeve dhe qëndrimit tuaj. A po e bëni pjesën tuaj për ta ftuar ndikimin e Shpirtit në shtëpinë tuaj?

### Kur Nuk Ka Udhëheqje Priftërie në Shtëpi

Jo të gjitha familjet duken ose veprojnë në të njëjtën mënyrë. Ju mund të jeni në një familje me një prind të vetëm ose të mos keni një mbajtës të priftërisë që kryeson në shtëpinë tuaj. Ka ende shumë mënyra për ta ftuar fuqinë e priftërisë për t'ju forcuar ju dhe familjen tuaj. Këto janë gjëra që ne të gjithë duhet t'i bëjmë, pavarësisht nga rrethanat tona:

- Bëni lutje personale, studioni shkrimet e shenjta dhe agjëroni. Këto përpjekje do t'ju ndihmojnë të jeni më të fortë shpirtërisht dhe ta ftoni Shpirtin në jetën tuaj dhe në sferën tuaj të ndikimit.
- Harxhoni kohë për t'i lartësuar thirrjet ose detyrat tuaja të Kishës dhe jini të përgatitur për mësimet e së dielës. Bëra e kësaj ju ndihmon të keni mirëbesim te vetja dhe tregon mbështetje për programet e priftërisë.
- Tregoni respekt për të gjithë anëtarët e familjes suaj dhe mbështetini veprimtaritë e tyre të shëndetshme. Këto

zgjedhje ndihmojnë në forcimin e tërë familjes.

- Ndani me familjen tuaj gjërat që mësoni dhe bëni në orët mësimore dhe kuorumet tuaja të Kishës. Ajo është një mënyrë për t'i sjellë mësimet e ungjillit në shtëpi.
- Gjeni mënyra për t'u shërbyer atyre që keni përreth nëpërmjet veprimeve të thjeshta të mirësisë.
- Ndihmoni nëpër shtëpi duke bërë punë shtëpie apo duke ndihmuar një vëlla ose një motër.
- Tregojini dashuri si e Krishtit familjes suaj – ajo do të ketë ndikim më të madh në krijimin e lidhjeve të forta familjare sesa pothuajse çdo gjë tjetër që mund të bëni.

### Nderimi i Besëlidhjeve Tuaja

Duke u shërbyer familjeve tona, duke i dashur e forcuar ato, ne jemi të vërtetë ndaj besëlidhjeve që bëmë në pagëzim për të qëndruar si dëshmitarë të Jezu Krishtit, për t'i zbatuar urdhërimet e Tij dhe për t'i forcuar njerëzit përreth nesh. Ne mund të marrim forcë nga besëlidhjet e priftërisë që të jemi një bekim për shtëpitë dhe familjet tona dhe për të ndihmuar në shtëpitë dhe familjet tona. *Priftëria, shërbimi dhe shtëpia* janë fjalë që duhet të lidhen përjetësisht në mendjen tonë. Anëtarët e vetë familjeve tona duhet të jenë përparësia numër një, ndërkohë që gjejmë mënyra për të marrë pjesë në punën e shpëtimit. Kur i forcojmë familjet tona, ne gjithashtu forcojmë Kishën, komunitetet tona dhe botën. ■



“Familja është thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përjetshëm të fëmijëve të Tij.”

“Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.



“Gjëja më e rëndësishme e punës së Zotit që do të bëni ndonjëherë, do të jetë brenda vetë mureve të shtëpive tuaja.”



# SIGURIA E DENJËSISË

*Dëshiroj të flas veçanërisht për mënyrën se si të kemi një lloj shumë të veçantë sigurie.*



**Nga Plaku Xhefri R. Holland**  
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

**M**esazhi im për ju është një mesazh shprese e inkurajimi tani dhe për gjithë jetën tuaj. Ka shumë andralla në botë, por gjithmonë ka pasur andralla në çdo periudhë dhe epokë. Mos u shqetësoni për to dhe mos u shkurajoni nga ato. Vitet pasuese do të mbushen me mundësi të mrekullueshme dhe bekime të mëdha. Ne do të vazhdojmë të kemi përparim në teknologji e shkencë, mjekësi e komunikim – të gjitha fushat që bëjnë kaq shumë për të pasuruar jetën tonë. Ju jetoni në epokën më të lavdishme që bota ka njohur ndonjëherë, me më shumë prej bekimeve të kohës që shkojnë te më shumë njerëz përreth botës se në çdo kohë tjetër në histori. Kujtoni – gjyshja juaj nuk ëndërroi asnjëherë për një kompjuter dore kur ishte në moshën tuaj, dhe gjyshi juaj ende nuk e ka idenë se si të dërgojë mesazh me celular. Kështu që, jini të lumtur, të shëndetshëm dhe optimistë.

E them këtë pjesërisht sepse, në një artikull që lexova së fundmi, thuhej se sëmundja më e zakonshme midis të rinjve në moshë sot nuk është diabeti ose sëmundja e zemrës apo kanceri. (Ato lloj problemesh zakonisht u lihen njerëzve të moshës sime, jo të moshës suaj.) Jo, u raportua se, sëmundja nga e cila

njerëzit në vitet e adoleshencës dhe rreth të 20-ve vuajnë më shumë, është dyshimi te vetja, frika nga e ardhmja, vetëvlerësimi i ulët dhe një mungesë e përgjithshme e sigurisë te vetja dhe te bota përreth tyre.

Edhe pse jam shumë më i moshuar se ju, vërtet i kujtoj ato lloj shqetësimesh sepse në pjesën më të madhe të rinisë time edhe mua m'u duk se u përballa me situata në të cilat nuk kisha shumë siguri te vetja. Mund të kujtoj që përpiqesha për nota të mira, që shpresoja të fitoja mundësinë për bursë në shkollë dhe pyesja veten se përse të tjerët dukeshin më të zotë në atë fushë sesa unë. Mund të kujtoj vite të shumta konkursesh atletike në të cilat përpiqesha të luaja me sigurinë e nevojshme për sukses në sporte në shkollën e mesme dhe atë të lartë, që dëshiroja kaq dëshpërimisht të fitoja lojën e rëndësishme ose të fitoja një kampionat të lakmuar. Mbaj mend në veçanti mungesën e sigurisë me vajzat, që është kaq shpesh arsyeja e shkakimit të një ankthi të madh te djemtë e rinj. Jam shumë mirënjohës që Motra Holland më dha një mundësi. Po, unë mund t'i mbaj mend të gjitha gjërat që ju mbani mend – të mos qenit i sigurt për pamjen time apo për faktin nëse më pranonin, ose për atë që do të ruante e ardhmja për mua.





Qëllimi im këtu nuk është të diskutoj mbi të gjitha ato probleme me të cilat përballlet një i ri, që sjellin dyshim te vetja dhe mungesë sigurie te vetja, por dëshiroj të flas veçanërisht për mënyrën se si të kemi një lloj shumë të veçantë sigurie – siguri e cila, kur fitohet në mënyrën e duhur, përmbush mrekulli në çdo aspekt tjetër të jetës sonë, sidomos te vetëvlerësimi ynë dhe mënyra se si e shohim të ardhmen. Për të dalë në këtë pikë, më duhet të tregoj një histori.

### **Vlera e Denjësisë Vetjake**

Shumë vite më parë, kohë përpara se të thirresha si Autoritet i Përgjithshëm, mora pjesë si folës në një konferencë të rinjsh në moshë madhore. Konferenca përfundoi me një mbledhje dëshmish në të cilën një misionar i ri i kthyer dhe i pashëm u ngrit për të ndarë dëshminë e tij. Ai dukej i mirë, i pastër dhe me siguri në vetvete – ashtu siç duhet të duket një misionar i kthyer.

Ndërsa filloi të fliste, i dolën lot nga sytë. Ai tha se ishte mirënjohës që qëndronte mes një grupi kaq të mrekullueshëm të rinjsh shenjtore të ditëve të mëvonshme dhe që ndihej mirë për jetën që po përpiqej të bënte. Por ajo ndjenjë ishte bërë e mundur, tha ai, vetëm për shkak të një përvoje që kishte pasur disa vite më parë, një përvojë që i kishte ndryshuar jetën përgjithmonë.

***Ndërsa u ul në makinën e tij për pak kohë në rrugicën para shtëpisë së vet, duke menduar gjërat që kaluan dhe duke ndier hidhërim të vërtetë, e ëma e tij joanëtare erdhi duke vrapuar e shqetësuar nga shtëpia.***

Ai më pas tregoi për kthimin në shtëpi nga një takim me një vajzë pak pasi ishte shuguruar plak, në moshën 18-vjeçare. Diçka kishte ndodhur në këtë takim, për të cilën nuk krenohej. Ai nuk hyri në hollësi, as nuk duhej ta kishte bërë në një ambient publik. Sot e kësaj dite nuk e di se çfarë ndodhi, por ishte mjaftueshëm domethënëse për të sa që i kishte prekur shpirtin dhe vetëvlerësimin e tij.

Ndërsa u ul në makinën e tij për pak kohë në rrugicën para shtëpisë së vet, duke menduar gjërat që kaluan dhe duke ndier hidhërim të vërtetë për çfarëdo që kishte ndodhur, e ëma e tij joanëtare erdhi duke vrapuar e shqetësuar nga shtëpia drejt makinës së tij. Në çast, ajo njoftoi se vëllai më i vogël i këtij djali ishte rrëzuar në shtëpi, kishte goditur kokën keqas dhe po kalonte një krizë apo spazmë. I ati joanëtar kishte telefonuar menjëherë për një ambulancë, por do t'i nevojitej ndihmë derisa ambulanca të vinte.

“Eja dhe bëj diçka”, thërriste ajo në lot. “A nuk ka diçka që bëni ju në Kishën tuaj në kohë si këto? Ti ke priftërinë e tyre. Eja dhe bëj diçka.”

E ëma e tij nuk dinte shumë për Kishën në atë pikë, por ajo dinte diçka për bekimet e priftërisë. Megjithatë, në këtë





***“Nga ajo natë e tutje, nuk kam bërë asnjëherë ndonjë gjë që do të më ndalonte të shkoja para Zotit me siguri dhe të kërkoja ndihmën e Tij kur nevojitej”, tha ai.***

mbrëmje kur dikush që ai e donte kaq shumë kishte nevojë për besimin e tij dhe forcën e tij, ky i ri nuk mund t'i vinte në ndihmë. Duke pasur parasysh ndjenjat me të cilat po ndeshesh dhe shkeljen që ndiente se sapo kishte bërë – çfarëdo qoftë ajo – ai nuk mundej të shkonte para Zotit dhe t'i kërkonte bekimin që nevojitej.

Ai doli me vrull nga makina dhe vrapoi teposhtë rrugës për në shtëpinë e një burri më të moshuar e të denjë, i cili e kishte mbajtur afër në lagje që pas kthimit të djalit në besim, dy ose tre vjet më parë. Iu dha shpjegim lidhur me situatën dhe të dy u kthyen në shtëpi ende shumë përpara se të mbërrinin ndihmësmjekët. Fundi i lumtur i kësaj historie, siç u tha në atë mbledhje dëshmish, ishte që ky burrë më i moshuar menjëherë dha një bekim të ëmbël e të fuqishëm priftërie, duke e lënë fëmijën e lënduar në gjendje të qëndrueshme e të qetë derisa të mbërrinte ndihma mjekësore. Udhëtimi i shpejtë për në spital dhe një kontroll i plotë treguan se nuk kishte pësuar asnjë dëmtim të përhershëm. Një çast shumë i frikshëm për këtë familje kishte kaluar.

Më pas, misionari i kthyer për të cilin po flas, tha këtë: “Asnjë njeri që nuk është përballur me atë që u përballa unë atë natë, nuk do ta njohë ndonjëherë turpin që ndjeva dhe hidhërimin që mbajta si barrë, nga të ndierit i padenjë për ta përdorur priftërinë që mbaja. Është një kujtim edhe më i dhembshëm për mua pasi ishte vetë vëllai im i vogël që kishte nevojë për mua dhe prindërit e mi të dashur joanëtarë që ishin kaq të trembur dhe që kishin të drejtë të prisnin më shumë prej meje. Por ndërsa qëndroja para jush

sot, mund t’ju premtoj këtë”, tha ai, “unë nuk jam i përsosur por, që nga ajo natë e tutje, nuk kam bërë asnjëherë ndonjë gjë që do të më ndalonte të shkoja para Zotit me siguri dhe të kërkoja ndihmën e Tij kur nevojitej. Denjësia vetjake është një betejë në këtë botë në të cilën jetojmë”, pranoi ai, “por është një betejë që unë po e fitoj. E kam ndier gishtin e dënimit të drejtohet nga unë një herë në jetën time dhe nuk kam ndërmend ta ndiej kurrë më atë nëse mund të bëj çdo gjë për këtë. Dhe, sigurisht”, përfundoi ai, “mund të bëj gjithçka për këtë.”

Ai përfundoi dëshminë e tij dhe u ul. Ende mund ta përfytyroj. Ende mund ta shoh mjedisin ku ishim. Dhe ende mund ta kujtoj heshtjen e zymtë dhe prekëse që erdhi pas fjalëve të tij, ndërsa çdokush në sallë pati rastin të kërkonte në shpirtin e tij apo të saj pak më thellë, të zotohej pak më fort për të jetuar sipas këtyre fjalëve të fuqishme të dhëna nga Zoti:

*“Virtyti duhet t’i stolisë mendimet e tua pa pushim; atëherë do të forcohet vetbesimi yt në prani të Perëndisë; dhe doktrina e priftërisë do të pikojë mbi shpirtin tënd sikurse vesat nga qiejt.*

Fryma e Shenjtë do të jetë shoqëruesi yt i vazhdueshëm dhe skeptri yt një skeptër i pandryshueshëm i drejtësisë dhe së vërtetës” (DeB 121:45–46; theksimi i shtuar).

### **Të Gëzuarit e Shpirtit të Perëndisë**

Miq të mi të rinj e të dashur, kini një jetë të mrekullueshme. Mendoni për më të mirën dhe shpresoni më të mirën, dhe kini besim tek e ardhmja. Ju keni një jetë të mrekullueshme përpara jush. Ati juaj Qiellor ju do. Nëse keni bërë ndonjë gabim, mund të pendoheni dhe të faleni sikurse u pendua dhe u fal ky djalë i ri. I keni të gjitha arsyet për të jetuar, planifikuar dhe besuar. Të pasurit e miratimit të ndërjegjes suaj kur jeni vetëm me kujtimet tuaja, ju lejon ta ndieni Shpirtin e Perëndisë në një mënyrë shumë vetjake. Dëshiroj që ta gëzoni atë Shpirt, ta ndieni atë siguri në praninë e Zotit gjithnjë. Mendimet e virtytshme i mbajtshin të pastra veprimet tona sot, nesër e përgjithnjë. ■

*Nga një mbrëmje rreth vatrës për rininë, e dhënë më 31 dhjetor 2006.*



# PORTA dhe SHTEGU

*Ordinancat dhe besëlidhjet e priftërisë na vendosin në shtegun drejt jetës së përhjetshme dhe na bekojnë me forcën që na nevojitet pikërisht tani.*

**N**e të gjithë kërkojmë jetë të përhjetshme, që do të thotë të shpëtohem dhe të ekzaltohem në shkallën më të lartë të mbretërisë çelestiale, ku ne mund të jetojmë në praninë e Atit Qiellor si familje.

Përveç besimit në Jezu Krisht dhe pendimit, ordinancat dhe besëlidhjet e priftërisë na lejojnë të hyjmë në shtegun që çon drejt jetës së përhjetshme. Pavarësisht se kur hytë në këtë shteg apo se ku jeni në të – qoftë nëse u lindët në Kishë apo u kthyet në besim më vonë, qoftë nëse keni qenë aktiv gjatë gjithë jetës suaj ose porsa po riaktivizoheni në Kishë – ju mund të përparoni përgjatë tij, ndërkohë që përqendroheni te besëlidhjet tuaja dhe tek ajo që mund të bëni për t'i marrë dhe mbajtur ato.

Dhe është e rëndësishme të dini se ordinancat dhe besëlidhjet e priftërisë nuk ofrojnë thjesht premtimin e një të ardhmeje të lavdishme. Ato gjithashtu na japin forcën, ngushëllimin dhe mbështetjen që na nevojitet pikërisht tani, me qëllim që ta ndjekim shtegun dhe që të durojmë deri në fund me drejtësi. ■




“Më e rëndësishmja, është autoriteti i priftërisë në Kishë ai që siguron ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta që i lidhin **familjet tok** dhe e kualifikojnë secilin prej nesh që të **kthehet te**

**Perëndia, Ati, dhe te Jezu Krishti** në mbretërinë çelestiale. Këto ordinanca sjellin paqe ngaqë ato janë besëlidhje me Zotin.”

Plaku Kuentin L. Kuk, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Paqja Vetjake: Shpërblimi i Drejtësisë”, *Liahona*, maj 2013, f. 34.

**SHTEGU QË ÇON  
DREJT JETËS SË  
PËRHJETSHME  
(DURIMI DERI  
NË FUND)**

Shih 2 Nefi 31.



PAGËZIMI



Sakramenti –  
ripërtëritja e përjav-  
shme e besëlidhjes  
së pagëzimit

DHURATA E FRYMËS SË SHENJTË

ORDINANCA DHE BESËLIDHJE THELBËSORE  
RIPËRTËRITJA DHE FORCIMI I ORDINANCAVE

Bekimet patriarkale  
– udhërrëfim i veçantë  
individual dhe bekime të  
premtuara




DHËNIA DHE SHUGURIMI  
I PRIFTËRISË (PËR TË RINJTË)



INDAUMENTI I TEMPULLIT

Bekime për  
të sëmuret –  
ndihmë dhe  
shërim



Bekime të atit dhe bekime të  
tjera për ngushëllim dhe këshillim –  
paqe dhe udhërrëfim kur nevojitet

NDIHMA  
PËRGGJATË UDHËS

**Shkrimet e shenjta** – udhërrëfim dhe udhëzim i marrë si pjesë e besëlidhjes midis Perëndisë dhe popullit të Tij (shih DeB 84:57)

**Lutja** – “[Mësuesi] na ofron besëlidhjen që ‘gjithmonë ta kujtojmë Atë’ dhe paralajmërimin që të ‘lutemi gjithmonë’, me qëllim që ne ta vendosim vërtet mbështetjen tonë tek Ai, siguria jonë e vetme” (Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltari i Parë në Presidencën e Parë, “Gjithmonë”, *Ensign*, tetor 1999, f. 9).

**Shërbimi** – përmbushja e besëlidhjeve tona duke i shërbyer Perëndisë dhe fëmijëve të Tij, duke përfshirë thirrjet, punën në tempull dhe punën për historinë familjare, ndarjen e ungjillit, shërbimin misionar kohëplotë

**Pendimi** – të kujtuarit e besëlidhjeve tona dhe afrimi më pranë Shpëtimtarit kur kemi shkuar në udhë të gabuar, nganjëherë duke përfshirë ndihmë nga udhëheqësit e priftërisë

VULOSJA NË TEMPULL



JETA E PËRJETSHME  
(MBRETËRIA ÇELESTIALE ME FAMILJET)



“Të qëndruarit në shtegun e besëlidhjeve, urdhërimeve dhe ordiancave të ungjillit na **mbron** dhe na **përgatit** për të bërë punën e Perëndisë në këtë botë.”

Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Qëndroni të Paepur në Vende të Shenjta”, *Liahona*, maj 2013, f. 49.



“Ndërsa merrni pjesë denjësisht në ordiancat e priftërisë, Zoti do t’ju japë **forcë, paqe e këndvështrim të përjetshëm më të sigurt.**”

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Fuqi në Priftëri”, *Liahona*, nëntor 2013, f. 95.



## “Çfarë duhet të bëj kur në shkollë hapet një temë, e cila është në kundërshtim me mësimet e ungjillit, e tillë si aborti?”

**K**a shumë mënyra për t'u përgjigjur – ose jo – në varësi të situatës. Së pari, mendoni se çfarë mund të ndodhë nëse thoni diçka apo nuk e thoni atë. Nëse heshtja juaj do t'i bënte të tjerët të mendonin se ju jeni dakord me diçka që e dini se është e gabuar, ju mund të doni të gjeni një mënyrë të thjeshtë për ta bërë të njohur mospranimin tuaj. Nëse mendoni se komenti juaj do të shkaktonte vetëm grindje, atëherë ju mund të gjeni një rast tjetër për ta bërë komentin. Megjithatë, nëse klasa juaj tregon respekt ndaj njëri-tjetrit dhe mësuesi po kërkon pjesëmarrje, ju mund të luteni për frymëzim dhe më pas të shpjegoni bindjet tuaja fetare.

Ju gjithashtu mund të përgatiteni që më parë nëse e dini se klasa juaj do të diskutojë për një temë të caktuar. Përveç shkri-meve të shenjta dhe bisedave të konferencave për temën, hidhuni një sy librave *Të Vërtetë ndaj Besimit*, *Parimet e Ungjillit*, ose broshurës *Për Forcën e Rinisë*. Ju gjithashtu mund ta praktikoni ta shpjegoni temën në mbrëmjen familjare të shtëpisë. Kur të jeni gati, flisni me mësuesin tuaj ose me shokët tuaj të klasës.

*Mënyra se si përgjigjeni është po aq e rëndësishme sa ajo që thoni. Kini respekt dhe mos u përpiqni të përdorni terminologji të Kishës. Shokët e klasës suaj do të hutohen sapo ju të thoni: “Një këshilltare e Të Rejave në lagjen time më mësoi se . . .”*

Çfarë është më e rëndësishme është që ju të dini atë që Kisha na mëson dhe atë që Fryma e Shenjtë po ju thotë, me qëllim që ju nuk do të mashtroheni nga gabimet që mund të dëgjoni ose lexoni në klasë.

### Mbani Mend se Cilin Përfaqësoni

Kur keni të bëni me këto situata, përpiquni të mbani mend se të tjerët mund të mos kenë të njëjtat ndjenja ndaj çështjes sikurse keni ju. Mos jini mbizotërues ose shtytës, por mos kini frikë t'i mbron bindjet tuaja fetare. Mbani mend se ju përfaqësoni Krishtin.

*Madëlajm K., 16 vjeçe, Uajomi, SHBA*

### Jini i Sjellshëm



Mendoj se duhet t'i ndaj pikëpamjet e mia në një mënyrë të sjellshme dhe gjithashtu të them përse unë i besoj ato. Nuk mendoj se kam nevojë t'i bëj të tjerët të kenë pikëpamjet e mia, por mendoj se ata duhet ta dinë se ku qëndroj unë lidhur me tema të caktuara dhe ta kuptojnë pikëpamjen time.

*Sabrina S., 16 vjeçe, Oregon, SHBA*

### Kini Respekt



Është e rëndësishme t'i bëjmë të tjerët të na dëgjojnë, por është gjithashtu shumë e rëndësishme që të kemi respekt për bindjet e të tjerëve. Mos bëni debate. Debatu krijon armiq dhe ngatërresë. Nëse nxirret në pah ndonjë ide që është në kundërshtim me fenë tonë, rriti të qetë, të përqendruar dhe tregoni respekt e mos harroni që të dëgjoni Shpirtin. Ka gjëra që ne nuk i kuptojmë, por Perëndia i kupton. Ne duhet ta dëgjojmë Shpirtin e Tij dhe të mësojmë prej Tij.

*Hena M., 18 vjeçe, Juta, SHBA*

## Tregoni për Atë që ju Mëson Kisha

Përpiqem t'iu përgjigjem pyetjeve të tilla sa më mirë që mundem, sepse miqtë dhe mësuesit e mi nuk e dinë, në qoftë se unë nuk ua them, cili është qëndrimi i Kishës mbi tema të tilla. Duke e bërë këtë gjë, ata do të jenë në gjendje të dinë për referenca të ardhshme dhe ju do të përfitonit shpirtërisht. Mbani mend: "Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiell" (Mateu 5:16).

*Xhoshua M., 16 vjeç, Mançester, Angli*

## Ndihmohjini të Tjerët të Mendojnë rreth Asaj që Është e Drejtë



Ndajini ndjenjat tuaja me ndershmëri. Shumë tema në shkollë, si aborti, debatohen shumë, prandaj mos kini turp që të thoni mendimin tuaj. Është një mundësi e mirë për të ndarë ungjillin dhe standardet në të cilat besojmë. Nëse i ndani ndani bindjet tuaja, ju mund t'i ndihmoni njerëzit të mendojnë për atë që është e drejtë.

*Medisën R., 14 vjeçe, Karolina Veriore, SHBA*

## Shmangeni Grindjen

Unë do ta shpjegoja mendimin tim, duke i mbrojtur parimet e mia dhe doktrinën e Kishës, duke i respektuar idetë e të tjerëve. Nuk do të jem grindavece, gjë që do ta largojë Shpirtin, i cili mund t'i ndikojë të tjerët në një mënyrë pozitive.

*Dajana V., 15 vjeçe, Buenos-Ajres, Argjentinë*

## Korrigjoheni Doktrinën e Gabuar

Ne i përkasim një Kishë që nxit punën misionare, në të cilën që të gjithë thirrëmi për të predikuar; si rrjedhim, ne nuk mund ta lejojmë të shpërndahej doktrinën e rreme. Në situata të tilla, ne duhet ta ngremë zërin që të korrigjohet ndonjë doktrinë të rreme dhe që t'i ndihmojmë njerëzit të kuptojnë pikëpamjen e ungjillit të rivendosur lidhur me çështjen.

*Dejvid M., 16 vjeç, Provinca Kasai-Oksidental, Republika Demokratike e Kongos*

## Njihni Qëndrimin e Kishës



Isha në një kurs ku u diskutuan shpesh tema kontradiktore. Gjëja e parë që të bëni është t'i respektoni bindjet e të tjerëve, ashtu sikurse do të prisnit nga shokët e klasës suaj. Nëse tema është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kishën, shpallni lirshëm opinionin tuaj. Juve nuk do t'ju duhet ta përmendni Kishën në përgjigjen tuaj. Megjithatë, sigurohuni që e dini qëndrimin e Kishës mbi këto gjëra.

*Xhozef Z., 18 vjeç, Merilend, SHBA*



## QËNDRONI TË PALËKUNDUR

"Është detyra jonë të shpjegojmë pozicionin tonë nëpërmjet arsyes, bindjes miqësore

dhe fakteve të sakta. Është detyra jonë të qëndrojmë të palëkundur e të pae-pur për çështjet morale të kohës dhe parimet e përhershme të ungjillit, por jo që të debatojmë me ndonjë njeri ose organizatë. Grindja lartëson mure dhe krijon pengesa. Dashuria hap dyer."

**Plaku Marvin J. Ashton (1915–1994), i Kuorimit të Dymbëdhjetë Apostujve, "No Time for Contention", Ensign, maj 1978, f. 8.**

## PYETJA PASUESE

"Si mund të ndihem mjaft i qetë për të folur me peshkopin tim rreth problemeve ose shqetësimeve?"

Deri më 15 maj 2014, dërgojeni përgjigjen tuaj dhe, nëse dëshironi, një fotografi me rezolucion të lartë te [liahona@ldschurch.org](mailto:liahona@ldschurch.org) ose nëpërmjet postës (shih adresën në faqen 3).

Përgjigjet mund të redaktohen lidhur me gjatësinë apo qartësinë.

Me përgjigjen tuaj duhet të përfshihen të dhënat dhe leja si vijon: 1) emri i plotë, 2) data e lindjes, 3) lagjia ose dega, 4) kunji ose distrikti, 5) leja juaj me shkrim dhe, nëse jeni nën moshën 18 vjeç, leja me shkrim e prindit tuaj (postimi elektronik pranohet) për botimin e përgjigjes dhe të fotografisë tuaj.





## MËSIMETË SË DIELËS

Tema e Këtij Muaji:  
Braktisja dhe Rivendosja

# E VËRTETË apo E RREME?

Ndonjëherë, njohja e së vërtetës nga e gabuara është e vështirë, por Ati ynë Qiellor na ka dhënë dhurata të fuqishme për të na ndihmuar të dallojmë midis të vërtetës së Perëndisë dhe gënjeshtrave të Satanit.

**Nga Dejvid A. Eduards**

Revistat e Kishës

**N**ëse keni bërë ndonjëherë një pyetësor e vërtetë apo e rreme, e dini se nganjëherë është e vështirë të dalloni një të pavërtetë. Po ashtu, në pyetjet e mëdha për besimin, bindjen fetare dhe jetën e përditshme, ndonëse është jashtëzakonisht e rëndësishme të jemi në gjendje të tregojmë ndryshimin midis asaj që është e vërtetë dhe asaj që nuk është, nuk është gjithnjë e lehtë.

Megjithatë, ne nuk duhet të kemi frikë si njerëz të papërgatitur për pyetësorin. Ati ynë Qiellor na ka bekuar me shumë dhurata për të na ndihmuar t'i njohim të vërtetat e Tij dhe gënjeshttrat e kundërshtarit.

Përgjigjia për secilën pyetje është *E Rreme*, dhe këto pyetje

### Lloje të Ndryshme të Pavërtetash

Së pari, për të ilustruar një çështje, ja tek është për ju një provim i shkurtër me përgjigje të llojit e vërtetë ose e rreme:



# 1

Hëna është e gjelbër.

E VËRTETË

E RREME

Nil Armstrong, astronauti i Apollos 12 që ishte njeriu i parë që shkeli në hënë, tha se ngjarja ishte një "hap vigan për njerëzimin".

E VËRTETË

E RREME

# 2





3

Programi i Administratës Kombëtare për Aeronautikën dhe Hapësirën (NASA) nuk mundi të shkonte në Mars në vitin 1969, prandaj atyre ju desh të shkonin në hënë.

E VËRTETË  E RREME



4

Erërat diellore, rrezatimi, rrezet kozmike dhe pengesa të tjera do t'i kishin bërë të pamundura zbritjet e drejtuara në hënë, plus fotografitë dukeshin të tjetërsuara dhe rrëfimet e dëshmitarëve binin ndesh me disa hollësi, ndaj qeveria amerikane duhet ta ketë sajuar të gjithën këtë.

E VËRTETË  E RREME

**Gënjeshtër të Kohës Sonë**

Kur bëhet fjalë për gjëra që ndikojnë te mendimet, bindjet, zgjedhjet dhe sjelljet tuaja – gjërat të cilat në mundësi kanë pasojë të përjetshme – është shpërblyese t'i mbash sytë hapur për lloje të ndryshme të pavërtetash, duke qenë se Satani, “ati [i] gënjeshtër” (2 Nefi 9:9), do të përdorë çdo metodë që mundet për të na mashtruar. Ja tek janë disa shembuj të mënyrës se si po vepron ai sot, si dhe shembuj të mënyrës se si ne mund të përgjigjemi me të vërtetën që kemi.

tregojnë disa lloje bazë të të pavërtetave që ka mundësi t'i ndeshni.

Pyetja 1 është një *e pavërtetë e thjeshtë*, një gabim i dukshëm. Pyetja 2 është një *e vërtetë e pjesshme*, që është e ndërlikuar, duke qenë se lidh një ose më shumë të vërteta me një të pavërtetë (ishte Apollo 11, jo Apollo 12 – të zura!) Pyetja 3 përmban një *pohim të rremë me dy pjesë* ose një situatë ku paraqiten vetëm dy mundësi, që në të vërtetë nuk janë të vetmet mundësi (për shembull, NASA mund të kishte zgjedhur të mos shkonte gjëkund). Pyetja 4 është një *argument “logjik”*, që shtron mbi njëra-tjetrën prova që tingëllojnë të arsyeshme, por shpesh me gabime, me qëllim që të çojnë në një përfundim të posaçëm të pasaktë.

E Pavërtetë e Thjeshtë

**Ide e Rreme:**

Pornografia është normale dhe nuk lëndon askënd.

**Ku të Çon (Gënjeshtër e Madhe):**

Vazhdo dhe shih pornografi.

E Vërteta:

Pornografia shtrembëron pikëpamjen tonë për seksualitetin, mund të jetë varësuese, na dëmton thellë shpirtërisht dhe mund t'i shkatërrojë marrëdhëniet.

E Vërtetë e Pjesshme

**Ide e Rreme:**

Çdo person është i veçantë dhe mund të jetojë ashtu si ai ose ajo zgjedh të jetojë, prandaj mënyrat se si ndiheni dhe shpreheni janë gjërat më të rëndësishme në jetën tuaj.

**Ku të Çon (Gënjeshtër e Madhe):**

Ju nuk duhet ta lejoni Perëndinë ose Kishën t'ju tregojë se si të jetoni, prandaj vazhdoni dhe bëni atë që doni nëse ajo ju bën të ndiheni mirë.

E Vërteta:

Çdonjëri prej nesh është një fëmijë i veçantë i Atit Qiellor, i cili dëshiron që ne të bëhemi vetë më të mirët dhe të bëhemi si Ai. Bindja ndaj urdhërimeve të Tij na ndihmon të fitojmë gëzim përfundimtar.



## Si ta Dini të Vërtetën

Atëherë, nga vjen një tablo më e plotë për të vërtetën? Si jemi në gjendje të shohim përmes të pavërtetave? Ja tek janë disa prej dhuratave të fuqishme që Ati Qiellor na i ka dhënë për të dalluar të vërtetën nga e gabuara.

- **Drita e Krishtit.** “Drita e Krishtit . . . i nxit të gjithë individët e arsyeshëm në të gjithë tokën të dallojnë të vërtetën nga e gabuara, të drejtën nga e padrejta. Ajo vë në veprim ndërgjegjen tuaj.”<sup>1</sup>
- **Fryma e Shenjtë.** “Fryma e së vërtetës . . . do t’ju prijë në çdo të vërtetë” (Gjoni 16:13).
- **Shkrimet e Shenjta.** “Perëndia e përdor shkrimin e shenjtë për të ndrequr mendimin e gabuar, traditat e pavërteta dhe mëkatin tok me ndikimet e tij rrënuese.”<sup>2</sup> Libri i Mormonit është veçanërisht i rëndësishëm në këtë drejtim, pasi “nxjerr në pah armiqtë e Krishtit. Ai i ngatërron doktrinat e rreme dhe i jep fund grindjes. (Shih 2 Nefi 3:12.)”<sup>3</sup>
- **Profetët bashkëkohorë.** “Përgjegjësia e [profetit] është t’i bëjë të njohur njerëzimit vullnetin dhe karakterin e vërtetë të Perëndisë. . . . Një profet e denoncon mëkatin dhe paratregon pasojat e tij.”<sup>4</sup>
- **Arsimimi.** “Një shenjtor . . . kërkon të mësojë me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit. Arsimimi . . . e aftëson dikë për të dalluar të vërtetën nga e gabuara, sidomos nëpërmjet

Pohim i Rremë me Dy Pjesë  
(Vetëm Dy Mundësi)

### Ide e Rreme:

Kisha predikon kundër disa stileve të caktuara të jetesës; si rrjedhim, ajo është e patolerueshme dhe i urren njerëzit – nuk është pranuese dhe e dashur.

Ku të Çon (Gënjeshtër e Madhe):

Duke qenë se Kisha është jo tolerante dhe plot urrejtje, ajo meriton të kritikohet, të përqeshet dhe të kundërshtohet, prandaj ju duhet t’i shkëputni lidhjet me të.

E Vërteta:

Mospranimi i mënyrës së jetesës së dikujt nuk është i barabartë me urrejtjen dhe mungesën e tolerancës. Ne mund të tregojmë dhembshuri, respekt dhe mirësi ndaj çdokujt – përfshirë njerëzit mënyra e jetesës së të cilëve bie në kundërshtim me ligjet e Perëndisë – ndërsa qëndrojmë të vërtetë ndaj Perëndisë dhe urdhërimeve të Tij.

Argument “Logjik”

### Ide e Rreme:

Disa gjëra në Librin e Mormonit hidhen poshtë nga fakte aktuale shkencore dhe rrëfimet e mënyrës se si u përkthye ai nuk pajtohen mes tyre, prandaj Jozef Smithi mund ta ketë sajuar të gjithën ose ta ketë kopjuar nga diku tjetër.

Ku të Çon (Gënjeshtër e Madhe):

Libri i Mormonit nuk është i vërtetë dhe Jozef Smithi nuk ishte një profet, prandaj shkëputini lidhjet me Kishën.

E Vërteta:

Shkenca pohon shuma gjëra në Librin e Mormonit dhe “prova” kundër tij është e çalë. Por prova më e rëndësishme për të është dëshmia e Shpirtit që ju tregon se ai është i vërtetë dhe se Jozef Smithi ishte një profet i vërtetë.

studimit të shkrimeve të shenjta.  
(Shih DeB 88:118.)<sup>5</sup>

Edhe pse mund të mos jetë gjithnjë e lehtë të përgjigjesh *E Vërtetë* ose *E Rreme* kur përballeni me të gjitha këto ide të ndryshme në botë, dhuratat që Ati Qiellor ju ka dhënë mund t’ju ndihmojnë ta plotësoni pyetësonin. ■

#### SHËNIME

1. Richard G. Scott, “Peace of Conscience and Peace of Mind”, *Liahona*, nëntor 2004, f. 15.
2. D. Tod Kristoferson, “Bekimi prej Shkrimeve të Shenjta”, *Liahona*, maj 2010, f. 33–34.
3. Ezra Taft Benson (1899–1994), “The Book of Mormon Is the Word of God”, *Ensign*, maj 1975, f. 64.
4. Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Profet”, f. 157, scriptures.lds.org.
5. Russell M. Nelson, “Thus Shall My Church Be Called”, *Ensign*, maj 1990, f. 16.

## HYNË NË BASHKËBISEDIM

### Gjëra për të Përsiatuar për të Dielën

- Si ju ka ndihmuar Ati Qiellor ta njihni të vërtetën?
- Si mund ta luftoni gabimin?
- Si mund t’i nxitni të tjerët ta zbulojnë të vërtetën?

### Gjëra që Mund të Bëni

- Në kishë, tregoni se si arritët të besonit se ungjilli i rivendosur është i vërtetë.
- Në mediat shoqërore, tregoni për një të vërtetë dhe se si e dini atë.



**Nga Plaku Enrike R. Falabela,**  
i Të Shtatëdhjetëve

# “Kjo është kaq e lehtë, Gjyshi.”

*“Ju hetoni Shkrimet sepse mendoni të keni nëpërmjet tyre jetë të përjetshme; dhe ato janë këto që dëshmojnë për mua” (Gjoni 5:39).*

**U**në e Dua Librin e Mormonit dhe Shpëtimtarin tim, Jezu Krishtin. Një ditë i kërkova mbesës sime, Rakelës, se çfarë mendonte rreth vendosjes së një qëllimi për të lexuar Librin e Mormonit. Rakela kishte mësuar të lexonte së fundmi.

“Por, Gjyshi”, tha ajo, “është kaq e vështirë. Është një libër i madh.”

Pastaj i kërkova të më lexonte një faqe. Mora një kronometër dhe mata kohën. I duheshin vetëm tri minuta për ta lexuar faqen.

Ne e lexojmë Librin e Mormonit në spanjisht dhe varianti spanjisht i Librit të Mormonit ka 642 faqe. I thashë asaj se do i duheshin 1.926 minuta për ta lexuar të gjithë librin.

Kjo do të mund ta kishte frikësuar atë edhe më shumë, kështu që e përpjesëtova atë numër me 60-minutëshja. I thashë se do t'i duheshin vetëm 32 orë për ta lexuar librin. Kjo do ishte më pak se një ditë e gjysmë!

Atëherë ajo më tha: “Kjo është kaq e lehtë, Gjyshi”.

Rakela, vëllai i saj, Estebani, dhe nipërit e mbesat tanë të tjerë shpenzuan më shumë kohë për ta lexuar Librin e Mormonit. Kjo ndodh, sepse kur e lexojmë atë, na nevojitet kohë për t'u lutur dhe për të menduar rreth asaj që kemi lexuar.

Ashtu si Rakela dhe Estebani, ne të gjithë mund të mësojmë t'i duam shkrimet e shenjta. Atëherë çdonjëri prej nesh mund të thërrasë: “Sa të ëmbla janë fjalët e tua në gojën time! Janë më të ëmbla se mjalti në gojën time!” (Psalmeve 119:103). ■

*Nga një bisedë në konferencën e përgjithshme të prillit 2013.*







**Nga Karol M. Stevens,**

Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës

# PREMTIMI



**K**ur vjehëri im ndërroi jetë, familja jonë u mblodh së bashku për të mirëpritur të tjerët që erdhën për të na ngushëlluar. Gjatë gjithë mbrëmjes, ndërsa flisja me familjen dhe miqtë, shpesh vura re nipin tonë 10-vjeçar, Porterin, duke i qëndruar pranë vjehrrës sime – “nënokes” së tij. Ndonjëherë qëndronte prapa saj, duke u kujdesur për të. Një herë, vura re ta kapte për krahu. E pashë t'i ledhatonte duart, t'i jepte për qafime të vogla dhe t'i qëndronte përkrah.

Për disa ditë pas asaj përvoje, nuk mund ta hiqja nga mendja

këtë pamje. Pata nxitjen t'i dërgoja Porterit një mesazh elektronik. I thashë atë çfarë kisha parë e ndier. I kujtova atij edhe **besëlidhjet** që ai kishte bërë kur ishte pagëzuar, duke cituar fjalët e Almës te Mosia, kapitulli 18:

“Dhe tani, pasi ju dëshironi të hyni në grigjën e Perëndisë dhe të quheni populli i tij dhe jeni të gatshëm të mbani barrët e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta –

Po, dhe jeni të gatshëm të vajtoni me ata që vajtojnë; po, dhe të ngushëlloni ata që kanë nevojë të

ngushëllohen dhe të qëndroni si dëshmitarë të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet që ju të gjendeni, madje deri në vdekje, . . . që ju të mund të keni jetën e përjetshme –

. . . Në qoftë se kjo është dëshira e zemrave tuaja, çfarë keni kundër pagëzimit në emrin e Zotit, si një dëshmi para tij që ju keni hyrë në një **besëlidhje** me të, se ju do t'i shërbeni atij dhe do të zbatoni urdhërimet e tij, që ai të mund të derdhë mbi ju Shpirtin e tij më me shumicë?” (vargjet 8–10).

# I PORTERIT

Një besëlidhje është një premtim midis teje dhe Atit Qiellor.

I shpjegova Porterit që Alma na mësoi se ata që dëshirojnë të pagëzohen duhet të jenë të gatshëm t'i shërbejnë Zotit duke u shërbyer të tjerëve – gjatë gjithë jetës! I thashë: “Nuk e di nëse e kuptove, por mënyra se si tregove dashuri dhe shqetësim për Nënoken ishte mbajtje e **besëlidhjeve** të tua. Ne i mbajmë **besëlidhjet** tona çdo ditë ndërsa jemi të përzemërt, tregojmë dashuri dhe kujdesimi për njëri-tjetrin. Thjesht dëshiroj që të dish se jam krenare për ty që je një mbajtës i **besëlidhjeve**! Ndërsa

mban **besëlidhjen** që bëre kur u pagëzove, ti do të jesh i përgatitur që të shugurohesh në priftëri. Kjo **besëlidhje** tjetër do të të japë më shumë mundësi për t'i bekuar e për t'u shërbyer të tjerëve dhe do të të ndihmojë të përgatitesh për **besëlidhjet** që do të bësh në tempull. Të falënderoj që je një shembull kaq i mirë për mua! Të falënderoj që më tregove se si është një mbajtës i **besëlidhjeve**!”

Porteri u përgjigj: “Gjyshe, faleminderit për mesazhin. Kur po e përqafoja Nënoken gjithë kohën,

nuk e dija se po i mbaja **besëlidhjet** e mia, por u ndjeva ngrohtë në zemër dhe u ndjeva vërtet mirë. E di që ishte Fryma e Shenjtë në zemrën time.”

Edhe unë u ndjeva ngrohtë në zemër kur e kuptova se Porteri e dinte se kur mban **besëlidhjet** e tij ai do të “ke[htë] gjithmonë Shpirtin e [Atit Qiellor] me [vete]” [DeB 20:77]. Ky është një premtim i bërë i mundur nëpërmjet marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë. ■

*Nga biseda “Kemi Arsye të Madhe për t'u Gëzuar”, Liahona, nëntor 2013, f. 115–116.*



## JI NJË MBAJTËS I BESËLIDHJEVE!

Kur pagëzohem, unë premtoj të ...

Tregoj dashuri dhe mirësi,  
Ngushëlloj ata që janë të trishtuar,  
Mbaj urdhërimet e Atit Qiellor,  
dhe t'u tregoj të tjerëve për Atin Qiellor.

Në këmbim, Ati Qiellor më  
premtan ...

Që do ta kem gjithmonë Frymën e Shenjtë!  
Nënshkruar,





Mësoni më shumë për temën  
e Fillores për këtë muaj!

# Familja Është Qendrore në Planin e Atit Qiellor



Nga Xhein Teilor

**M**ishas i pëlqente shumë të ndërtonte kulla me blloqe, por ndonjëherë mërзитеj kur blloqet përmbyseshin në tokë. Atëherë ajo mësoi një sekret. Kur përdorte më shumë blloqe në pjesën e poshtme të kullës, i jepte kullës një themel më të fortë. Iu desh përpjekje dhe praktikë, por shpejt mundi të ndërtonte kulla që nuk binin aq kollaj.

Ashtu si Misha mësoi të ndërtonte kulla më të forta, ne mund të mësojmë të krijojmë një familje më të fortë. Familjet janë një pjesë shumë e rëndësishme e planit të Atit Qiellor për ne. Përpara se të lindeshim, jetuam si bij dhe bija shpirtërore të Atit Qiellor. Kur erdhi koha që ne të

vinim në tokë, Ai planifikoi që ne të vinim nëpër familje. Ai dëshiron që familjet të na mbrojnë, të na mësojnë dhe të na ndihmojnë të kthehemi tek Ai.

Ne mund të punojmë për t'iu dhënë familjeve tona një themel më të fortë. Ne mund të ushtrojmë shërbim dhe ndihmë ndaj njëri-tjetrit. Ne mund të dëgjojmë dhe të flasim me mirësi ndaj njëri-tjetrit. Ne mund të lutemi dhe t'i studiojmë shkrimet e shenjta së bashku. Ne mund të punojmë së bashku dhe të kalojmë kohë së bashku duke bërë gjëra që na pëlqejnë. Me përpjekje dhe praktikë, ne mund të ndërtojmë një familje më të fortë. ■

## KËNGË DHE SHKRIM I SHENJTË

- "Families Can Be Together Forever" ["Familjet Mund t'Jen' s' Bashku Përgjithmon'"], (*Children's Songbook*, nr. 188)
- Lluca 6:47-49

## IDE PËR BISEDË FAMILJARE

Si familje, ju mund të lexoni Llukën 6:47-49. Më pas mund të flisni rresh asaj që na mësojnë këto vargje për familjet. Si e ka ndihmuar familja juaj njëri-tjetrin përmes kohëve sfiduese? Çfarë mund të bëni ju për të ndërtuar një themel edhe më të fortë?



Lutja familjare

Të shkruarit e një  
letre një misionari

Mbrëmja familjare

Ngrënia e darkës së bashku

Studimi familjar  
i shkrimeve

Bërja e lojërave së bashku

Vizita te dikush që  
është i sëmurë

Të mësuarit e historive  
për paraardhësit tanë

## BËRJA E FAMILJEVE TONA TË FORTA

Ju mund të bëni një afishe për ta ndihmuar familjen tuaj të forcohet më shumë!

- Me ndihmën e një të rrituri, pritini blloqet. Ngjitni në një copë letër ato që tregojnë gjërat që familja juaj po bën tashmë. Këto blloqe do të përfaqësojnë themelin e familjes suaj.
- Zgjidhni një tjetër bllok që tregon diçka që familja juaj do të dëshironte të bënte ose bën më mirë. Pasi ta plotësoni këtë synim, shtojani kullës suaj. Vendoseni afishen në një vend ku çdokush mund ta shohë dhe vazhdoni duke shtuar blloqe për ta bërë familjen tuaj të fortë!

Shkruani disa nga vetë idetë tuaja në blloqet bosh.



# Pagëzimi

është pika e nisjes  
në udhëtimin tonë të  
dishepullimit.

Presidenti Diter F. Uhtdorf,  
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë  
Nga konferenca e përgjithshme e tetorit 2013







**Nga Plaku**  
**Terens M. Vinson,**  
i Të Shtatëdhjetëve

Cilat janë disa gjëra që janë shumë të vështira për ju që t'i bëni?  
.....  
Si mund t'i kërkonti ndihmë Atit Qiellor në bërjen e gjërave të vështira?  
.....  
Kujt tjetër mund t'i kërkonti ndihmë?  
.....



## Lëvizja e Shkëmbit

**N**jë djalë i ri po përpiquej të pastroste zonën e ndotur prapa shtëpisë së tij që të mund të luante atje me makinat e tij. Atje ishte një shkëmb i madh që e pengonte punën e tij. Djali e shtynte dhe e tërhiqte me gjithë fuqinë e tij. Por pavarësisht sa fort u përpoq, shkëmbi nuk lëvizte.

Babai i tij e vështroi për pak kohë.

Pastaj erdhi tek i biri dhe i tha: “Ti ke nevojë ta përdorësh gjithë fuqinë tënde për të lëvizur një shkëmb kaq të madh”.

Djali u përgjigj: “Unë e përdora të gjithë fuqinë time!”

Babai i tij e korrigjoi: “Jo, nuk e ke përdorur. Ti nuk e pate ende ndihmën time!”

Ata u përkulën atëherë së bashku

dhe e lëvizën shkëmbin lehtësisht.

Zoti do që ne të mbështetemi tek Ai për zgjidhjen e problemeve tona. Atëherë mund ta ndiejmë dashurinë e Tij më shpesh, më fuqishëm, më qartë dhe më personalisht. Ne bëhemi një me Të dhe mund të bëhemi si Ai. ■

*Nga biseda “Duke iu Afruar më Shumë Perëndisë”,  
Liahona, nëntor 2013, f. 105.*



# Unë jam Dria nga Filipinet

## *Mabuhai, Kaibigan!\**

Nga një intervistë prej Emi Xhejn Levit

**A**keni ëndërruar ndonjëherë të jetoni në një ishull? Kjo është Alehandria, por familja dhe miqtë e saj e thërrasin shkurt Dria. Ajo jeton në ishullin e Kebusë në Filipine me të ëmën, të atin dhe dy motrat e saj. Ajo kishte edhe një vëlla më të madh, por ai vdiq përpara se të lindte Dria. “Unë e di se ai është ende pjesë e familjes sonë dhe do ta shoh atë një ditë, sepse familjet janë përgjithmonë”, thotë ajo. ■

\*“Përshëndetje, miq!” në gjuhën tagaloge.

*Një nga gjërat e parapëlqyera që bëj është kërcimi. Jam një balerinë klasike. Vitin e ardhshëm shpresoj të kaloj në nivelin tjetër, që është baleti me puante. Kjo do të thotë që do të vesh këpucë të veçanta baleti, që më ndihmojnë të kërcëj në majë të gishtave.*



*Filipinet kanë më shumë sesa 7.000 ishuj, ndaj ka shumë vende të bukura për t'u vizituar. Shtëpia jonë është afër plazhit, dhe më pëlqen të luaj në oqean. Një nga gjërat e parapëlqyera që bëj është noti. Madje e kam mësuar vetë!*





*Më pëlqen shumë të shkoj me familjen time për të vizituar plazhe të ndryshme. Një herë shkuam në Palauan – një ishull me lumin më të madh nëntokë në botë. Shkova për zhytje me periskopin tim dhe pashë të gjithë peshqit shumëngjyrësh.*



*Një ditë në shkollë, disa shokë klase thanë se mormonët nuk besojnë në Perëndi. U thashë atyre se besojmë. Ditën pasuese solla disa karta për shpërndarje që kishin një fotografi të Jezusit përpara dhe Nenet e Besimit prapa. Kur shokët e klasës e panë fotografinë dhe lexuan disa nga bindjet tona, ata qenë të lumtur që e dinin se ne vërtet besojmë në Perëndi.*



*Jemi fatlumë që jetojmë afër Tempullit të Sebu-Sitit, Filipine. Unë pata mundësi ta vizitoja tempullin me familjen time përpara se ai të përkushtohej. Është një vend kaq i bukur dhe i qetë. Jam mirënjohëse që, për shkak të tempujve, familja ime mund të jetë së bashku përgjithmonë.*



## GATI PËR T'U NISUR!

*Çanta e Drias mbushet me disa prej gjërave të saj të parapëlqyera. Cilat janë ato gjëra që do të vendosnit në çantën tuaj?*





# Të Mendojmë për Krishtin


Nga Mabel Xhons Gabot



E vështir' nuk duhet t'jet' të ulesh  
i qetë e Jezusin t'mendosh, kryqin e Tij në kodër,  
E gjithçka vuajti dhe e bëri për mua;  
E vështir' nuk duhet t'jet' të ulesh n'qetësi.



Se sa milje Ai eci në  
pluhur, mendoj,



Dhe fëmijët i ndihmoi  
t'duan e t'besojn';





E vështir' nuk duhet t'jet' që n'karrige shembullor t'qëndroj,  
me kulturë t'dëgjoj e këmbët mos përplas'.  
E vështir' nuk duhet t'jet', ndonëse i vogël jam,  
Jezusin t'mendoj, e vështirë jo aspak. ■



# NJË KOHË E VEÇANTË PËR TË MENDUAR PËR JEZU KRISHTIN

*Mbledhja e sakramentit është një kohë e veçantë për t'u ulur qetësisht dhe për të menduar për Shpëtimtarin.*



Jezusi u pagëzua në lumin Jordan.



Jezusi shëroi njerëz.



Jezusi i donte fëmijët e vegjël.



Jezusi vuajti dhe vdiq për ne.



Jezusi u ngrit përsëri mëngjesin e Pashkës.



Për shkak të Jezusit, edhe ne do të jetojmë sërish!

Vizatoni ose vendosni këtu një fotografi tuajën.



# GJETJA E SHPRESËS NË TË ARDHMEN

Nga Sten Pagsli

Më 12 shtator 2001, unë dhe bashkëshortja ime po matnim me hapa dyshtemenë e një spitali në Tucson të Arizonës, SHBA, duke kaluar orë plot ankth ndërsa prisnim që djali ynë të vinte në jetë. Nga televizori ynë dhe nga çdo televizor në ndërtesë, ne u bombarduam nga pjesët filmike të një dite më parë në qytetin e Nju-Jork-ut – pamje të dy kullave që dikur ishin spiranca e horizontit të atij qyteti, duke rënë në rrënoja dhe pluhur. Pamjet, transmetimi me orë të tëra, na lanë me një ndjenjë dëshpërimi. Dukej koha më e keqe e mundshme për të sjellë një foshnjë në botë – një botë që dukej kaq e errët dhe kërcënuese.

Herët në mëngjes, djali ynë foshnjë u lind. Ndërsa e mbajta në krahë foshnjën e vockël, mendova për ngjarjet shkatërruese të pak ditëve të fundit, ngjarje që më bënë të rikujtoja zjarrin në Parkun Kombëtar të Jelloustounit në vitin 1988. Flakët kishin djegur pothuaj 800.000 akra (323.750 ha) të pyllit. Shkatërrimi i parkut dukej i vërtetë. Pamjet në lajme treguan vetëm tokën e djegur dhe tymin e dendur të zi në qiell. Asnjë përpjekje njerëzore nuk mund ta rikthente shpejt atë që humbi. Dukej sikur edhe ripërtëritja e palodhur dhe vrulli i natyrës nuk mateshin dot me forcën shkatërruese të zjarrit.

Sidoqoftë, pranverën tjetër ndodhi një mrekulli e padëgjuar – bimë dhe lule të vogla



*Të njëjtat erëra  
që godasin dhe  
kërcënojnë për  
të na mposhtur,  
mbjellin edhe fa-  
rat e ndryshimit  
dhe të rritjes.*

filluan të rriteshin nëpër tokën e përcëlluar. Pak nga pak, akoma më shumë lule dhe shkurre e pemë çelën nga toka. Rilindja e parkut ishte e ngadaltë dhe e mbushur me hollësi imcake, të lavdishme dhe me kalimin e kohës rezultatet ishin të ndjeshme.

Në çastet e frikës që duket të na shkrumbojë si flakët flakëruese të Jelloustounit, kur besimi dhe shpresa jonë kanë arritur fundin e tyre, ne duhet të kujtojmë se ekziston një themel i qetë e i palëkundur poshtë nesh, shumë më i fuqishëm sesa çdo forcë e ligë që vërtet do të ndeshim. Helamani shpjegon se ky themel është “shkëmbi [i] Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë”. Nëse e hedhim spirancën tonë tek Ai, atëherë “kur djalli të çojë erërat e tij të fuqishme, po shigjetat e tij në shtjellë të erës, po, kur i gjithë breshëri i tij dhe furtuna e tij e fuqishme do të lëshohen mbi ju, nuk do të ketë fuqi mbi ju, që t’ju tërheqë në humnerën e mjerimit dhe të vuajtjes së pafund, për shkak të shkëmbit mbi të cilin jeni ndërtuar, që është një bazë e sigurt, një bazë mbi të cilën në qoftë se njerëzit ndërtojnë, nuk mund të bien” (Helamani 5:12).

Për shkak të forcave të tërbuara të së ligës dhe tundimit në botë, mund të mendojmë se ndikimi i vogël e i thjeshtë i ungjillit nuk matet me to dhe tronditet. Ne mund të ndiejmë dyshim dhe dëshpërim ndërsa presim më kot që e keqja të ndreqet, dhembja të lehtësohet dhe dyshimet të zgjidhen. Sidoqoftë, pikërisht ato erëra që na godasin, mbjellin fara të ndryshimit e të rritjes dhe fuqia e pamasë e ungjillit vepron qetësisht nën dheun e ekzistencës tokësore, duke përgatitur mijëra fara të vogla shprese dhe jete. ■

*Autori jeton në Arizonë, SHBA.*



LUSTRIMI NGA ROBERT T. BARRETT

## HAUARD W. HANTER

Hauard W. Hanter fitoi Çmimin e Skautistit Shqiptonjë (çmimi më i lartë në programin e arritjes për djemtë e rinj) kur ishte 15 vjeç. Ai ishte i magjepsur pas **gjenealogjisë** dhe shpesh kalonte kohë duke kërkuar në bibliotekën gjenealogjike të Kishës ose duke vizituar familjen. Ndërsa po shërbente si Apostull, ai ndihmoi në zgjedhjen e vendit për **Qendrën e Universitetit “Brigam Jang” në Jerusalem**. Si President i Kishës, i nxi-ti anëtarët të adhuronin shpesh në tempull dhe përkushtoi **Tempullin Bauntiful në Juta** më pak se dy muaj para se të vdiste.



# Gjithashtu në Këtë Botim

## PËR TË RINJTË NË MOSHË MADHORE



Nëse Syri Juaj Drejtohet te

## Lavdia Ime

f.40

Të rinj në moshë madhore anekënd botës reflektojnë mbi atë çka do të thotë të ndjekësh shembullin e Shpëtimtarit dhe të jetosh me thjeshtësi.

## PËR RININË

A është hëna e gjelbër? A ishte e rreme zbritja në hënë? Bëjeni këtë pyetësor dhe mësoni se si ta dalloni ndryshimin midis të vërtetës së Perëndisë dhe gënjeshtreve të Satanit.

## E VËRTETË apo E RREME?



f.64

## PËR FËMIJËT

## “Kjo është kaq e lehtë, Gjyshi.”

A do të çuditeshit nëse do të zbulonit se mund ta lexoni Librin e Mormonit në një ditë e gjysmë?



f.67

